

SISTEMI PARTIAK - STRUKTURA DHE ORGANIZIMI I PARTIVE POLITIKE NË SHQIPËRI 1991-2013

Anjeza Xhaferaj


Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Sociale, me profil Shkenca Politike, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: Odeta Barbullushi, PhD

Numri i fjalëve: 51,237

Tiranë, janar, 2016



DEKLARATA E AUTORËSISË

Ky studim është një punim origjinal i imi. Asnjë pjesë e tij nuk është plagjaturë. Të gjithë autorët janë cituar dhe referuar sipas rregullave të shkrimit akademik. Deklaroj gjithashtu se ky punim nuk është dorëzuar as tërësisht dhe as pjesërisht në ndonjë universitet tjetër për marrjen e ndonjë titulli.

ABSTRAKTI

Punimi doktoral fokusohet në studimin e sistemit partiak dhe partive politike shqiptare në periudhën post-komuniste. Synimi i analizës është t'i japë përgjigje pyetjes se cili është sistemi partiak dhe cila është struktura dhe organizimi i partive politike shqiptare. Periudha e marrë në shqyrtim nis me zgjedhjet e para post-komuniste në vitin 1991 dhe përfundon me zgjedhjet e fundit të përgjithshme në vitin 2013. Teza qendrore e punimit është se sistemi partiak shqiptar ka shfaqur qëndrueshmëri gjatë kësaj periudhe dhe se partitë politike shqiptare janë parti masash klienteliste me shtrirje të thellë territoriale ku anëtarësia ka reshtur së luajtur rolin e saj tradicional të vullnetarizimit për aktivitetet publike të partisë dhe atashimi i saj me partinë nuk është ideologjik por synon përfitimin material në shkëmbim të mbështetjes së dhënë në kohë fushate. Përmes depërtimit të thellë territorial partitë politike kontrollojnë votat e elektoratit gjë që shpjegon luhatshmërinë e ulët elektorale në Shqipëri dhe për pasojë qëndrueshmërinë e sistemit partiak.

Punimi u mbështet në teorinë institucionaliste dhe historiko-strukturore sipas së cilës konteksti institucional ku krijohen dhe fillojnë të operojnë partitë politike si edhe e kaluara historike ndikojnë mbi sistemin partiak dhe strukturën dhe organizimin e partive politike. Në këtë kontekst, mungesa e identiteteve të qarta sociale për shkak të nivelimit socio-ekonomik që komunizmi i kish bërë popullsisë, aksesit ndaj fondeve publike që në fazat e hershme të krijimit të tyre dhe trashëgimia e komunizmit patrimonial që inkurajon marrëdhënie klienteliste dhe nepotike ndërmjet elitave politike dhe niveleve më të ulta të hierarkisë partiake dhe shtetërore, bën që partitë politike shqiptare të jenë parti jo-

programatike që vendosin marrëdhënie klienteliste me anëtarësinë. Mungesa e aksesit ndaj medias, dhe nevoja për të strukturuar elektoratin përmes shpërblimesh jo-legjitime dhe jo programatike, megjithatë i ka shtyrë partitë politike të kërkojnë një depërtim të thellë territorial që rezulton në formimin e partisë së masave klienteliste

Për të testuar hipotezën e punimit janë ndërmarrë tre hapa: a) përcaktimi i numrit efektiv të partive dhe përcaktimi i luhatshmërisë së sistemit partiak; b) shpërndarja e brendshme e pushtetit dhe analiza e rolit të anëtarësisë në partitë e marra në shqyrtim si edhe; c) identifikimi i burimeve të financimit të partive politike.

ABSTRACT

This thesis explores the party system and political parties in the post-communist Albania. The overarching question of the thesis is what kind of party system has developed and what is the structure and organization of the Albanian political parties. The study analyses the period 1991-2013, that is the period between the first and the last general elections. I argue and test that the Albanian party system is stable and that the Albanian political parties are mass clientelist parties with deep territorial penetration. The members of the parties have ceased to play their traditional roles of the era of mass party and their attachment to the party is not ideological but aims to ensure material benefits in return for the support provided to the party in election times. As parties don't have many tools at hand they use their organizational structure to stabilize electorate, which explains the low level of electoral volatility in Albania and as consequence the stability of the party system.

The thesis has an institutionally embedded and a historically and structural framework, according to which party strategies are shaped by both the institutional context and the historical setting in which parties are created and operate. Following this line of reasoning, the weak societal roots of parties do not allow for party identification or voter alignment; the early access to public funding reduces the incentives of parties to create strong links with the members and society to collect financial resources and; in line with the features of the patrimonial communism which is characterized by clientelism and nepotism, the Albanian political parties develop the same relationships between the higher echelons of the party and the lower strata of the party structure. On the other hand the lack

of media access in the early phase of organization and the need to stabilize the electorate, encourage the Albanian political parties to seek a deep territorial penetration which results in the creation of mass clientelist parties.

In order to test the hypotheses I have undertaken three steps: a) the analyses of the Effective Number of Parties and Electoral Volatility; b) the internal distribution of power, the role of the membership and the relationship of the organization with society and; c) the identification of financial resources of the political parties.

DEDIKIMI

Për Zekërian

Përkujtim i mëshirës së Zotit tënd ndaj robit të vet Zekërisë

FALENDERIME

Për ata studentë që vendosin të ndjekin një karrierë akademike, mbrojtja e tezës doktorale është hapi i parë i rëndësishëm. Duke qenë produkt i një periudhe të gjatë kërkimore, punimi doktoral ka për synim të tregojë aftësitë intelektuale dhe analitike të kandidatit doktoral. Kjo tezë nuk do të kish mundur të përfundohej pa ndihmën e një sërë akademikësh dhe institucionesh. Si udhëheqësja ime, Odeta Barbullushi e ka ndjekur nga afër këtë punim që prej fillimit të tij. Komentet e detajuara, kriticizmi i vlefshëm dhe inkurajimi i vazhdedhëm kanë dhënë një ndihmë të pazëvendësueshme në përfundimin e këtij punimi. Kam mësuar jashtë mase prej saj gjatë katër viteve që kemi punuar së bashku si në shkrimin e tezës doktorale ashtu edhe në zhvillimin e lëndëve mësimore.

Mirënjohje i shkon gjithashtu edhe Henri Çilit, për akordimin e bursës pa të cilën nuk do të kish qenë e mundur kryerja e punimit doktoral.

Janë gjithashtu edhe shumë njerëz të tjerë që do të doja t'i falenderoja për komentet e tyre të vlefshme gjatë prezantimit të kësaj teze përpara departamentit apo në ditët doktorale.

Falenderoj gjithashtu edhe shkollën doktorale, pjesë e së cilës kam qenë edhe vetë për rreth dy vite, për punën e madhe që kanë bërë për të siguruar mbarëvajtjen e procesit: profesor Adrian Civicin, Arbi Agalliun, Erika Melonashin, Besarta Vladin dhe Nertila Kokën.

Po kështu falenderoj edhe koleget dhe mikeshat e mia, pjesë e grupit të parë të doktoranteve në UET, Valentina Memini, Irena Lavdari, Blerta Aliu dhe Irena Myzeqari të cilat me durim kanë dëgjuar prezantimet e mia dhe më kanë dhënë komente të vlefshme për to.

Së fundmi, po pa ndihmën e të cilëve ky punim nuk do të kish qenë i mundur, falenderoj mamanë time që u kujdes për djalin tim të porsalindur teksa unë shkruaja punimin si edhe bashkëshortin tim për mbështetjen e vazhdueshme për punën time, pavarësisht se kjo do të thoshte më pak kohë dedikuar familjes.

TABELA E PËRMBAJTJES

KAPITULLI I. HYRJE – SISTEMI PARTIAK DHE STRUKTURA E ORGANIZIMI I

PARTIVE POLITIKE NË VENDET POST-KOMUNISTE. - 1 -

1.1 Qëllimi i Punimit - 1 -

1.2 Pse Shqipëria? - 6 -

1.3. Cila është Risia? - 12 -

1.4 Metodologjia - 15 -

1.4 Plani i Punimit - 18 -

KAPITULLI II. SKELETI TEORIK DHE MODELI ANALITIK I TEMËS - 21 -

2.1. Skeleti Teorik: Sistemi Partiak dhe Tipologjitë e Partive Politike - Struktura dhe Organizimi në Evropën

Perëndimore dhe në vendet Post-Komuniste..... - 21 -

Sistemi Partiak dhe Lurahshmëria e Elektoratit në vendet e Evropës Perëndimore dhe në vendet post-komuniste..... - 21 -

Tipologjitë e Partive Politike..... - 26 -

Partia e Masave - 27 -

Partia ‘Catch All’ ose Partia ‘Kap Gjithkënd’ - 29 -

Partia elektorale - profesionale - 31 -

Partia Kartel - 34 -

Partia Klienteliste e Masave - 35 -

Modele Teorike mbi Strukturën dhe Organizimin e Partive Politike në Evropën Post- Komuniste - 38 -

2.2 Modeli Analitik – Të Dhënat dhe Metodat	- 45 -
Mbi Sistemin Partiak: Numri efektiv i partive dhe luhatshmëria e elektoratit	- 46 -
Analiza në nivel partiak: financat – shoqëria – balanca e brendshme e pushtetit.....	- 51 -

KAPITULLI III – SISTEMI PARTIAK NË SHQIPËRI..... - 60 -

3.1. Çfarë është Sistemi Partiak.....	- 60 -
3.2 Sistemi Partiak në Shqipëri: përbërja e parlamentit dhe e qeverisë	- 61 -
3.3 Numri Efektiv i Partive dhe Fragmentizimi Partiak në Shqipëri.....	- 67 -
3.4 Luhatshmëria Elektorale	- 74 -
3.5 ‘Manual’ për Matjen e Luhatshmërisë Elektorale	- 76 -
3.6 Luhatshmëria e sistemit partiak dhe sistemi elektorale në Shqipëri.....	- 82 -
3.7 Luhatshmëria në Bllok në Shqipëri	- 86 -
3.8 Përfundime	- 91 -

KAPITULLI IV. ORGANIZIMI PARTIAK, ANËTARËSIA DHE BALANCA E

BRENDSHME E PUSHTETIT..... - 93 -

4.1 Hyrje	- 93 -
4.2 Organizimi Partiak - Anëtarësia.....	- 94 -
Madhësia e Anëtarësisë	- 94 -
Konceptimi i anëtarësisë partiake	- 99 -
Partitë dhe grupet e interesit.....	- 103 -

4.3 Struktura Organizacionale	- 104 -
Organet Kombëtare të Partisë	- 104 -
4.4 Shpërndarja e brendshme e pushtetit	- 111 -
4.5 Partia Jashtë Parlamentare vs. Partia në Poste Publike	- 117 -
Konceptimi i brendshëm i balancës së pushtetit	- 120 -
Akumulimi i mandateve	- 121 -
Alokimi i fondeve shtetërore.....	- 127 -
5. Konkluzion	- 130 -
 KAPITULLI V – NDIKIMI I FINANCIVE MBI PARTITË POLITIKE - “MË THUAJ SI FINANCOHESH TË TË THEM SE Ç’PARTI JE”	- 132 -
5.1 Hyrje	- 132 -
5.2 Korniza ligjore e Fondeve Publike dhe ndikimi i tyre mbi partitë politike	- 134 -
5.3 Korniza Ligjore e Financimit të Partive Politike në Shqipëri	- 137 -
5.4 Kufizimet, Transparenca dhe Kontrolli	- 147 -
5.5 Ndikimi i fondeve publike mbi partitë politike	- 150 -
5.6 Roli i Shoqërisë.....	- 163 -
5.7 Financat Partiake dhe Organizimi Partiak.....	- 167 -
5.8 Konkluzioni	- 169 -

KAPITULLIL VI: PËRFUNDIME – SISTEMIT PARTIAK DHE STRUKTURA DHE ORGANIZIMI I PARTIVE POLITIKE SHQIPTARE.....	- 171 -
6.1 Hyrje	- 171 -
6.2 Sistemi Partiak Shqiptar dhe Panorama Komplekse e Lulatshmerisë Elektorale.....	- 174 -
6.3 Organizimi Partiak, Anëtarësia dhe Balanca e Brendshme e Pushtetit	- 177 -
6.4 Ndikimi i Financave mbi Partitw Politike	- 181 -
6.5 Konkluzioni	- 182 -
7. SHTOJCA.....	- 184 -
BIBLIOGRAFIA.....	- 186 -

Lista e Tabelave

Tabela 1: Numri i vendeve në parlament për partitë politike gjatë periudhës 1991-2013-	62
-	
Tabela 2: Shpërndarja e Portofoleve në Kabinetet Qeveritare: 1991-2013	64 -
Tabela 3: Numri Efektiv i Partive Parlamentare	68 -
Tabela 4: Klasifikimi i Sistemit Partiak sipas dimensioneve të P3%S, 2PSC, SR 1:2 dhe SR 2:3 (Siaroff, 2000, kap.3)	70 -
Tabela 5: Klasifikimi i Sistemit Partiak i Siaroff (2000) në lidhje me NEPP	70 -
Tabela 6: Dimensionet e Sistemit Partiak në Shqipëri 1991-2013 – Aplikim i skemës së Siaroff	71 -
Tabela 7: Luhatshmëria në nivel sistemi dhe në nivel partie në Shqipëri: 1991- 2013 ..-	82 -
Tabela 8: Sistemi Elektorale dhe Luhatshmëria e Sistemit Partiak	85 -
Tabela 9: Mbështetja elektorale ndaj partive politike (në %)	87 -
Tabela 10: Luhatshmëria në Bllok (LB) 1997 – 2013	90 -
Tabela 11: Anëtarësia e Partive politike Shqiptare: 1991-2013	95 -
Tabela 12: Numri i votuesve dhe Pjesëmarrja në zgjedhje në Shqipëri: 1991-2013:	97 -
Tabela 13: Anëtarësia e Partive Politike në Shqipëri (% e votave):	97 -
Tabela 14: Anëtarësia partiake në Shqipëri si përqindje e votave partiake	98 -
Tabela 15: Të ardhurat nga anëtarësia dhe deputetët për periudhën 2011-2013	128 -
Tabela 16: Tabelë përmbledhëse mbi rregullat e financimit të Partive Politike në Shqipëri: 1991-2013	138 -
Tabela 17 : Pasqyra e të Ardhurave të Partive Politike në Fushatën Elektorale 2009:..-	153 -

Tabela 18: Pasqyra e të Ardhurave të Partive Politike në Fushatën Elektorale 2011-	154 -
Tabela 19: Pasqyra e të Ardhurave të Partive Politike në Fushatën Elektorale 2013-	155 -
Tabela 20: Pasqyrimi i të ardhurave vjetore të Partive Politike në periudhën 2011 - 2013.... -	156 -
Tabela 21: Të ardhurat nga kuotizacioni për partitë politike në periudhën 2009-2013.-	161 -
Tabela 22: Tabelë Përmbledhëse për Sistemin Partiak dhe Lulahshmërinë e Elektoratit-	176 -
Tabela 23: Zgjerimi i mbulimit të territorit të Republikës me sinjale të operatorëve kombëtare radio televizivë	184 -

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

PD	Partia Demokratike
PR	Partia Republikane
PLL	Partia Lëvizja e Legalitetit
PBK	Partia Balli Kombëtar
BL	Bashkimi Liberal
PDK	Partia Demokristiane
PDR	Partia Demokratike e Re
PBKD	Partia Bashkimi Kombëtar Demokratik
BLD	Bashkimi Liberal Demokrat
LZHK	Lëvizja për Zhvillim Kombëtar
PBD	Partia Bashkimi Demokrat
PDIU	Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet
PAD	Partia Aleanca Demokratike
PS	Partia Socialiste
LSI	Partia Lëvizja Socialiste për Integrim
PSD	Partia Social Demokrate
PDSSH	Partia Demokracia Sociale Shqiptare
PBDNJ	Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut
PAASH	Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë
G99	G99

KAPITULLI I. HYRJE – SISTEMI PARTIAK DHE STRUKTURA E ORGANIZIMI I PARTIVE POLITIKE NË VENDET POST-KOMUNISTE.

1.1 Qëllimi i Punimit

Rënia e komunizmit në Evropë u shoqërua me një sërë fenomenesh, ku ndër më të rëndësishmet padyshim mund të përmendet shfaqja e partive politike që nuk mëtojnë të unifikojnë trupin politik të popullit rreth një të vërtete universale, karakteristike intrinsike kjo e partive komuniste, por përkundrazi krijojnë ose së paku tentojnë të krijojnë një ndarje të shoqërisë në vija ideologjike, përkatësi shoqërore, identitete etnike dhe kombëtare. Shfaqja e partive politike në vendet post-komuniste ndodhi në një kohë kur simotrat e tyre në perëndim kishin krijuar tashmë një të shkuar të pasur me ndryshime radikale në strukturën dhe organizimin e tyre, ndryshime këto që reflektuan revolucionin politik, ekonomik dhe shoqërore që përfshiu Perëndimin në fundshekullin e 19-të dhe shekullin e 20-të.

Në periudhën post-komuniste, u mendua se, në kontekstin e demokratizimit, shumë prej partive të Evropës Lindore dhe Qendrore do të shkonin drejt modeleve perëndimore. Madje një pjesë e studjuesve menduan se këto parti do të kapërcenin fazat e hershme të zhvillimit të partive politike në Evropën Perëndimore dhe do të përqafonin modelin amerikan të tipit ‘kap-gjithçka’ (Gross, 1992 në Webb & White, 2007: 5). Ky arsyetim u mbështet në argumentimin se komunizmi kishte niveluar të gjitha dallimet socio-ekonomike, duke e bërë të vështirë në mos të pamundur krijimin e organizatave që do të

organizonin apo mobilizonin interesat e grupeve të ndryshme të shoqërisë, duke qenë se këto grupe nuk ekzistonin (Bielasiak, 2002:189-90).

Tashmë, njëçerek shekulli pas rënies së komunizmit, literatura mbi partitë politike në vendet post-komuniste është shumë e pasur dhe studjuesit përgjithësisht kanë konkluduar se partitë politike në këto vende shfaqin tipare të simotrave të tyre në perëndim, pra janë më afër shtetit sesa shoqërisë dhe janë të orientuara drejt elektoratit dhe jo anëtarësisë. Përgjithësisht studjuesit bien dakort se faktorë të tillë si kultura e trashëguar ‘anti-parti’, mungesa e identiteteve të qarta shoqërore dhe ekonomike, dobësia ose inekzistenca e shoqërisë civile dhe e grupeve të interesit, rëndësia relative e shtetit si një bazë kryesore burimore për partitë politike, natyra ‘fluide’ e elektoratit, prirja që kanë partitë të krijohen prej ‘së brendshmi’, pra prej elitave politike të tranzicionit, dhe jo prej ‘së jashtmi’ mbi bazë të lëvizjeve sociale si edhe rritja e rëndësisë së medias elektronike janë faktorët që kanë ndikuar në krijimin e partive të orientuara drejt shtetit dhe jo drejt shoqërisë (Hanley, 2007: 2).

Për sa i përket sistemit partiak në vendet post-komuniste, ai karakterizohet nga nivele të larta paqëndrueshmërie (Rose et al. 1998; Toka 1998; Lewis 2000; Birch 2001; Sikk 2005; Tavits 2005). Një vëzhgim i shpejtë i qeverive të këtyre vendeve tregon se ka veçse pak raste ku e njejta qeveri drejton vendin në periudha konsektive, dhe prej qindra partive që kanë konkuruar në zgjedhje në më shumë se dy dekadat e fundit, më pak se një e katërta e këtyre partive ka ruajtur një prani të qëndrueshme në parlament. Kjo panoramë bie në fakt ndesh me pritshmëritë sipas të cilave partitë post-komuniste dhe sistemet partiake në këto vende kanë prirjen që të shkojnë drejt konsolidimit dhe stabilizimit (Agh 1998; Olson 1998a; Lewis 2001a; Casal Bertoa 2012).

Por cili është sistemi partiak dhe cila është struktura dhe organizimi i partive politike shqiptare? A karakterizohet ky sistem nga të njëjtat tipare dhe a shfaqin partitë politike shqiptare të njëjtat tipare të simotrave të tyre në Perëndim apo në vendet post-komuniste? Qëllimi kryesor i këtij punimi është ta adresojë këtë pyetje duke hulumtuar tiparet e sistemit partiak shqiptar gjatë periudhës 1991-2013 si edhe duke ekzaminuar partitë relevante (Sartori, 1976) në këtë sistemin partiak përgjatë të njëjtës periudhë kohore. Me tipare të sistemit partiak në këtë punim kuptohet numri efektiv i partive si edhe luhatshmëria e elektoratit.

Tiparet e sistemit partiak studjohen për të kuptuar se cilat janë partitë që do të merren në shqyrtim dhe ç'raporte qëndrueshmërie apo paqëndrueshmërie kanë ato me elektoratin. Mbijetesa e partive në skenën politike është një indikator që tregon se një numër i konsiderueshëm votuesish të partisë nuk e ndryshojnë zgjedhjen e tyre nga njëra palë zgjedhje në tjetrën. Për të patur një rezultat të tillë, partitë politike u sigurojnë votuesve të tyre incentiva. Sipas Lipset dhe Rokkan (1967) këto incentiva janë afat-gjata: partia që përfaqëson një grupim të caktuar shoqëror përfaqëson interesat e këtij grupi, dhe politikatat e qeverisë të ndërmarra nën këtë këndvështrim shpërblejnë në afat-gjatë anëtarët e grupit. Megjithatë, mjedisi zgjedhor i vendeve post-komuniste nuk e bën aspak të lehtë këtë gjë: lidhjet e dobëta shoqërore të partive nuk i ofrojnë kushtet për të patur një identifikim dhe pozicionim partiak të votuesit; trajtat e paqarta të konkurimit e bëjnë dimension ideologjik mbi politikatat jo shumë relevant; dhe mungesa e besnikërisë së elitave redukton vazhdimësinë e lidërshiptit (Gherghina, 2012: 3).

Partitë politike post-komuniste nuk kanë shumë mjete për të mobilizuar elektoratin. Duke qenë se organizatat partiake krijojnë porta efektive komunikimi me elektoratin

(Adams et al. 2005), partitë politike mund t'i përdorin këto organizata për të stabilizuar elektoratin e tyre (Gherghina, 2012:3). Pikërisht këtu qëndron edhe lidhja ndërmjet sistemit partiak dhe strukturës dhe organizimit të partisë. Një sistem partiak i qëndrueshëm është një indikator i një partie të organizuar mirë në terren. Megjithatë në mungesë të ndarjeve të qarta ideologjike, incentivat për të krijuar atashime të forta mes elektoratit dhe partisë nuk janë programatike por klienteliste (Kitschelt, 1995). Në këtë kontekst unë argumentoj dhe testoj tezën sipas së cilës *partitë politike shqiptare janë parti masash klienteliste, me shtrirje të gjerë në terren por që nuk financohen nga anëtarësia, por përdorin pushtetin shtetëror për të shpërblyer anëtarësinë dhe simpatizantët për mbështetjen e marrë në kohë fushate. Ato janë të centralizuara në qendër duke lënë pak hapësirë për organizatën bazë në lidhje me procesin e vendimmarrjes.*

Për ta vërtetuar këtë tezë janë ndërmarrë tre hapa: a) përcaktimi i numrit efektiv të partive dhe përcaktimi i luhatshmërisë së sistemit partiak; b) shpërndarja e brendshme e pushtetit dhe analiza e rolit të anëtarësisë në partitë e marra në shqyrtim si edhe; c) identifikimi i burimeve të financimit të partive politike.

Numri efektiv i partive na ndihmon për të kuptuar se cilat janë partitë që do të merren në shqyrtim dhe në të njëjtën kohë flet për stabilitetin ose luhatshmërinë e sistemit partiak. Ndërsa luhatshmëria elektorale e mat sistemin në nivel elektorati, numri efektiv i partive e mat atë në nivel përfaqësimi parlamentar. Të ndërthurura së bashku ato na ndihmojnë të kuptojmë se ç'lidhje kanë partitë politike me elektoratin dhe cila është aftësia e tyre për ta menaxhuar atë. Një indeks partiak stabël shoqërohet me *luhatshmëri në bllok* (shih kapitullin 3) të ulët, dhe me luhatshmëri elektorale partiake të ulët. Ndërsa një indeks partiak i paqëndrueshëm shoqërohet me luhatshmëri elektorale partiake të lartë, por me dy

mundësi për sa i përket luhatshmërisë në bllok. Kur kjo luhatshmëri në bllok është e lartë, atëherë kemi të bëjmë me një sistem partiak të paqëndrueshëm, dhe me parti që nuk e kontrollojnë dot zgjedhjen e votuesve. Por në rast se luhatshmëria në bllok është e ulët atëherë, kjo tregon se aktorët politikë janë të aftë të alterojnë zgjedhjen e votuesve sipas preferencave të tyre, gjë që flet për lidhje të forta të partisë me elektoratin, lidhje që nuk vijnë si pasojë preferencave programatike (shih Lami, 2013 për paqartësiën ideologjike të elektoratit shqiptar), por përmes lidhjesh personale.

Balanca e brendshme e pushtetit na ndihmon të kuptojmë se ku është i përqëndruar pushteti vendimmarrës në parti: në krahun jashtë-parlamentar apo në atë brenda-parlamentar. Një krah jashtë-parlamentar i fortë tregon se partia është më e rëndësishme sesa përfaqësuesit politik në parlament apo në ekzekutiv të qeverisë, dhe kjo tregon se karriera politike kalon dhe mbi të gjitha ruhet përmes partisë. Po kështu një krah jashtë-parlamentar më i fuqishëm tregon se partia kërkon të ruajë depërtimin territorial në elektorat, ka më tepër besim tek elektorati sesa tek elitat politike të cilat në çdo moment mund të largohen dhe liderët e partisë e kanë përzgjedhur këtë strategji për të ruajtur kohezionin e partisë nga përçarjet, shkëputjet, krijimet e partive të reja që kanë qenë tipike për vendet post-komuniste. Përveç analizës së brendshme të pushtetit, struktura e brendshme organizative e partisë përveçse ka lidhje drejtpërsëdrejti me pyetjen kërkimore, na ndihmon për të kuptuar rolin që luan anëtarësia në parti. Një rol i kufizuar i anëtarësisë në vendimmarrje i shoqëruar me krah jashtë-parlamentar të fuqishëm, tregon se kontrolli i partisë është i centralizuar dhe se lidhjet mes partisë në qendër dhe asaj në bazë nuk janë lidhjet që karakterizojnë partitë e masave por lidhje që karakterizojnë partitë klienteliste, ku

elitat politike rekrutojnë ‘klientelë’ për të siguruar depërtim territorial dhe për të siguruar qëndrueshmëri elektorale.

Së fundmi, financat e partive na ndihmojnë të kuptojmë se sa të rëndësishme janë për partitë politike të ardhurat që vijnë prej anëtarësisë. Kur këto të ardhura zënë një përqindje të rëndësishme atëherë ky është një indikator që tregon se partitë politike mbështeten kryesisht tek anëtarësia. Por në rast se ato janë të parëndësishme në raport me shpenzimet e partisë atëherë kjo tregon se partitë politike nuk janë parti masash. Në rast se kuotizacione të ulëta anëtarësie shoqërohen me nivele të larta anëtarësimi partiak, atëherë kjo tregon se lidhjet e partisë me anëtarët nuk janë të tipit të partisë së masave, por janë lidhje klienteliste, ku anëtarësia i duhet partisë jo për të siguruar fonde por për të depërtuar territorialisht, dhe kjo anëtarësi pret në këmbim shpërblime në formë favoresh në rast se partia fiton.

1.2 Pse Shqipëria?

Studimet e shumta mbi vendet post-komuniste tashmë kanë treguar se historia dhe dinamikat e sistemit partiak në to është e ndryshme nga ajo e vendeve të Evropës Perëndimore. Tre tipare në nivel makro – procesi i formimit të partive politike, mjediset politike të paqëndrueshme dhe elitat e pamobilizuara – janë kyçe për të treguar se faktorët e lidhur me ndarjet shoqërore (Lispert dhe Rokkan, 1967) nuk kanë ndonjë fuqi shpjeguese në lidhje me luhatshmërinë e elektoratit në këto vende (Gherghina, 2012:4). Regjimet komuniste, përmes ideologjisë së tyre egalitare niveluan çdo lloj diferencimi shoqëror të madh që mund të ekzistonte (van Biezen, 2003: 35-36). Për pasojë ndarjet shoqërore aq të tipike për vendet e Evropës Perëndimore nuk gjejnë hapësirë në vendet post-komuniste. Për

pasojë, duke qenë se partitë nuk mund t'u drejtoheshin identiteteve kolektive të ndryshme të formuara si pasojë e këtyre çarjeve në shoqëri, formimi i tyre do të duhej të gjente arsye të tjera. Andaj, në këto vende partitë u krijuan mbi bazë të sjelljeve kundrejt aspekteve institucionale në lidhje me ndryshimin e regjimit (van Biezen, 2003). Kjo gjë shpjegon edhe pse në këto vende u shfaq më shumë se një parti anti-komuniste, të cilat synonin të njëjtin grupim shoqëror (p.sh. të përndjekurit politik).

Për shkak të mungesës së çarjeve shoqërore, pjesa më e madhe e partive të vendeve post-komuniste nuk origjinojnë prej shoqërisë por kanë origjinë institucionale. Kjo situatë e bën të vështirë identifikimin e ndarjes tradicionale e djathtë-e majtë në konkurrencën partiake. Megjithatë mungesa e këtyre çarjeve shoqërore që shoqërohen me dallime ideologjike dhe shoqërore nuk nënkupton se zgjedhësit nuk kanë mundësi të zgjedhin (Gherghina, 2012 : 4). Përkundrazi elektorati i vendeve post-komuniste është i hapur dhe i luhatsëm dhe rrallë karakterizohet nga ndonjë identifikim partiak (Rose dhe Mishler, 1998; Millard 2004). Përgjithësisht votohet për të shpërblyer apo dënuar sjelljen e partive politike. Zhvendosjet e vazhdueshme të votave nga njëra parti-tek tjera nga njëra palë zgjedhje në tjetrën, flasin për një identifikim të dobët të elektoratit me partitë politike, dhe janë gjithashtu indikator se alternativat e reja politike mund të gjejnë elektorat për t'i mbështetur (Gherghina, 2012: 5).

Luhatshmëria e mbështetjes politike në vendet post-komuniste mund të kuptohet edhe në kontekstin e dy perspektivave në nivel makro që kanë të bëjnë me prirjet globale dhe zhvillimet e teknologjisë. Së pari, partitë politike post-komuniste u shfaqën në një periudhë kur edhe vendet e Evropës Perëndimore, dikur të qëndrueshme (Bartolini dhe Mair,1990) u karakterizuan nga një luhatshmëri e elektoratit. Pra, edhe në sistemet partiake

ku preferencat politike ishin të qëndrueshme, votuesit i modifikuan preferencat e tyre. Së dyti, këto parti i kapërcyen fazat e zhvillimit të partive të Evropës Perëndimore (nga parti masash që komunikonte me elektoratin përmes anëtrësisë dhe organizatave bazë) në parti që patën akses të menjëhershëm në burimet moderne (van Biezen, 2003). Ato u shfaqën në një periudhë kur media ishte zhvilluar shumë dhe kish kanale të shumta informacioni, kur sondazhet janë një metodë gjerësisht e përdorur për të matur opinionin publik dhe kur votuesit kanë nivel arsimimi më të lartë në krahasim me paraardhësit e tyre. Pavarësisht avantazhit të qartë që një kontekst i tillë paraqet për partitë politike (p.sh. komunikim më i efektshëm, vizibilitet më i lartë i partisë para elektoratit), partitë politike jo gjithmonë përfitojnë nga to. Duke qenë se elektorati ka më shumë informacion për partitë në garë, e ka më të gjerë spektrin e zgjedhjes, duke shkaktuar kështu luhatje të mëdha elektorale (Gherghina, 2012: 5).

Një kontekst i tillë shpjegon se pse faktorët e lidhur me ndarjet/çarjet në shoqëri, të rëndësishme për vendet e Evropës Perëndimore nuk mund të shpjegojnë atashimin e elektoratit me njërin parti apo tjetrën dhe as strategjitë e organizimit të partive politike në vendet post-komuniste, dhe për pasojë edhe në Shqipëri.

Megjithatë, historia e partive politike shqiptare shfaqet e ndryshme edhe nga vetë ajo e vendeve post-komuniste. Dhe pikërisht kjo e bën edhe interesant dhe të rëndësishëm për t'u studjuar rastin shqiptar.

Së pari, analizat për partitë politike në vendet post-komuniste kanë dalë nga studimi mbi vende të tilla si Hungaria, Polonia, Sllovakia, Çekia dhe ca më pak Bullgaria dhe Rumania. Në fakt vendet e mësipërme kanë marrë gjithmonë pjesën e luanit përse i përket studimeve mbi partitë politike në vendet post-komuniste. Megjithatë, në vazhdim të së

njëjtës logjikë të teorisë së rrugës së varësisë sipas së cilës “rruga drejt demokracisë dhe veçoritë e formimit të partive janë ngushtësisht të lidhura me njera-tjetrën, ku e para ka një ndikim kritik mbi strategjitë e mundshme për organizimin partiak” (van Biezen, 2003: 19), për shkak të rrugëve të ndryshme drejt demokracisë që këto vende kanë ndjekur në raport me Shqipërinë, atëherë edhe partitë politike shqiptare me shumë gjasa do të duhej të shfaqnin tipare të ndryshme jo vetëm nga simotrat e tyre në përfundim por edhe nga vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore me të cilat e lidh e shkuara komuniste. Sipas Kitschelt et al. (1999) e shkuara e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore kushtëzon profilin e partive politike që shfaqen në këto vende me rënien e komunizmit. Këto vende klasifikohen në tre kategori: komunizëm burokratiko-autoritarian, komunizëm patrimonial dhe komunizëm kombëtar (për më shumë detaje shih Kapitullin 2). Ndërsa vendet e mësipërme sipas këtij klasifikimi i përkasin vendeve të komunizmit burokratiko-autoritarian që janë të afta të krijojnë parti programatike apo atij kombëtar ku partitë janë të distancuara nga e shkuara komuniste, Shqipëria klasifikohet në vendet e komunizmit patrimonial ku dimensionin e ndarjes programatike është i mjegullt, konkurrenca politike mbetet e personalizuar dhe partitë anti-komuniste i kanë rrënjët tepër të dobëta për të prodhuar një alternativë të besueshme kundrejt kampit politik hegjemon të (ish) partisë komuniste e cila vërtitet rreth populizmit ekonomik.

Në këtë kontekst, duke qenë se konceptet e rrugës së varësisë (Mahoney, 1991; 2000; 2001) dhe momentit kritik (Pierson, 2000; 2004) janë intrinsike për të shpjeguar se pse strategjitë për t’u strukturuar dhe organizuar janë të ndryshme në vendet post-komuniste prej vendeve të Evropës Perëndimore (van Biezen, 2003), të njëjtat koncepte

janë të vlefshme se pse këto strategji janë të ndryshme në rastin e Shqipërisë prej vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore.

Së dyti, mass-media, dhe më konkretisht televizioni është një tjetër faktor i rëndësishëm që ka influencuar strukturën dhe organizimin e partive politike në demokracitë e reja. Studjuesit (Panebianco, 1988; Katz & Mair, 1995) e kanë analizuar tashmë rolin që ka luajtur mass-media në ndryshimin e komunikimit të partive politike me mbështetësit dhe elektoratin e tyre. Ndërsa Duverger (1954) identifikoi anëtarët si një mekanizëm të nevojshëm për të transmetuar mesazhin e udhëheqësve partiake ndaj shoqërisë, pasardhësit e tij vunë në dukje se një mekanizëm i tillë transmissioni nuk ishte më i nevojshëm në epokën e komunikimit masiv. Përmes mjeteve të komunikimit masiv, udhëheqësit politikë tashmë mund të komunikojnë drejtpërdrejt me elektoratin pa përdorur mekanizmin e transmetimit të mesazhit përmes degëve dhe anëtarësisë që për më tepër kërkon edhe shumë kohë. Por, van Biezen argumenton se sekuenca e zhvillimit të ngjarjeve është e rëndësishme. Duke qenë se partitë politike në demokracitë e reja patën mundësi ta përdornin komunikimin masiv përpara se sa të organizoheshin si parti masash, ato nuk investuan as kohë dhe as fonde për të organizuar partinë e masave. Pra, në vendet post-komuniste, komunikimi masiv e dëmtoi procesin e krijimit të partisë së masave dhe nevojën e partisë për t'u shtrirë territorialisht (2003, 41).

Megjithatë nuk vihet re i njëjti skenar edhe në Shqipëri. Gjatë viteve të para të tranzicionit media në Shqipëri vazhdoi të reflektonte sjelljet e fituara gjatë periudhës së komunizmit. Ajo e pati të vështirë të emancipohet dhe të transformohej nga një institucion partiak në një institucion të pavarur (Godole, 2014:70). Dekada e parë e post-komunizmit karakterizohet nga mbizotërimi i Televizionit Shqiptar, të vetmit televizion që arrinte të

mbulonte të gjithë territorin, por që në të njëjtën kohë duke qenë tërësisht në kontroll të shtetit (Fuga, 2008: 434 – 435), u karakterizua nga një mungesë paanshmërie duke favorizuar gjithmonë partinë në pushtet, sidomos gjatë fushatave elektorale (OSBE, 1996, 8-9). Radiotelevizioni konsiderohej nga opozita, si një instrument manipulues i opinionit publik, mjet propagande në duart e partisë që kontrollonte pushtetin shtetëror. (Fuga, 2008: 434-435). Në këtë kontekst partive opozitare u duheshin kanale të tjera komunikimi për të përçuar mesazhin e tyre në të gjithë territorin e vendit, andaj ato nuk mund ta injoronin shtrirjen e tyre territoriale në të gjithë vendin.

Sigurisht, që ekzistenca e mediave të pavarura do ta lehtësonte komunikimin e mesazhit tek elektorati, por këto media u shfaqën në Shqipëri në fund të viteve 90-të, dhe e arritën konsolidimin e tyre vetëm pas viteve 2000 (Godole, 2014: 78-79) ku edhe numri i tyre u rrit ndjeshëm. Megjithatë edhe pse në numër të madh, televizionet e pavarura vetëm në gjysmën e dytë të viteve 2000, filluan të mbulonin me transmetime pjesë të mëdha të territorit. Në Anex 1, shihet Tabela e mbulimit të territorit të Republikës me sinjale të operatorëve kombëtare radio televizivë (AMA, 2012 :57-58). Kjo gjë tregon se në pothuaj gjithë dekadën e parë, partitë politike nuk mund të mbështeteshin tek Televizioni Shtetëror, andaj u duhej të mendonin për kanale të tjera komunikimi me elektoratin, dhe depërtimi territorial organizacional mbetej alternativa e vetme. Andaj, përkundër asaj që pretendon van Biezen (2003), në rastin shqiptar, media nuk mund të veprojë si faktor ndikues në strukturën e partive politike shqiptare për ti orientuar ato drejt elektoratit dhe jo anëtarësisë, ashtu siç ka ndodhur me vendet post-komuniste të Evropës Qendrore (Xhaferaj, 2015).

Arësyeja e tretë që e bën Shqipërinë interesante për t'u studjuar për sa i përket partive politike dhe sistemit partiak është se ka një vakuum për sa i përket studimit të

këtyre partive nga pikëpamja e strukturës dhe organizimit dhe lidhjes që ekziston mes tyre dhe sistemit partiak. Janë një sërë punimesh akademike në lidhje me partitë politike shqiptare të cilat janë fokusuar në linja të tilla si aspekti historik i zhvillimit të tyre dhe rezultateve zgjedhore (Krasniqi, 2006, 2009; Bugajski, 2002), lidhja mes sistemit elektoral dhe atij partiak (Çili, 2002; Çeka, 2013), partitë e reja dhe të vogla (Këlliçi, 2012), faktorët që kanë çuar në mbijetesën e Partisë Demokratike në Shqipëri (Xhaferaj, 2012) si edhe lidhja parti politike – ideologji (Lami, 2012). Megjithatë ka një dakortësim të përgjithshëm se partitë politike shqiptare janë parti masash (Çili, 2002; Kajsio, 2004; 2005; Xhaferaj, 2012; Krasniqi & Hackaj, 2014: 45)¹, dakortësim që ky punim kërkon ta rrëzojë duke provuar se partitë politike shqiptare janë në fakt parti masash klienteliste: me depërtim të thellë territorial por që vendosin marrëdhënie klientelizmi me anëtarësinë.

Pra veçantësia e Shqipërisë në raport me rastet e studjuara tashmë në vendet post-komuniste dhe pamjaftueshmëria e studimeve mbi rastin e Shqipërisë janë arësyet se përse Shqipëria u përzgjedh si rast studimor.

1.3. Cila është Risia?

Literatura mbi strukturën dhe organizimin e partive politike deri më tani është fokusuar kryesisht në analizën e brendshme të pushtetit, burimet e financimit të partive politike, lidhjen e partive politike me shoqërinë (van Biezen, 2003), kontinuitetin e elitave politike (Hanley & Szczerbiak, 2001; Gherghina, 2012), megjithatë deri më sot pak studime janë bërë në lidhje me strukturën dhe organizimin e partisë dhe ndryshimet që kjo strukturë mund

¹ Krasniqi dhe Hackaj arsyetojnë se vetëm pas vitit 2009, partitë politike shqiptare kanë filluar të rrëshkasin drejt modelit të partisë elektorale.

të prodhojë në nivel sistemi partiak. Gherghina (2012) argumenton se organizimi dhe struktura e partisë mund të luajë një rol të rëndësishëm për të shpjeguar sjelljen elektorale. Megjithatë, ajo që mungon është pikërisht shpjegimi i dallimit të madh që ekziston ndërmjet luhatshmërisë partiake dhe asaj në bllok. Bartolini dhe Mair (1990) në studimin e tyre të tipit *long dure* mbi luhatshmërinë e elektoratit evropian në periudhën 1885-1985 vunë re se për të kuptuar nëse ka ose jo qëndrueshmëri sistemi partiak është më e vlefshme të matet luhatshmëria në bllok dhe jo ajo në nivel partiak. Megjithatë ata e shpjegojnë se dallimi ndërmjet luhatshmërisë në bllok dhe luhatshmërisë në nivel partiak vjen për shkak të besnikërisë elektorale ndaj ideologjisë por jo ndaj partisë, që do të thotë, se votuesit i ruajnë preferencat e tyre ideologjike por mund të votojnë për parti të ndryshme që i përkasin të njëjtit bllok. Ndërkaq, Shqipëria, ashtu sikundër të gjitha vendet post-komuniste, nuk ka parti të ndërtuara në vija ideologjike të pastra dhe pavarësisht luhatshmërisë së lartë elektorale, sistemi partiak ka mbetur i qëndrueshëm. Kjo është edhe një ndër pikat që kërkon të sqarojë punimi, e parë gjithmonë në funksion të strukturës dhe organizimit të partisë politike. *Punimi hipotetizon dhe teston se dallimi i madh ndërmjet luhatshmërisë në nivel partie dhe luhatshmërisë në bllok, në mungesë të çarjeve shoqërore që do të prodhonin parti programatike, shkaktohet prej zhvendosjes së elektoratit sipas udhëzimeve të krerëve të partive politike. Një zhvendosje e tillë kërkon një marrëdhënie të fortë me elektoratin, pra një depërtim territorial, por jo atashim ideologjik. Gjë që është karakteristikë e partisë klienteliste të masave.*

Punimi synon të kap thelbin e marrëdhënies ndërmjet organizimit partiak dhe elektoratit. Ai e kalon nivelin e analizës nga sistemi partiak tek partia, duke investiguar se ç'ndodh brenda sistemit. Partitë politike përfaqësojnë njësitë bazike të ndërveprimit dhe

ndryshimit në një sistem politik. Ato janë agjentët kryesorë të përfaqësimit dhe konkuresit kryesor në zgjedhjet legislative. Për pasojë, është e rëndësishme të shihet dhe shpjegohet në nivel partie se si ndodh zhvendosja e votave nga një parti në tjetrën.

Për rastin e Shqipërisë Çili (2002) dhe Kajsiu (2004; 2005) argumentojnë se është sistemi elektoral ai që kushtëzon partitë politike. Megjithëse ka përpjekje për të provuar se në tensionin agjenci-strukturë, partitë politike shqiptare ja dalin të formësojnë strukturën (Xhaferaj, 2012), ende nuk është studjuar se si lidhen këto ndryshime me strukturën dhe organizimin e partive politike. Dhe pikërisht këtu qëndron edhe risia e punimit. Përveçse studjon luhatshmërinë e elektoratit shqiptar në zgjedhjet e përgjithshme, studimi njëkohësisht studjon edhe fragmentizimin e sistemit partiak. Çeka (2013) ka studjuar gjithashtu luhatshmërinë e elektoratit shqiptar (të cilën ai e quan indeks të disproporcionalitetit) por autori e mat atë vetëm në nivel partiak për partitë politike që kanë marrë pjesë në parlament. Ndërsa ky punim mat luhatshmërinë e elektoratit për të gjitha partitë që kanë marrë pjesë në zgjedhje, dhe përveç kësaj mat edhe luhatshmërinë në bllok (sipas rregullave të propozuara nga Bartolini dhe Mair, 1990) që përveçse jep një panoravë më të qartë mbi qëndrueshmërinë ose jo të elektoratit, në të njëjtën kohë na jep mundësinë të kuptojmë se pse luhatshmëria e elektoratit është e madhe ndërsa sistemi partiak është i qëndrueshëm.

Pikërisht kjo ‘çarje’ midis luhatshmërisë në bllok dhe luhatshmërisë në nivel partie shërbejnë si indikatorë për të treguar se orientimi i elektoratit përcaktohet në nivel elitash politike të cilat ‘tregtojnë’ pjesë të elektoratit të tyre për të ruajtur status-quonë. Megjithatë një orientim i tillë i saktë kërkon një depërtim të thellë në elektorat. Dhe marrëdhënie të tilla të forta mes udhëheqjes dhe elektoratit, jo për shkak të afinitetit ideologjik, janë tipare

të partisë klienteliste të masave. Përveç kësaj, risia tjetër e punimit është se bën një analizë të financave të partisë dhe të shpërndarjes së brendshme të pushtetit. Të dy këta komponentë janë të rëndësishëm për të kuptuar rolin e anëtarësisë në organizatë dhe për të përforcuar premisën paraprake që kemi se zhvendosje të mëdha të elektoratit mund të menaxhohen vetëm nga partitë klienteliste të masave.

1.4 Metodologjia

Në qasjen e tij, punimi ndjek një metodologji të përzier, sasiore dhe cilësore dhe është i natyrës së testimit të teorisë. Ai bazohet në literaturën klasike dhe bashkëkohore mbi tipologjitë e partive politike, sistemin partiak dhe luhatshmërinë e elektoratit në Evropën Perëndimore dhe në vendet post-komuniste.

Është e vërtetë se literatura mbi organizimin e partive politike në Evropën perëndimore mbështetet gjerësisht në analizimin e ndryshimit të strukturave sociale në shoqëri dhe për pasojë tipologjitë partiake, më tepër se sa modele organizimi partiak, reflektojnë modele të *ndryshimit* partiak. Partitë e ndryshojnë organizimin e tyre të brendshëm si rezultat dhe si përgjigje ndaj ndryshimeve strukturore të shoqërisë (Mair et.al., 2004:11). Siç komenton edhe Katz dhe Mair ‘zhvillimi i partive në demokracitë perëndimore ka reflektuar një proces dialektik në të cilin secila tipologji partiake gjeneron një reaksion që stimulon zhvillime të mëtejshme, duke çuar kështu drejt një tjetër tipologjie partiake, dhe drejt një tjetër reaksioni e kështu me rradhë’ (1995:6). Për pasojë tipologjitë perëndimore mbi organizimin partiak reflektojnë një proces ndryshimi partiak, në të cilin secila tipologji merr si pikë nisjeje një tipologji të mëparshme.

Për rrjedhojë, pjesa më e madhe e modeleve të organizimit partiak përqendrohen mbi analizën e shkallës dhe drejtimit të adaptimit, ndryshimit dhe transformimit organizacional partiak. Megjithatë ajo ç'ka mungon është një teori e *formimit* të partisë, teori e cila do të mund të përdorej për të analizuar edhe raste të tjera. E njëjta logjikë e përdorur prej LaPalombra dhe Weiner (1966) se 'është e nevojshme të bëhen teorizime të rëndësishme [...] sepse përpjekja e Duvergerit për t'i gjurmuar fazat e hershme të zhvillimit të partisë në fazën e shfaqjes së parlamenteve dhe sistemeve elektorale pothuajse, nuk mund të aplikohet fare në rastet e tjera' (në van Biezen, 2003:8), është e vlefshme edhe për partitë në demokracitë e reja. Ndonëse tema e rrugës së varësisë dhe momentit kritik (Mahoney, 2000; 2001; Pierson, 2004) është gjerësisht e përdorur në vendet post-komuniste, ajo jo-domosdoshmërisht gjen shpjegim në rastin shqiptar (Xhaferaj, 2013:308). Ndërsa ajo mund të aplikohet në rastin e Partisë Socialiste, e cila kishte një të shkuar të saj kur ndodhi momenti kritik në vitin 1990 (përmbysja e sistemit), ajo nuk mund të aplikohet në rastin e partive të tjera të cilat u krijuan pas vitit 1990.

E megjithatë për ta bërë të mundur analizën është e nevojshme ta lëmë mënjanë 'problematikën' e transformimit/ndryshimit që i shoqëron këto tipologji, dhe t'i përdorim si modele analitike duke qenë se ato janë të vetmet që kemi. Për të evituar problematikën e përdorimit të këtyre modeleve në tërësinë e tyre, unë i kam 'çmontuar' në elementët përbërës duke qenë se këta element reflektojnë karakteristikat organizacionale të partisë.

Literatura aktuale mbi studimin e organizimit të partive politike në vendet post-komuniste ka 'ecur' nëpër dy 'shina'. Njëra qasje i jep një rëndësi të veçantë kontekstit institucional në të cilin shfaqen dhe fillojnë të operojnë partitë politike, duke analizuar kështu edhe oportunitetet dhe kufizimet që ky kontekst u ofron këtyre partive në strategjitë

e tyre për organizim dhe mobilizim politik (Kitschelt et.al., 1998; Grzymala-Busse, 2002; van Biezen, 2003). Ndërsa qasja tjetër i jep më tepër përparësi agjentit sesa strukturës dhe e shikon partinë si një forcë institucionale të pavarur që vepron mbi ambjentin politik, social dhe ekonomik (Harmel dhe Janda, 1994; Hanley et.al.,2007; 2008). Sipas tyre, ndryshimi i partisë ndodh si pasojë e ‘ndryshimit të kryesisë së partisë, e ndryshimit të një fraksioni dominues brenda partisë ose edhe si pasojë e një stimuli të jashtëm’ (Harmel dhe Janda në van Biezen, 2003:15). Pra mund të thuhet se qasjet aktuale kanë krijuar një tension agjenci-strukturë ku për raste të ndryshme njëra qasje ka më tepër fuqi shpjeguese se tjetra.

Në këtë punim, megjithatë perspektiva teorike është se sjellja e udhëheqësve të partisë dhe strategjitë partiake nuk mund të jenë të pavarura nga konteksti strukturor në të cilin shfaqet partia. Pra punimi mbështetet në premisën e qasjes institucionaliste sipas së cilës strategjitë partiake formësohen si nga konteksti historik ashtu edhe nga momenti historik në të cilin shfaqen dhe fillojnë të operojnë. Mjedisi në të cilin fillon të operojë partia është faktori kryesor përgjegjës që përcakton se ç’lloj organizate do të shfaqet dhe siç thotë edhe Katz dhe Mair (1990:18) ndryshimi i mjedisit ndodh shpesh të jetë shkaku i fundëm i ndryshimit organizacional. Për ta përmbledhur, mund të thuhet se ndërsa strategjitë e formimit dhe ndryshimit të partisë mund të jenë kontigjent dhe subjekt i zgjedhjes së udhëheqësve, kontigjenca i nënshtrohet gjithashtu kufizimeve strukturore. Andaj edhe studimi i partive politike shqiptare, si ajo që ndryshoi (PS) ashtu edhe ato që u formuan nuk mund ta anshkalojë kontekstin e gjerë në të cilin këto parti u shfaqën.

Në pjesën e tij *empirike*, ky studim fokusohet kryesisht në grumbullimin e të dhënave mbi organizimin e brendshëm të partive të marra në shqyrtim, si p.sh. madhësia dhe struktura e organizatës partiake, balanca e brendshme e pushtetit dhe profili financiar i

partisë. Po kështu për të plotësuar studimin, në punim janë analizuar edhe të dhënat mbi rezultatet në zgjedhjet e përgjithshme, të cilat janë të nevojshme për të kuptuar llojin e sistemit partiak gjatë periudhës 1991-2013 si edhe për të parë se cilat janë partitë që duhet të merren në shqyrtim. Po kështu këto rezultate ndihmojnë për të kuptuar luhatshmërinë e elektoratit. Luhatshmëria e elektoratit është parë si indikator i lidhjes së partisë me shoqërinë. Sa më e ulët kjo luhatshmëri aq më të forta janë këto lidhje dhe e anasjellta. Duke qenë se lidhjet e forta janë tipar i partisë së masave dhe ato të dobëta janë tipar i partive ‘kap gjithkënd’, elektoral profesionale apo kartel ky element është parë si shumë i rëndësishëm, dhe që indikon në mënyrë indirekte se ç’tipologjie partiake i korrespondojnë partitë politike.

1.4 Plani i Punimit

Libri është i ndarë në gjashtë kapituj që shkojnë prej përsiatjeve teorike mbi partitë politike, strukturën dhe organizimin e tyre, sistemin partiak dhe luhatshmërinë e elektoratit deri tek evidencat e rëndësishme mbi partitë politike shqiptare. Në seksionet e mësipërme është folur për konceptet kyçe, hipotezën, synimin e punimit, përcaktuesit kryesor të strukturës dhe organizimit të partisë si edhe indikatorët për matjen e kësaj strukture. Une do t’i rikthehem të gjitha këtyre pikave më në detaje në kapitullin e dytë të punimit.

Kapitulli II fokusohet në literaturën ekzistuese mbi tipologjitë e partive politike në perëndim dhe në vendet post-komuniste, mbi strategjitë që kanë ndjekur këto parti për të mbijetuar, mbi konceptin e sistemit partiak dhe matjen e tij si edhe mbi konceptin e luhatshmërisë së elektoratit, çfarë e karakterizon këtë luhatshmëri si në vendet perëndimore ashtu edhe në vendet post-komuniste dhe nga se shkaktohet ajo. Në këtë kapitull sqarohet

njëkohësisht edhe modeli analitik që do të shërbejë për të provuar hipotezën e punimit. Në modelin analitik jepen përkufizimet e koncepteve si edhe shpjegohen indikatorët me të cilët maten këto koncepte dhe njëkohësisht edhe formulat që do të përdoren për të matur luhatshmërinë e elektoratit, indeksin e fragmentizimit partiak dhe partitë që do të merren në shqyrtim.

Kapitulli III konceptualizon dhe operacionalizon luhatshmërinë e elektoratit, duke përfshirë edhe një përshkrim dhe analizën empirike të tij në Shqipëri për periudhën 1991-2013. Në këtë kapitull konceptualizohet gjithashtu edhe indeksi i fragmentizimit të sistemit partiak i cili më pas analizohet së bashku me luhatshmërinë e elektoratit për të dalë më pas tek konkluzionet.

Kapitulli IV merret me shpërndarjen e brendshme të pushtetit. Analizon statutin e partisë për të kuptuar procesin e vendimm-marrjes brenda partisë. Po kështu analizon raportin anëtarësi elektorat për të kuptuar se ç'shtirje ka partia në vend dhe në të njëjtën kohë shikon se cili krah predominon në parti, ai jashtë-parlamentar apo ai brenda-parlamentar. Predominanca e krahut jashtë-parlamentar do të tregonte se strukturat organizative të partisë janë të fuqishme dhe në këtë rast partia do t'i përngjasonte partisë së masave, por në rast se predominon krahu brenda-parlamentar, atëherë partia nuk mund të jetë parti masash por bie në njërën prej tipologjive: elektoral-profesionale, kap gjithkënd apo kartel.

Kapitulli V i dedikohet analizës së financave të partive politike. Analiza përfshin legjislacionin shqiptar në lidhje me këto financime ku shihet hap pas hapi se si ky legjislacion ka ndryshuar dhe ç'implikime mund të ketë pasur mbi strukturën dhe organizimin e partisë. Po kështu në analizë përfshihen edhe raportet e auditimit të partive

politike të marra në shqyrtim. Këto raporte janë të vlefshme për të kuptuar se ç'përqindje zënë të ardhurat e anëtarësisë në financat e përgjithshme të partisë, dhe kjo është e rëndësishme sepse indikon se ç'marrëdhënie ka partia me anëtarësinë dhe tregon gjithashtu se cilës tipologji partiake i përket partia e marrë në shqyrtim.

Kapitulli i VI-të është njëkohësisht edhe kapitulli i fundit i cili përveçse i jep përgjigje pyetjes se ç'sistem partiak është ai shqiptar dhe cilës tipologji partiake i korrespondojnë partitë politike shqiptare, shtron udhën edhe për një sërë studimesh të tjera në këtë fushë.

KAPITULLI II. SKELETI TEORIK DHE MODELI ANALITIK I TEMËS

Ky kapitull është i ndarë në dy seksione: 2.1 Skeleti teorik; 2.2 Modeli Analitik dhe Të Dhënat dhe Metodat. Në kapitullin e skeletit teorik kemi një përmbledhje të shkurtër të literatures mbi sistemin partiak, luhatshmërinë e elektoratit, tipologjitë e partive politike në Evropën Perëndimore si edhe strategjitë, struktura dhe organizimi i partive politike në vendet post-komuniste. Qasjet që mbizotërojnë janë ato të institucionalizmit historik, sipas arësytimit të bërë në pikën 1.4 të kapitullit hyrës.

2.1. Skeleti Teorik: Sistemi Partiak dhe Tipologjitë e Partive Politike - Struktura dhe Organizimi në Evropën Perëndimore dhe në vendet Post-Komuniste

Sistemi Partiak dhe Luhatshmëria e Elektoratit në vendet e Evropës Perëndimore dhe në vendet post-komuniste

Sistemi partiak mund të përkufizohet si një strukturë ku ndodh konkurimi dhe bashkëpunimi ndërmjet partive politike. Lipset dhe Rokkan (1967) e shohin sistemin partiak si stabël, të krijuar mbi ndarjet shoqërore të fillim shekullit të 20-të, ndarje këto tashmë të ngrira, të pandryshueshme që kanë përcaktuar një herë e mirë ndërveprimin e partive politike (konkurrencë apo bashkëpunim si edhe tematikat mbi të cilat ndodh konkurrenca apo bashkëpunimi) në Evropën Perëndimore të shekullit të 20-të.

Në të njëjtën linjë Bartolini dhe Mair (2007) në studimin e tyre *longue dureé* mbi elektoratin evropain në periudhën 1885-1985 vunë re se ‘atashimet që lidhin elektoratin në një set identitetesh dhe pozicionimesh politike kanë dëshmuar qëndrueshmëri’ (262). Ata vunë re se stabiliteti ose jo i sistemit partiak ishte në varësi të formimit dhe konsolidimit të ndarjeve socio-economike në shoqëri, pozicionimit të partive politike ndaj politikave shtetërore, numrit të partive politike në konkurim, ndryshimeve institucionale si për shembull ndryshimi i sistemit elektoral si edhe pjesëmarrja në votime. Po kështu Pennings dhe Lane, në ndryshim nga ajo që besonte Lipset dhe Rokkan (1967), argumentojnë se sistemi partiak është kontigjent jo vetëm i ndarjeve në shoqëri por edhe i një sërë faktorësh të tjerë siç janë një ndryshim në mjedisin e jashtëm, në ekonomi, në udhëheqjen e partisë, një ndryshim i rregullave elektorale apo edhe përmbysja e sistemit (Pennings & Lane, 2005: 4-5).

Lane dhe Ersson (1994: 4-5) identifikojnë këta indikatorë që karakterizojnë sistemin partiak:

- Numri i çështjeve që krijojnë strukturën e ndarjeve në sistemin partiak dhe polarizimi (distanca ideologjike ndërmjet partive);
- Numri efektiv i partive dhe Indeksi i fragmentizimit;
- Lulahshmëria elektorale: ndryshimi agregat i votave për partitë politike ndërmjet zgjedhesh të njëpasnjëshme.

Lulahshmëria elektorale është një tregues shumë i rëndësishëm që tregon nëse ndarjet shoqërore, ekonomike, sociale, politike, fetare, etnike apo çfarëdolloj tjetër ndarjeje që ekziston në shoqëri dhe frymëzon krijimin e një partie politike, pra këto ndarje janë të stabilizuara ose jo. Lulahshmëria e ulët elektorale është indikator i një sistemi partiak të

qëndrueshëm, ndërsa luhatshmëria e lartë elektorale është indikator i një sistemi partiak të paqëndrueshëm dhe për pasojë i një shoqërie në mobilitet e sipër interesat e së cilës janë në ndryshim të vazhdueshëm. Po kështu, përveçse indikon ndryshime sistemike në shoqëri, luhatshmëria elektorale tregon edhe ndryshime në sjellen e qytetarëve. Ajo është pjesë e debatit të madh në lidhje me ri-rreshtimin, largimin dhe pakënaqësinë e votuesve. Në këtë kontekst, luhatshmëria elektorale është veçse një ndër indikatorët që tregojnë për ndryshimin strukturor të sjelljes zgjedhore (Dassonneville & Hooghe, 2011: 4).

Bartolini dhe Mair (1990:25) e masin luhatshmërinë në tri nivele: në nivel sistemi partiak, blloku partiak dhe në nivel partie individuale dhe i konsiderojnë këto të tria si të ndryshme nga njëra-tjetra. Në nivel sistemi partiak, luhatshmëria e elektoratit tregon ndryshimin elektorale në tërësi dhe llogarit shumën e fitoreve apo humbjeve neto të partive politike nga njëra palë zgjedhje në tjetrën. Ky është një indikator i vlefshëm që flet për forcën relative dhe rrënjosjen sociale të aktorëve politikë në zgjedhje të njëpasnjëshme (Krupavicius, 1999:8).

Në lidhje me ndryshimet e para në nivel blloku partiak, me bllok mund t'i referohemi ose një familje partish ose partish të ndryshme të grupuara përreth disa dimensioneve: e majtë- e djathtë, e vjetër vs. e re, ose opozitë vs. qeverisë (Pennings dhe Lane, 1998). Po edhe këtu duhet bërë dallimi ndërmjet luhatshmërisë *intra* dhe *inter* blloku partiak. E para i referohet ndryshimeve elektorale ndërmjet partive prej të njëjtit bllok, ndërsa e dyta identifikon zhvendosjet e votave ndërmjet blloqeve (Bartolin dhe Mair, 1990). Ndërsa në nivel partie, luhatshmëria elektorale është një indikator i vlefshëm i të pranuarit të partisë prej shoqërisë: pra tregon nëse partia ka hedhur apo jo rrënjë në shoqëri

(Lane dhe Ersson, 1999: 127). Lulahshmëria e elektoratit në nivel partiak tregon numrin e votave të fituara ose të humbura nga partitë individuale ndërmjet zgjedhesh.

Përsa i përket faktorëve që ndikojnë mbi lulahshmërinë e elektoratit, literatura akademike liston katër të tilla: a) ndarjet shoqërore; b) institucionet dhe pasojat që këto institucione prodhojnë; c) performanca ekonomike si edhe; d) organizimi partiak.

Në të njëjtën linjë me Lipset dhe Rokkan (1967) sipas të cilëve partitë politike i mobilizojnë votuesit mbi bazë të çarjeve strukturore në shoqëri dhe të Pedersen (1979) sipas të cilit lulahshmëria e elektoratit në vendet e Evropës Perëndimore pas viteve 1960-të i kishte rrënjët në ri-rreshtimin e elektoratit, të gjitha studimet konkludojnë se ndryshimet longitudinale në preferencat e elektoratit ndodhin si rezultat i transformimit që i ndodh vlerave dhe strukturës shoqërore (Dalton et. al.1984:451). Pikërisht, sistemi vleror dhe strukturor i shoqërisë ndikon edhe në ideologjitë e partive politike. Crewe argumenton se ideologjia luan një rol të rëndësishëm në sjelljen e votuesve. Mënyra se si votuesit votojnë dhe ndryshojnë preferencat e tyre zgjedhore është në varësi të marrëdhënies që ekziston ndërmjet pozicionit të zgjedhësve dhe pozicionit të perceptuar të partisë në lidhje me çështjet e mëdha që ndajnë dhe formojnë sistemin partiak (1985:129). Argumentimin mbi burimin ideologjik të votimit e plotësojnë akoma më tej Bartolini dhe Mair të cilët konkludojnë se faktorët që ndikojnë mbi lulahshmërinë e elektoratit mund të ndahen në tri grupe: ndryshime në sistemin elektoral, formati i sistemit partiak dhe segmentimi kulturor (1990:282).

Përsa i përket vendeve post-komuniste, ndarjet shoqërore të identifikuara nga Lipset dhe Rokkan (1967) apo segmentimi kulturor i Bartolini dhe Mair (1990) nuk ndikojnë në formimin e sistemit partiak dhe për pasojë as në lulahshmërinë e elektoratit. Kjo për arsye

se regjimet komuniste i sheshuan dallimet shoqërore përmes përodrimit të ideologjisë egalitariane (van Biezen, 2003: 35-36). Etniciteti, gjuha dhe feja nuk arritën të prodhonin dallime të rëndësishme ndërmjet qytetërëve. Për sa i përket pronësisë, vetëm shteti përfitoi nga kjo e drejtë, duke eliminuar kështu të gjitha dallimet e mundshme ndërmejt pronarëve dhe punëtorëve. Për pasojë, duke qenë se partitë nuk mund t'i drejtoheshin identiteteve kolektive, iu desh të mbështeteshin mbi baza të tjera, që kishin të bënin me aspektet institucionale të ndryshimit të regjimit (van Biezen, 2003:159). Pra, për shkak të mungesës të ndarjeve shoqërore, pjesa më e madhe e partive të vendeve post-komuniste nuk kishte prejardhje shoqërore, por më tepër institucionale, dhe pikërisht kjo e bëri edhe më të ulët besnikërinë e elektoratit (Gherghina, 2013:5).

Përsa i përket numrit të partive që konkurojnë në sistem, ky numër është i lidhur në përpjestim të drejtë me luhatshmërinë elektorale (Pedersen, 1979; Creëe, 1985; Bartolini and Mair, 2005). Është një fakt i njohur tashmë se sistemi elektorale është një prej përcaktuesve kryesorë të numrit të partive që konkurojnë në zgjedhje (Rae, 1971; Taagepera and Shugart, 1989). Sa më pak parti në sistem, aq më pak alternativa të spektrit ideologjik për votuesin dhe e anasjella (Pedersen, 1979). Duke qenë se në vendet post-komuniste partitë lindën në një klimë ku lejohej formimi i tyre, ku shteti i subvenciononte dhe ku kemi një media të zhvilluar që diversifikon kanalet e komunikimit me elektoratin duke diversifikuar kështu edhe alternativat për votuesit, kjo i dha hov krijimit të tyre duke rritur në këtë mënyrë numrin e partive që merrnin pjesë në zgjedhje. Numri i madh i partive dhe mungesa e besnikërisë së votuesve ndaj një partie të vetme për shkak të mungesës së identifikimit me të, bëri që edhe luhatshmëria e elektoritit të vendet post-komuniste të ishte e lartë.

Një faktor i tretë që ndikon në luhatshmërinë e sistemit elektoral është edhe ndryshimi i sistemit zgjedhor. Pritshmëria është që sistemi elektoral të influencojë luhatshmërinë në mënyrë indirekte përmes numrit të partive që inkurajon të konkurojnë me njera-tjetrën. Sistemet shtrënguese me zona zgjedhore të vogla (prag i lartë natyral) ose me pragje formale të larta në nivel kombëtar i dekurajojnë partitë për të marrë pjesë në konkurrencën partiake për pushtet duke e reduktuar kështu luhatshmërinë e elektoratit (Birch, 2001:7).

Përveç vetë ndikimit që ka sistemi elektoral në nivelin e luhatshmërisë së elektoratit, edhe ndryshimi i sistemit elektoral ndikon në këtë nivel. Sipas Bartolini dhe Mair, ndryshimi i sistemit elektoral në vendet e Evropës Perëndimore në periudhën 1885 – 1985 është shoqëruar me nivel të lartë luhatshmërie (2007: 160). Së fundmi, Bartolini dhe Mair kanë analizuar edhe lidhjen që ekziston ndërmjet pjesëmarrjes së zgjedhësve në votime dhe luhatshmërisë dhe kanë parë një lidhje pozitive ndërmjet tyre, pra sa më e lartë pjesëmarrja aq më e lartë luhatshmëria.

Tipologjitë e Partive Politike

Literatura mbi vendet e Evropës Perëndimore identifikon katër tipologji partiake të cilat ndihmojnë për të kuptuar strukturën dhe organizimin partiak. Këto tipologji janë: partia e masave, partia ‘kap gjithkënd’, partia elektoral profesionale dhe partia kartel. Edhe pse studjuesit e pranojnë gjerësisht se forma të tilla të pastra nuk gjenden në praktikë, sërish tipologjitë janë të nevojshme për t’u përdorur sepse na ofrojnë indikatorët e nevojshëm që duhen matur, shqyrtuar dhe analizuar për të kuptuar një rast konkret. Përveç këtyre katër tipologjive, literatura bashkëkohore ka identifikuar edhe një model partiak të pestë që është

partia klienteliste e masave, e cila vërehet kryesisht në vendet me demokraci të pakonsoliduar.

Partia e Masave

Duverger-i identifikoi dy tipe partish: partinë e kuadrove dhe partinë e masave. Për Duverger-in, partia e masave evoloi nga partia e kuadrove, duke qenë kështu faza finale e zhvillimit të partive në shoqërinë bashkëkohore (1954: 63, 427). Në modelin e partisë së masave njësitë themelore të jetës politike janë grupet shoqërore qartësisht të para dhe mirë-përcaktuara, të cilët luajnë një rol shumë të rëndësishëm sepse të gjitha aspektet e jetës së njeriut janë të lidhura dhe përcaktohen nga përkatësia në këto grupe shoqërore (Neumann, 1956: 403). Partia shihet si përfaqësuesja e këtyre grupeve shoqërore. Ajo ndërmjetëson konfliktin ndërmjet tyre, organizon konkurrencën por edhe bashkëpunimin ndërmjet tyre dhe synon të fitojë kontrollin mbi shtetin duke vendosur zyrtarë të saj në postet kyçe shtetërore. Programi i partisë shihet si një sintezë e artikullimit të interesave të këtyre grupeve shoqërore.

Megjithatë një konceptualizim i tillë i partisë vazhdon të mbizotërojë edhe në tipologjitë e mëvonshme mbi të (Kirchheimer, 1967; Panebianco, 1988). Ajo çka e dallon partinë e masave prej tipologjive të tjera partiake (që do të zhvillohen më poshtë) është grupi shoqëror që përfaqëson, struktura dhe mënyra e saj e organizimit. Partia e masave përfaqëson klasën punëtore (Duverger, 1954: 65-67). Ajo mbështetet në parimin e anëtarësisë dhe anëtari është ‘ai që nënshkruan një sipërmarrje me partinë dhe më pas paguan rregullisht për këtë anëtarësim’ (Duverger, 1954: 63). Kjo pagesë ka një rëndësi jetike për funksionimin e partisë së masave, sepse ajo, përfaqëson burimin kryesor të

financimit të partisë. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është se anëtari konsiderohet të jetë ‘vetë substanca e partisë, materia e aktiviteteve të saj’ (63). Anëtarët kryejnë aktivitetet e partisë dhe në të njëjtën kohë janë rezervuari i udhëheqësve të ardhshëm potencialë që synojnë të administrojnë dhe qeverisin vendin. Për pasojë anëtarët e partisë së masave janë të rëndësishmë si për nga pikëpamja financiare ashtu edhe ajo politike. Kjo rëndësi që ka anëtarësia, bën që të kemi një supremaci të pjesës jashtë-parlamentare të partisë mbi atë parlamentare.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i partisë së masave është se ajo është e centralizuar, e disiplinuar, e mbështetur mbi degët dhe seksionet të cilat kanë lidhje të forta me njera tjetrën (67). Uniteti, disiplina dhe shtrirja e gjerë e partisë në të gjitha qelizat e shoqërisë janë intrinsike për partinë e masave, si nga pikëpamja praktike (siguron mirëfunksionimin e partisë) ashtu edhe nga pikëpamja e legjitimitetit. Është pikërisht një përfshirje e tillë e gjerë e shoqërisë në formulimin e programit partiak (gjë që nga pikëpamja organizative kërkon një organizim të gjerë të anëtarësisë në degë dhe celula) që i jep legjitimitet partisë.

Partia e masave u shfaq si pasojë e përpjekjeve të elementeve të shoqërisë civile (shpesh pa të drejtë vote) për të fituar zë dhe kontroll mbi strukturat e shtetit. Në ndryshim nga partia e kuadrove e cila mbështetet mbi cilësinë e mbështetësve të saj, partia e masave u mbështet në sasinë e tyre ‘duke u përpjekur kështu të kompensojë përmes anëtarësive të shumta patronazhin individual të partisë së kuadrove; për të kompensuar përmes individëve të organizuar dhe aksionit kolektiv influencën individuale të partisë së kuadrove; dhe për të kompensuar përmes shtypit partiak dhe kanaleve të tjera të komunikimit partiak aksesin në shtypin komercial të partisë së kuadrove’ (Katz & Mair, 1995; 10).

Sipas Duverger, partia e masave shënjon fazën përfundimtare të evoluimit partiak dhe konsiderohet si partia e së ardhmes. Megjithatë, tipologji të tjera partiake u elaboruan më pas dhe një prej tyre është pikërisht tipologjia e partisë ‘kap gjithkënd’ prej Otto Kirchheimer.

Partia ‘Catch All’ ose Partia ‘Kap Gjithkënd’

Partia ‘catch-all’ është produkt i transformimit të partisë së masave, transformim ky që erdhi si pasojë e ndryshimeve shoqërore dhe politike. Sipas Kirchheimer, partia e masave ishte produkt i një epoke me ndarje klasore të forta dhe struktura denominale dukshëmrisht të ndryshme. Përkundër kësaj, partia ‘catch-all’ është produkt i një epoke ku ndarje të tilla janë zbehur dhe strukturat denominale zhduken gradualisht (1966:184). Pra partia politike nuk është më një përfaqësuese grupeve shoqërore të mirë-përcaktuar. Kjo erdhi si pasojë e erozionit të kufijve tradicional shoqërorë në fund të viteve 1950-të dhe 1960-të, gjë që çoi në një zbehje të identiteteve kolektive që më parë ishin qartësisht të dallueshme, duke bërë gjithmonë e më të vështirë identifikimin e sektorëve me kufij të qartë shoqërorë në elektorat dhe për pasojë duke bërë gjithmonë e më e vështirë identifikimin e partisë me një sektor të caktuar të elektoratit.

Faktorë të tjerë që çuan në formimin e partisë ‘catch-all’ lidhen me shfaqjen e shtetit të mirëqenies sociale dhe zhvillimin e mass-medias. Shteti i mirëqenies sociale lehtësoi hartimin e programeve ekonomiko-shoqërore prej të cilave përfitonin njëkohësisht sektorë të ndryshëm të shoqërisë. Pra në ndryshim nga periudha e partisë së masave, ku programi politik ishte qartësisht në favor të një grupi të caktuar social, tashmë, programi

politik nuk është më përçarës por i shërben interesave të të gjithëve. Po kështu, zhvillimet në fushën e medias, bënë të mundur që krerët e partive politike t'i drejtohen elektoratit në përgjithësi dhe jo vetëm elektoratit të përkatësisë.

Periudha e viteve 1950 – 1960-të është periudha e de-ideologjizimit (1966, 187). Partia ‘catch-all’ është një organizatë që përpiqet të mbijetojë duke maksimizuar numrin e mbështetësve të saj. Ajo i ka reshtur ‘përpjekjet për rekrutimin intelektual dhe moral të masave, [dhe] është i është kthyer tërësisht skenës elektorale, duke u përpjekur ta zëvendësojë efikasitetin në thellësi për një audiencë më të gjerë dhe sukses elektoral më të shpejtë’ (1966, 184).

Por po këtë lloj transformimi e pëson edhe partia e kuadrove, apo partia tradicionale e cila nuk mund të adoptojë të njëjtën strategji sikurse partia e masave, pra ajo nuk mund të organizohet duke u mbështetur vetëm në segmente të mirëpërcaktuara të elektoratit, sepse, kjo do të thoshte që ajo të mbështetej në segmente që gjithmonë e më tepër po zvogëloheshin (fermerët, industrialistët). Për më tepër, në ndryshim nga partia e masave, ku organizata jashtë-parlamentare është më e fortë se ajo parlamentare, kjo strukturë nuk ishte e përshtatshme për partinë e kuadrove. Partia e kuadrove nuk ka nevojë të mbështetet tek anëtarësia, sepse ajo nuk ka nevojë për burimet materiale të siguruar prej anëtarësisë, sepse ajo i siguron ato përmes kontributeve individuale dhe asetëve shtetërore (ato janë ende pjesë e qeverisjes). Një tjetër arsye është sepse ajo ka ende akses në kanalet ‘jo-partizane’ të komunikimit. Ajo për të cilën ka nevojë partia e kuadrove është mobilizimi i elektoratit.

Për pasojë, strategjia partiake (qoftë kjo parti masash apo kuadros) është të nënvizojë aspekte të programit prej të cilit përfitojnë një kategori e gjerë votuesish, sikurse

edhe aspekte të cilat nuk kanë gjasa të hasin kundërshti në elektorat. Andaj, partia propozon një program që kapërcen interesat e grupeve të ndryshme të shoqërisë dhe i drejtohet një klientele pa kufij (1966:186). Nga pikëpamja strukturore, partia 'kap gjithkënd' ruan modelin e partisë së masave duke ruajtur tiparet e jashtme apo të dukshme të saj si anëtarësi e rregullt, degë partiake në gjithë territorin e vendit, kongrese dhe shtyp partiak, por për sa i përket organizimit dhe funksionimit i jep më shumë rëndësi degës parlamentare sesa asaj jashtë-parlamentare, duke sjellë kështu një ndryshim në conceptualizimin dhe rolin e pjesëve të partisë: tashmë nuk është më partia parlamentare që vepron si agjent i masës së partisë, por kjo e fundit shihet në funksion dhe si mbështetëse e degës parlamentare. Pra, përfundimisht mund të thuhet se si partitë e majta, një herë e një kohë të organizuara sipas modelit të partisë së masave, ashtu edhe partitë e djathta (dikur partia e kuadrove) u konvertuan në parti 'kap gjithkënd'. Partia 'kap-gjithkënd' kthehet në një ndërmjetësuese midis shoqërisë civile dhe shtetit: nga njëra anë ato agregojnë dhe i bëjnë me dije shtetit kërkesat e shoqërisë civile, nga ana tjetër ato kthehen në agjentë të burokracisë shtetërore duke mbrojtur para publikut, politikat shtetërore.

Partia elektorale - profesionale

Panbianco observoi daljen e një tipi të ri partie: partinë elektorale-profesionale e cila reflektoi ndryshimet në stratifikimin e shoqërisë, ndryshimet në rëndësinë që grupe të ndryshme punonjësish morën apo humbën me kalimin e kohës si edhe ndryshimet në veçansitë dhe sjelljet kulturore të grupeve të ndryshme. Po kështu partia elektorale profesionale shfaqet edhe si pasojë e ndryshimeve në teknologji si edhe të rritjes së

rëndësisë së mass-medias dhe TV si mjete të komunikimit politik, të cilat influencuan strategjitë e partive dhe qasjen që ato kishin ndaj elektoratit (1988, 264 -272).

Në anlizën që i bëri sistemit partiak evropian, Stein Rokkan (1967) identifikoi katër ndarje kryesore strukturore që e formësuan këtë sistem: ndarja qendër-periferi, ndarja kishë-shtet, ndarja urban-rural dhe ndarja klasore (punedhënës-punëmarrës). E megjithatë, ndarja klasore ishte ndarja më themelore politike sepse çështjet që kishin lidhje me këtë ndarje kryesuan hierarkinë e problemeve politike në pjesën më të madhe të vendeve Evropiane duke e kthyer kështu konkurrencën elektorale në një dimensionale: e majtë – e djathtë e cila u përqëndrua kryesisht rreth çështjeve socio-ekonomike. Megjithatë pas viteve 70-të lidhja ndërmjet ndarjeve strukturore dhe çështjeve politike ka ndryshuar gjithkund sepse “[n]darjet kulturore ... që i dhanë kuptim dhe substancë ‘hartës konjitive’ të dimensionit e djathtë – e majtë, u bënë të mjegullta në një kohë kur nuk është më e qartë se cili grup social dëmtohet dhe cili favorizohet nga një zgjedhje politike e caktuar” (Panebianco, 1988:270). Ndryshimeve në ndarjet kulturore iu shtuan edhe një sere çështjesh të tjera politike të cilat nuk mund të akomodoheshin nga dimensionit e djathtë-e majtë. Çështje të tilla janë ato ekologjike, lëvizjet feministe të cilat në vitet 70-të i ndanë radikalisht nën-kulturat tradicionale politike si edhe ato që kanë lidhje me ringjalljen e lëvizjeve etniko-linguistike të viteve 70-të. Kjo gjë e ktheu hapësirën politike në multi-dimensionale. Madje Ronalt Inglehart nuk flet më për një ndarje klasike e djathtë – e majtë por për një ndarje ndërmjet grupeve sunduese që mund të jenë si të majta ashtu edhe të djathta, organizatave industriale apo sindikatave të punëtorëve dhe qytetarëve. Pra hapësira politike ka ndryshuar duke u kthyer kështu në të paktën dy – dimensionale, ku përveç

dimensionit e djathtë-e majtë, ka edhe një dimension të ri dhe permanent që ndodhet në rrënjët e sjelljeve jo-konvencionale.

Partia elektoral-profesionale mbështetet më shumë tek profesionistët sesa tek anëtarët e saj. Ajo e zhvendos vëmendjen e saj nga elekorati i përkatësisë në atë të opinionit. Kjo ndodh sepse ‘elektorati i përkatësisë zvogëlohet dhe identifikimi me partinë – që më parë pat siguruar stabilitetin elektoral në pjesën më të madhe të vendeve evropiane – bie. Elektorati bëhet më i pavarur prej partisë, dhe integrimi social “prej djepit deri në varr” (Newman, 1956) kufizohet tashmë në minoritete që gjithmonë e më tepër zvogëlohen’ (Panebianco, 1988:267) Po ashtu, burimet e saj financiare nuk janë më anëtarët apo aktivitetet kolaterale, por grupet e interesit dhe fondet publike. Së fundmi, ajo nuk mbështetet në një ideologji të caktuar, por tenton të zgjidh çështje të ndryshme pavarësisht ideologjisë (1988: 264). Në ndryshim nga partia a masave e identifikuar nga Duverger (1954) partia elektoral profesionale është institucionalisht e dobët. Ndodh ajo që Panebianco e quan de-institucionalizimi i partisë politike (1988: 267). Kjo ndodh sepse partitë inkorporohen gjithmonë e më tepër në shtet dhe aparati burokratik aq i rëndësishëm për partinë e masave (Duverger, 1954) bëhet gjithmonë e më i panevojshëm, gjë që nga ana tjetër shoqërohet nga rritjen e peshës politike të ekspertëve dhe përfaqësuesve politikë.

Përfundimisht, në ndryshim nga partia e masave e përshkruar nga Duverger, ku një rol qendror luan burokracia partiake, në partinë elektoral profesionale, profesionistët luajnë një rol shumë më kryesor, rol të cilin e fitojnë sepse edhe qendra e gravitetit zhvendoset prej anëtarësisë së partisë drejt elektoratit. Tiparet kryesore të partisë elektoral-profesionale janë: rol qendror i profesionistëve, ekspertëve, teknikienëve, e orientuar drejt elektoratit dhe me lidhje të dobëta vertikale, mbizotërim të përfaqësuesve publikë, udhëheqje e

personalizuar, financim prej grupeve të interesit dhe fondeve publike, vënie e theksit tek çështjet dhe jo ideologjia, vendosje në qendër të vëmendjes të karrieristëve dhe përfaqësuesve të grupeve të interesit brenda organizatës (Panebianco, 1988, 264).

Në përgjithësi, partia electoral - profesionale ka ngjashmëri me partinë ‘catch – all’, e megjithatë, qasja e Panebianco-s për të identifikuar burimet e forcës së partisë janë të vyera në analizimin e partive politike.

Partia Kartel

Partia kartel është një tip i ri partie. Në ndryshim nga tipologjitë e mëparshme partiake, ku partia gjykohet apo analizohet në raportet që ajo krijon me shoqërinë civile (Duverger, 1954; Newmann, 1956, Kirchheimer, 1967; Panebianco, 1988), partia kartel analizohet në marrëdhëniet që ajo krijon me shtetin (Katz & Mair, 1995). Ajo shfaqet në periudhën post-industriale ku struktura shoqërore që e prodhoi ose bëri të mundur partinë e masave, nuk ekziston më si edhe kur, apo për shkak të ndryshimeve që pësojnë marrëdhëniet e partisë me shtetin. Dhe pikërisht këtu qëndron edhe risia e kësaj partie. Ndërsa tipologjitë partiake të mëparshme qëndrojnë jashtë shtetit (partia klasike e masave është pjesë e shoqërisë civile që del prej sektorëve të elektoratit, me qëllimin që të kapë shtetin dhe modifikuar në afat-gjatë politikat e tij publike në interes të të përfaqësuarve të saj që janë një segment i caktuar i shoqërisë dhe jo e gjithë shoqëria, ndërsa partia ‘kap gjithcka’ duke qëndruar ndërmjet shtetit dhe shoqërisë civile, kërkon sërish të influencojë prej së jashtmi shtetin për të kënaqur kërkesat afat-shkurtra të konsumatorëve të saj pragmatistë), partia kartel është pikërisht brenda tij duke i hequr atij tiparin e një arene neutrale dhe të lirë prej partive politike.

Ndërsa i largohet shoqërisë ajo i afrohet shtetit. Partia kartel është një ‘agjent i shtetit dhe punëson burimet e shteti (partia shtet) për të siguruar mbijetesën e saj’ (Katz dhe Mair, 1995, 5). Partia kartel del si rezultat i rënies së pjesëmarrjes së qytetarëve në politike dhe përfshirjes së tyre në aktivitetet e partisë dhe daljes në skenë të grupeve të interesit. Rënia e anëtarësisë u shoqërua me rënien e të ardhurave financiare. Për pasojë partia ‘u detyrua’ të kërkojë burime alternative financiare dhe ia doli të siguroje mbështetje nga shteti (Katz dhe Mair, 1992; 1995, 15). Në këtë moment partia absorbohet prej shtetit dhe kthehet në një agjenci gjysmë-shtetërore (Katz dhe Mair, 1995, 16). Me daljen në skenë të partisë kartel, politika kthehet në profesion. Konkurenca partiake nuk mbështetet më në vija ideologjike, por në menaxhimin eficient dhe efektiv. Për më tepër, edhe pse partitë vazhdojnë të konkurojnë me njera-tjetrën, ‘ato e bëjnë këtë duke e ditur se ndajnë me konkuresit e tjerë interesin e përbashkët për mbijetesën kolektive të organizatës’ (Katz dhe Mair, 1995, 19-20). Partitë ndajnë të njëjtin burim subvencionit dhe përfitimesh: shtetin (16-20).

Partia Klienteliste e Masave

Partitë politike i kanë tërhequr mbështetësit e tyre gjithmonë me premtimin e përmirësimeve materiale. Në pjesën më të madhe këto premtime përfshijnë të mirat që vijnë prej politikave publike, por disa parti premtojnë gjithashtu benefite materiale në formë selektive për mbështetësit e tyre (Scarrow, 2015:169), të cilat shfaqen në formën e patronazhit dhe klientelizmit.

Patronazhi dhe klientelizmi janë ngushtësisht të lidhura bashkë sepse të dyja janë forma marrëdhënieje shkëmbimi ndërmjet patronëve dhe klientëve, marrëdhënie në të cilat burimet e shtetit tregtohen për mbështetje politike. Këtë formë marrëdhënieje Kopecký (2006) e quan kolonizim të shtetit prej partisë. Është e rëndësishme të bëhet një dallim ndërmjet patronazhit partiak dhe klientelizmit partiak me patronazhin dhe klientelizmin në përgjithësi. Në rastin e patronazhit dhe klientelizmit partiak, është partia padroni ‘kolektiv’ i këtyre marrëdhënieve shkëmbyese. Ndërsa në rastin e dytë, padroni është një individ (p.sh. një bos lokal, një njeri i njohur) (fq.258). Megjithatë në këtë punim do të fokusohem tek partia dhe jo thjesht marrëdhënia individuale.

Patronazhi partiak ka të bëjë me shpërndarjen e posteve dhe pozicioneve të tjera të rëndësishme publike dhe gjysëm- publike, p.sh. , në shërbimin civil, kompanitë e sektorit publik, universitetet, shkollat dhe institutet kërkimore (fq.258). Në kontekstin Evropian, aksesit ndaj burimeve publike dhe semi-publike u dha mundësi udhëheqësve partiakë të ndërtojnë dhe më pas të ruajnë organizimin partiak përmes shpërndarjes së ‘incentivave selektive’ ndaj aktivistëve të partisë dhe elitave partiake në shkëmbim të besnikërisë ndaj organizatës (fq.258).

Klientelizmi partiak është një fenomen për i përhapur sesa patronazhi partiak. Është një formë përfaqësimi bazuar mbi shpërndarjen selektive të një varieteti të gjerë burimesh publike – kontrata, shtëpi, subvencione, hartim legjislativ në favor të një pale të caktuar – me synimin për të siguruar mbështetje elektorale, ose prej individësh ose prej segmenteve të caktuara të shoqërisë. Në këtë kuptim klientelizmi është më tepër një marrëdhënie e partisë me shoqërinë, në ndryshim nga patronazhi që është më tepër një marrëdhënie e partisë me shtetin. Megjithatë e rëndësishme për t’u theksuar është se klientelizmi e

përfshin patronazhin sepse pa patur aftësinë për të kontrolluar emërtimet në pozicionet publike dhe gjysëm-publike, partia nuk do të ishte në gjendje të shpërndante burimet publike (Kopecký, 2006: 259).

Përveç patronazhit dhe klientelizmit kemi edhe korrupsionin, që konsiston në dhënien parave në shkëmbim të vendimeve publike në favor të palës që ka dhënë paratë. Në kontekstin e partive politike, forma më e përhapur e korrupsionit janë donacionet financiare ndaj drejtuesve të partisë në shkëmbim të kontratave të ndërtimit, kontratave të armëve apo dhënien e liçensave. Megjithatë, si patronazhi ashtu edhe klientelizmi në një farë mënyre janë forma praktikash korrupsioni (fq. 259).

Pavarësisht formave të shkëmbimit të votës për favore, vetëm klientelizmi ka ‘arritur’ të krijojë një tipologji partiake që është ajo e partisë klienteliste të masave. Partia Klienteliste e Masave funksionon sipas parimeve të klientelizmit. Qytetarët bëhen anëtarë të partisë në shkëmbim të favoreve prej përfaqësuesve të partisë në rast se ata marrin pushtetin. Këto favore mund të jenë punësim i anëtarësisë apo të afërmëve të tyre në shtet, dhënia e kontratave publike bizneseve që kanë ndihmuar partinë, apo edhe shpërndarja preferenciale e shërbimeve sociale si dhënia e shtëpive apo asistencës sociale.

Sjellja votuese është funksion i një këndvështrimi të personalizuar dhe instrumental të pjesëmarrjes politike: votuesit e përdorin votën e tyre thjesht për të mbështetur ‘padronët’, duke fituar si shkëmbim mbështetjen e tyre. Votuesit nuk i interesojnë pasojat që mund të sjellë në vend zgjedhja e tyre elektorale, dhe përfaqësuesit e zgjedhur përmes mekanizmash klientelizmi nuk mund të pretendojnë ta përdorin mandatin e tyre për të ndjekur një program të gjerë politikash publike. Për më tepër, natyra statike e klientelizmit minon funksionin e *‘feedback’* - ut në politikën elektorale duke e bërë alternimin politik

shumë të vështirë (Hopkins, 2006: 406). Një strategji e tillë i jep partisë përfitimet që ka një organizatë masash sepse e bën të mundur praninë e partisë në çdo kapilar të shoqërisë dhe i siguron asaj burime njerëzore për të kryer aktivitetet e partisë duke përfshirë këtu edhe fushatat elektorale. Po kështu i siguron partisë qëndrueshmëri në elektorat duke krijuar në këtë formë edhe bastionet partiake. Një tipologji e tillë favorizohet në vendet që kanë një burokraci shtetërore të nën-zhvilluar dhe lehtësisht të prekshme prej infiltrimeve partiake (Hopkin, 2004:631-632).

Megjithatë, në praktikë, është e vështirë që të vëzhgohet një tipologji e qartë dhe e pastër e partive politike. Në varësi të legjislacionit shtetëror mbi financimin e partive politike, ndarjeve shoqërore (ideologjike, fetare, sociale) që mbizotërojnë në shoqëri partitë politike shfaqin diku më shumë e diku më pak elemente të të gjitha tipologjive të përmendura më sipër. Por ndërsa tipologjia e partive politike në Evropën perëndimore ka ndryshuar gradualisht duke reflektuar ndryshimet shoqërore, mbetet për t'u parë nëse ajo është e përshtatshme për të kuptuar, shpjeguar dhe analizuar zhvillimin e partive politike në vendet post-komuniste ku ndryshimet shoqërore dhe politike nuk ndodhën gradualisht por erdhën si pasojë e një ndryshimi radikal si në rendin politik ashtu edhe atë shoqëror.

Modele Teorike mbi Strukturën dhe Organizimin e Partive Politike në Evropën Post-Komuniste

Në fillim të epokës post-komuniste kishte një ide të pranuar nga të gjithë se përgjithësisht partitë politike të Evropës lindore dhe qendrore do të prireshin drejt modelit perëndimor në kontekstin e demokratizimit (Gross, 1992; Webb & White, 2007: 5). Pjesa

më e madhe e specialistëve binte dakort se për një sërë arsyesh historike, strukturore dhe konjunkturale, konteksti në të cilin u organizuan partitë politike në Evropën Qendrore dhe Lindore ishte i ndryshëm nga ai i vendeve të Evropës Perëndimore. Për këtë arsye, gjasat që partitë politike post-komuniste t'i ngjasonin partive politike të fund-shekullit të 19-të dhe fillim shekullit të 20-të, pra të shfaqnin tipare të partisë së masave ishin të pakta. Janë një sërë arsyesh që e shkaktojnë këtë ndër të cilat mund të përmenden: kultura e trashëguar 'anti parti' dhe dyshimi ndaj politikës dhe organizatave politike; mungesa identiteteve shoqërore të qarta dhe për pasojë edhe e identiteteve socio-ekonomike respektive; një shoqëri civile e dobët dhe për pasojë një shtet relativisht i rëndësishëm si burim mbështetjeje bazë për partitë; natyra fluide e elektoratit post-komunist, prirja e partive për t'u themeluar 'së brendshmi' prej elitave të kohës së tranzicionit dhe jo 'së jashtmi' si pasojë e levizjeve sociale, rritja e rëndësisë së medias elektronike dhe së fundmi edhe nevoja gjithmonë e më e madhe e partive për të kontrolluar dhe pushtuar shtetin (Hanley, 2001:2; van Biezen, 2003).

Lewis (2000:32) argumenton se konteksti struktural në Evropën post-komuniste ishte më pak i favorshëm për partitë politike se sa ç'kishte qenë një shekull më parë në perëndim. Në ndryshim me vende të tilla perëndimore si Britania dhe Franca e fund-shekullit të 19-të dhe fillim-shekullit të 20-të, sistemi pluralist partiak i hapur për të gjithë publikun, nuk ndodhi në kontekstin e një 'demokracie të brendshme partiake' para-ekzistuese (Mair, 1997:175-98). Sistemi komunist mbeti monolitik deri në fund të jetës së tij dhe nuk shfaqti asnjëherë shenja të diversitetit institucional. Megjithatë popullsia ishte mobilizuar gjatë sistemit komunist nëpërmjet rrjeteve të shumta të organizatave politike dhe shoqërore, ky mobilizim kishte qenë gjithmonë nën kontrollin e partisë-shtet duke mos

i dhënë mundësi qytetarëve për të ndikuar në vendim-marrje. Në këtë kontekst, fazat e para të demokratizimit dhe të ndërtimit të sistemit partiak u zhvilluan në një situatë të pastrukturuar ku nga njëra anë institucionet e periudhës komuniste e kishin humbur kuptimin dhe rolin e tyre, por nga ana tjetër edhe kushtet shoqërore të nevojshme për pluralizmin politik mungonin (Lewis, 2000:32).

Kështu kishte një konsensus të gjerë ndërmjet studjuesve në lidhje me tipologjinë e partive post-komuniste: organizata të vogla me anëtarësi të ulët të dominuara nga zyrtarët, profesionistët politikë dhe elitat partiake, të cilët as kanë dhe as nuk kërkojnë të kenë prezencë reale në shoqërinë civile, por përkundrazi mbështeten tek shteti, media dhe marrëdhënia me elektoratin. Për shembull, Kitschelt (1992:42) parashikoi krijimin e ‘organizatave të profesionistëve me lidhje të vogla lokale dhe pa rripa transmisioni në zonat zgjedhore’. Ndërsa Kopecký (1995:517) hipotetizoi krijimin e ‘formacioneve me lidhje të dobëta me zonat elektorale, në të cilat një rol relativisht i parëndësishëm luhet nga anëtarësia, ndërsa udhëheqësit kanë rol dominues’. Në të njëjtat konkluzione arriti edhe Mair (1996:12-13) dhe Szczerbiak (1999:526).

Pra, me kolapsin e komunizmit pritshmëria ishte që modeli më eficient i organizimit partiak në vendet post-komuniste do të ishte ai ‘elektoral-profesional’ ose ‘kartel’. Një arsye e rëndësishme që e shkaktonte këtë pritshmëri ishte se komunizmi i pati sheshuar dallimet socio-ekonomike të shoqërisë duke e bërë të vështirë kështu organizimin e interesave të njerëzve rreth partive politike (Lewis, 1996: 9-16; Bielasiak, 2002:189-90). Lewis (1996:16), Szczerbiak (1999:526-527; 2000:9-11) dhe Kopecký (1995:529-30) argumentuan se modeli elektoral-profesional dhe ai kartel do të adaptoheshin nga partitë e reja post-komuniste apo partitë opozitare, ndërsa partitë trashëgimtare të partisë komuniste

do të ruanin tipare të partisë tradicionale të masave, kryesisht në aspektin e anëtarësisë, pra parti me nivele të larta anëtarësie.

Pikërisht për shkak të mungesës së ndarjeve sociale dhe interesave ekonomiko-shoqërore të mirëpërcaktuara, Lewis (2001:7) dhe Webb & White (2007:5) argumentojnë se partitë politike në vendet post-komuniste nuk patën një ideologji të qartë (sikundër patën së paku në fillimet e tyre partitë në vendet e Evropës Perëndimore) por u fokusuan ndjeshëm në përmbysjen dhe largimin e komunistëve gjë që nuk ka qenë asnjëherë tipar i vendeve të Evropës Perëndimore. Ajo çka u vu re në këto vende është që forcat anti-komuniste nuk u mbështetën në një grup të caktuar social-ekonomik por ose u ndanë duke krijuar parti të reja ose u kthyen në lëvizje të mbështetura mbi kultin e individit. Për pasojë largimi i regjimit komunist në këto vende nuk u shoqërua me konsolidimin e sistemit partiak, por u karakterizua nga një fluiditet politik dhe luhatshmëri elektorale (Lewis, 2001:7; Webb & White, 2007:5).

Në lidhje me elektoratin në analizën e tij të partive politike polake, Szczerbiak (2000, 16-18) vëren se megjithëse partitë politike u përpoqën që t'i drejtoheshin një grupi specifik të elektoratit, duke i dizenuar strategjitë e tyre elektorale në përputhje me këtë grup të caktuar socio-ekonomik, ato, pra partitë politike, e bënë këtë gjë brenda një kuadri të përgjithshëm që i drejtohej votuesit në përgjithësi. Këto strategji u dizenuan sipas dy linjave: ose duke e vënë theksin tek aftësitë, kompetencat dhe besimi i liderëve partiakë ose duke mobilizuar një elektorat ideologjikisht heterogjen mbi baza moral-kulturore dhe jo mbi baza të interesave socio-ekonomike.

Faktorë të tjerë që do të ndikonin në mos-shfaqjen e partisë së masave në vendet post-komuniste me rënien e komunizmit janë: a) pjesa më e madhe e partive të reja u

krijuan si organizata nga lart-poshtë duke e patur origjinën në nivelin e elitave dhe shpesh u formuan në bazë të marrëdhënieve personale ose rreth personave specifikë. Por edhe kur nuk u krijuan së brendshmi brenda parlamentit, ato fituan përfaqësim parlamentar në një fazë shumë të herëshme të zhvillimit të tyre, duke neglizhuar kështu aspektin e ndërtimit të strukturave organizacionale jashtë-parlamentare; b) partitë e reja politike filluan të operonin në një kulturë politike ku shteti kishte marrë një rol prominent në panoramën politike. Në këtë kontekst duke parë se partitë politike të reja kishin nivele të ulëta anëtarësie, nivel të ulët lidhjesh me shoqërinë dhe nivel të ulët organizimi në terren, ishte e natyrshme që ato t'a fokusonin vëmendjen e tyre tek shteti, roli i të cilit si financues i partive politike u vendos që në fillimet e herëshme të krijimit të partive post-komuniste (Szczerbiak, 2000:10-11), krejt e ndryshme kjo me atë çka ndodhi me partitë politike në vendet e Evropës Perëndimore.

Faktor tjetër që indikonte se partia e masave nuk do të ishte modeli sipas të cilit do të zhvilloheshin partitë politike në vendet post-komuniste, ishte ai i lidhur me trashëgiminë historike, gjë që me të gjitha gjasat çonte në një trajektore të ndryshme të zhvillimit të ndarjeve shoqërore dhe ekonomike ndërmjet këtyre dy ndarjeve gjeografike (Webb & White, 2007:5). Kështu Stark komenton se aktorët politikë në Evropën Lindore dhe Qendrore:

janë duke i ndërtuar organizat dhe institucionet *jo mbi rrënojat por së bashku me rrënojat* ndërkohë që rishpërndajnë burimet aktuale si përgjigje ndaj dilemave të momentit. ... format e reja organizacionale shfaqen si pasojë e adaptimit ndaj kërtyre pasigurive të reja (1992:14).

Sipas Kitschelt (1995) dhe Kitschelt et.al. (2000) e shkuara e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore kushtëzon profilin e partive politike që shfaqen në këto vende me rënien e komunizmit. Kështu Kitschelt i klasifikoi këto vende në tre kategori: komunizëm burokratiko-autoritarian, komunizëm patrimonial dhe komunizëm kombëtar. Vendet që dolën nga komunizmi burokratiko-autoritarian kanë një potencial të lartë për ta strukturuar programatikisht konkurrencën partiake. Ndërkaq në vendet e komunizmit patrimonial dimensionimi i ndarjes programatike në sistemin partiak është i mjegullt. Nuk ka një strukturim programatik politik sepse konkurrenca politike mbetet e personalizuar dhe partitë anti-komuniste i kanë rrënjët tepër të dobëta për të prodhuar një alternativë të besueshme kundrejt kampit politik hegjemon të (ish) partisë komuniste e cila vërtitet rreth populizmit ekonomik, autoritetit, rendit dhe ligjit, autonomisë kombëtare, de-komunistizimit të ngadalshëm dhe ka një farë armiqësie ndaj demokratizimit.

Në komunizmin patrimonial, partitë ish-komuniste nuk ishin tërësisht të distancuara prej regjimit të vjetër siç ndodhi me partitë neo-social demokrate që u shfaqën në vendet e komunizmit kombëtar. Ato janë anti-komuniste e megjithatë qëndrimet e tyre shpesh janë të paqëndrueshme dhe simbolike për shkak të mungesës së eksperiencës dhe aftësive intelektuale për t'u artikuluar. Ndërkohë që sektori post-komunist ruan dominancën e tij, sektori liberal qëndron i bashkuar nën një ombrellë të 'prishur' e cila në fakt është e ndarë në një numër të madh fraksionesh dhe grupesh sektariane. Në të gjitha konfigurimet e sistemeve post-komuniste, ndarjet partiake komplikohen prej pluralizmit etnik. Empirikisht, pluralizmi etnik është më i zakonshëm në regjimet post-patrimoniale. Në këtë kuadër, ish partitë komuniste kanë shumë gjasa të ngrenë flamurin e partikularizmit etnik ose duke përdorur slogane nacionaliste që i drejtohen pjesës më të madhe të popullsisë, ose

duke përdorur slogane minoritaro-etnike si përfaqësuese të minoritetit. Aty ku partitë nacionaliste apo etnike largojnë nga skena politike ish-partitë komuniste, ato adoptojnë politika ekonomike centriste. Përfundimisht mund të thuhet se eksperiencat historike, në kuptimin e rrugës institucionale të ndjekur dhe strategjisë së elitave, përpara, gjatë dhe pas komunizmit, së bashku me ndarjen etnike të punës që u instalua gjatë komunizmit, kanë rëndësi dhe shpjegojnë linjat e ndryshme politike dhe alternativat e ndryshme partiake në vendet post-komuniste (pp.464-468)

Trajektorja e ndryshme e zhvillimit partiak e partive politike në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore me ato të Evropës Perëndimore ndikoi edhe në hartimin e strategjive të ndryshme elektorale. Ndërsa partitë politike në perëndim kishin qenë dikur parti masash me një bazë ekzistuese në elektorat dhe më pas e zgjeruan këtë bazë duke përfshirë edhe grupime që nuk i përkisnin klasës punëtore, partitë politike në vendet post-komuniste u përpoqën ta krijonin elektoratin e tyre bazë në të njëjtën kohë që i drejtoheshin edhe elektoratit në përgjithësi: pra tentuan të krijonin elektoratin e përkatësisë ndërkohë që ndiqnin strategji ‘kap gjithkënd’. Lewis (1996) vëren se nuk ka gjasa që në vendet post-komuniste të shfaqen shëmbëlltyrat e partive historike që u shfaqën në Evropën Perëndimore dhe kjo sepse shoqëria post-komuniste nuk mund të ofrojë burimet, interesat e qarta dhe ndarjet sociale, dhe madje as edhe përkushtimin emocional dhe intelektual që mbështeti krijimin e partive në perëndim (fq.6).

Një tjetër tipar që i karakterizoi vendet e Evropës post-komuniste ishte se partitë ish-komuniste u rishfaqën si aktorë të rëndësishëm politikë dhe në mes të viteve 1990-të pjesa më e madhe e këtyre vendeve udhëhiqej prej këtyre partive. Kjo ndodhi për shkak të organizimit të tyre të mirë në terren (Webb & White, 2007:5) në një kohë që partitë post-

komuniste nuk e patën këtë mundësi. Në fakt ‘në vend që t’u forconin partinë dhe të përpiqeshin për të patur në mënyrë graduale sukses zgjedhor dhe vende në parlament, partive anti-komuniste iu desh të konkurronin papritur në zgjedhje duke patur pak eksperiencë dhe aftësi politike dhe organizacionale’ (Roskin, 1997:48). Në ndryshim prej tyre, trashëgimtarët e partive komuniste patën mundësi të mbështeteshin në strukturat organizacionale të hershme, në të paktën një pjesë të anëtarësisë dhe ndonjëherë edhe në burimet financiare të paraardhësve të tyre. Ato ishin veçanërisht të suksesshme në ato vende ku nuk u sfiduan ose u sfiduan shumë pak nga forca të tjera të majta (Bozóki dhe Ishiyama, 2002:4).

Sa më sipër është një përmbledhje e shkurtër e literaturës akademike mbi sistemin partiak dhe tipologjitë e partive politike. Mbetet megjithatë e rëndësishme të krijohet një model analitik që ndihmon në analizën e rastit shqiptar.

2.2 Modeli Analitik – Të Dhënat dhe Metodat

Për t’iu përgjigjur pyetjes kërkimore ‘*Cili është sistemi partiak dhe cila është struktura dhe organizimi i partive politike shqiptare?*’ punimi bën një analizë të sistemit partiak e cila ndihmon për të kuptuar se sa i qëndrueshëm ose jo është ky sistem partiak, cilat janë partitë relevante të tij, a ka vazhdimësi partish si edhe çfarë marrëdhëniesh krijojnë partitë me elektoratin. Po në vazhdë të përpjekjes për t’i dhënë përgjigje pyetjes kërkimore, punimi analizon gjithashtu edhe legjislacionin dhe burimet e financimit të partive politike, gjë që e ndihmon për të kuptuar se çfarë tipologjie partiake favorizon

legjislacioni sikurse për të parë edhe se cili është burimi kryesor i financimit të veprimtarisë së këtyre partive. Kur burimi kryesor është shteti, kemi të bëjme me parti kartel, ndërsa kur burimi kryesor është anëtarësia atëherë ky është një indikator që flet për rëndësinë e anëtarësisë së partisë dhe identifikon kështu partinë e masave. Në fundmi punimi analizon edhe balancën e brendshme të pushtetit për të parë se cili krah mbizotëron: partia në post-publik apo partia jashtë-parlamentare (për ‘fytyrat’ apo krahët e partisë shih Katz dhe Mair, 1994). Në seksionin e mëposhtëm tregohet çfarë, pse dhe si do të matet dhe analizohet.

Punimi lëvizi midis nivelit makro (studimi i sistemit partiak, matja e luhatshmërisë në nivel sistemi,) dhe nivelit mezzo (marrja në shqyrtim e vetë njësisë së analizës, partisë politike, në lidhje me luhatshmërinë e elektoratit, balancën e brendshme të pushtetit, lidhjet e partisë me shoqërinë si edhe rolin e anëtarësisë partiake). Edhe pse zhvendosja midis dy niveleve mund të duket problematike, mbetet megjithatë e vetmja mënyrë për të kuptuar dinamikat e sistemit partiak si edhe për të hulumtuar partitë që lëvizin në këtë mjedis partiak. Për më tepër, edhe një ndër risitë e studimit qëndron pikërisht në analizën e mos-përputhjes që ekziston ndërmjet luhatshmërisë së elektoratit në nivel blloku partiak dhe asaj në nivel partie dhe si lidhet kjo me elementët përbërës të vetë njësisë së analizës, partisë politike. Në seksionin e mëposhtëm të modelit analitik, shpjegohet se si lidhen këto me njëra – tjetrën dhe se cilat janë pritshmëritë e rezultateve të punimit bazuar në këtë model.

Mbi Sistemin Partiak: Numri efektiv i partive dhe luhatshmëria e elektoratit

Alternimi i pushtetit ndërmjet Partisë Socialiste dhe asaj Demokratike mund të duket i mjaftueshëm për të vendosur *a priori* se cilat janë partitë kryesore të sistemit partiak shqiptar dhe bazuar edhe në literaturën gjithsesi të kufizuar mbi partitë politike shqiptare po

a priori mund të thuhet se ky sistem është dy partiak. Megjithatë duke qenë se për çdo rast këto parti kanë patur nevojë për aleanca me parti më të vogla të cilat kanë qenë relativisht permanente në spektrin politik shqiptar, si edhe dalja në skenë e forcës së re politike Partia Socialiste për Integrim, e cila ka qenë e pranishme në të dyja qeveritë e fundit (2009-2013 dhe 2013-2017) është i nevojshëm një studim më sistematik për të evidentuar partitë kryesore shqiptare.

Kriteri i përdorur për përzgjedhjen e partive politike që do të jenë pjesë e këtij studimi bazohet në konceptin e ‘relevancës’ të Sartorit (2005,[1976]). Sartori e lidh relevancën e partisë me forcën elektorale të partisë dhe këtë të fundit me potencialin e saj për të qeverisur, apo për të qenë në koalicion qeveritar, sepse “ajo çka vërtetë ka rëndësi në balancën e multipartizmit është se sa e nevojshme është një parti si partnere koalicioni për një ose më tepër të shumicave qeverisëse. Një parti mund të jetë e vogël por ka aftësi negociuese të mëdha për të qenë në koalicion. Nga ana tjetër, një parti mund të jetë e fuqishme por i mungon potenciali për të negociuar për të qenë në koalicion” (fq.107-108). Sartori sugjeron se për të përcaktuar nëse një parti është relevante apo jo “mund të heqim partitë që nuk kanë as (i) potencial për koalicion dhe as (ii) potencial për kërcënim. Po kështu duhet të numërojmë të gjitha partitë që kanë ose relevancë qeveritare, pra për të qenë në arenën e formimit të koalicionit, ose relevancë konkurruese në arenën opozitare” (fq.108). Në linjë me këtë informacioni i nevojshëm për studimin është numri i vendeve në parlament që ka fituar secila parti si edhe koalicionet e formuara si edhe kabinetet qeveritare.

Megjithatë koncepti i relevancës nuk është i mjaftë për të kuptuar dinamikat e sistemit partiak në Shqipëri. Për ta realizuar këtë na duhet edhe indeksi partiak (Laakso dhe

Taagepera, 1979) si edhe luhatshmëria e elektoratit (Pedersen, 1979). Indeksi partiak tregon Numrin Efektiv të Partive Parlamentare (NEPP) apo fragmentizimin e sistemit partiak, dhe llogaritet si më poshtë:

$$N = 1 / \sum s_i^2$$

ku 's' është proporcioni i vendeve të partisë 'i'. Indeksi i Fraksionalizimit është i vlefshëm kur përpiqemi të zbulojmë partitë relevante sepse sikurse e thotë edhe Taagepera NEPP zakonisht i përafrohet për llogaritjeve të Sartorit në lidhje me numrin e partive relevante ose së paku 'i' përafrohet aq afër sa ç'mundet një indeks operacional i bazuar thjeshtë mbi shpërndarjen e vendeve, pa patur njohuri të detajuara mbi një vend të caktuar (1999:498).

Megjithatë NEPP na tregon fragmentizimin e sistemit partiak por nuk na tregon se cilat janë partitë dhe cfare peshe kanë ato në sistemin partiak. Për këtë na duhet ta lidhim NEPP-në me tipologjinë e sistemit partiak.

Pavarësisht ekzistencës së një sërë klasifikimesh të sistemit partiak (Blondel 1969; Sartori 1976) në këtë punim do të përdoret analiza e Siaroff (2000) jo vetëm se është më bashkëkohore, por sepse në ndryshim nga analizat e mësipërme e tregon më qartë jo vetëm numrin e partive në një sistem partiak por edhe peshën e tyre në këtë sistem dhe kjo jep mundësi për të bërë një analizë më të saktë. Kështu Siaroff merr në konsideratë masën dhe forcën relative të partive politike, balancën ndërmjet tyre dhe numrin e partive relevante dhe krijon një tipologji me tetë kategori: 1) sistem i pastër dy partiak (dy parti fitojnë 95% të vendeve në parlament); 2) sistem dy partiak e gjysëm; 3) sistem multipartiak i moderuar me një parti dominuese; 4) sistem multipartiak i moderuar me dy parti dominuese; 5)

sistem multipartiak i moderuar me balancë ndërmjet partive; 6) sistem multipartiak ekstrem me një parti dominuese; 7) sistem multipartiak ekstrem me dy parti dominuese dhe; 8) sistem multipartiak ekstrem me balancë ndërmjet partive. Është e rëndësishme gjithashtu të sqarohet se Siaroff nuk i konsideron këto tipologji si sisteme partiake, por u referohet më së shumti si prirje, modele (*patterns*) të forcës së partisë, të cilat mund të ndryshojnë nga njëra palë zgjedhje në tjetrën.

Sipas Siaroff, klasifikimi i sistemit partiak përcaktohet nga kombinimi i një sërë faktorësh që janë: 1) numri mesatar i partive me të paktën 3% të vendeve në parlament – P3%S; 2) mesatarja e përqëndjes së vendeve në parlament të dy partive kryesore – 2PSC; 3) mesatarja e raportit të vendeve ndërmjet partisë së parë dhe të dytë – SR 1:2; dhe 4) mesatarja e raportit të vendeve në parlament ndërmjet partisë së dytë dhe asaj të tretë – S2:3 (kap.3).

Përsa i përket tiparit tjetër të sistemit partiak, luhatshmërisë së elektoratit, punimi e përllogarit atë në dy forma: luhatshmëria në nivel partiak dhe luhatshmëria në bllok. Luhatshmëria elektorale në nivel partiak matet duke përdorur Indeks të Pedersen-it (1979) i cili mbledh ndryshimet absolute në ndarjen e votave nga një palë zgjedhje në tjetrën, për të gjitha partitë politike (në këtë studim do të matet për partitë e marra në shqyrtim). Kjo shumë, e cila quhet ndryshimi total neto, ndahet në dy, duke qenë se një zhvendosje e votës të numërohej dy herë (humbja për njëri parti është fitore për partinë tjetër). Konkretisht formula përmes së cilës matet indeksi i luhatshmërisë së elektoratit është:

$$\text{Luhatshmëria } (V_t) = 1/2 \times \text{TNC}_t$$

$$0 \leq V_t \leq 100$$

Ku V_t është vlera numerike e grumbulluar për të gjitha votat e fituara nga partitë fituese në sistemin partiak, vlera numerike e grumbulluar prej të gjitha votave të humbura nga partitë humbëse. Ajo shprehet në terma të përqindjes. Luhatshmëria tregon ndryshimet që ka mbështetja e një partie nga një palë zgjedhje në zgjedhjet e tjera pasuese. Sipas Pedersen 'edhe pse zgjedhjet nuk janë janë evenimente determinuese, ato mbeten megjithatë pika më avantazhuese për të studjuar ndryshimin, sepse ndryshimi ose do të jetë rezultat i zgjedhjeve, ose zgjedhjet do të regjistrojnë çdo ndryshim që mund të ndodhë në sistemin partiak' (1979:5).

Ndërsa luhatshmëria në bllok matet duke u mbështetur tek Bartolini dhe Mair (1990) duke patur parasysh kriteret që ata vendosin për të grupuar një parti në një bllok apo në një tjetër (shih Kapitullin 3). Luhatshmëria në bllok është e rëndësishme sepse luhatshmëria nuk është thjesht matje e ndryshimit të mbështetjes elektorale për një apo disa parti politike. Në rast se do të kuptohej vetëm kështu, luhatshmëria elektorale nuk do të merrte parasysh dinamikat e sistemit partiak si ndarjet, shkrirjet, ndryshimet e emrave dhe hyrjen e partive të reja, të gjitha këto shumë tipike për politikën post-komuniste. ***Ndërkaq, për rastin e Shqipërisë, luhatshmëria në bllok është e nevojshme për të kuptuar se pse sistemi partiak edhe pse stabil ka përjetuar nivele të larta luhatshmërie në nivel partie.***

Gherghina (2013) i jep luhatshmërisë elektorale një shpjegim institucional, ku sipas tij organizimi partiak (përzgjedhja e kandidatëve, anëtarësia dhe ri-përzgjedhja e deputetëve) është faktori kyç që mund të shpjegojë luhatshmërinë në nivel partiak. Ai e konsideron luhatshmërinë në bllok si të panevojshme duke qenë se sistemet partiake post-komuniste nuk janë të qëndrueshme për shkak të hyrjes dhe daljes së partive politike gjë që bën që kompozimi i sistemit partiak të mos jetë asnjëherë njësoj nga njëra palë zgjedhje në

tjetrën, dhe duke qenë se jo të njëjtat parti kanë marrë pjesë në të gjitha zgjedhjet, sistemi partiak nuk mund të bëjë dallim ndërmjet luhatshmërisë së shkaktuar prej partive të përhershme në sistem dhe luhatshmërisë së shkaktuar prej hyrjeve të reja (19). Megjithatë duke qenë se premisa e punimit është që sistemi partiak ka treguar qëndrueshmëri për sa i përket kompozimit të tij (PS dhe PD kanë alternuar vazhdimisht pushtetin) atëherë ky pretendim bie. Në fakt pritshmëria është që luhatshmëria në nivel partiak dhe në nivel sistemi të jetë e njëjtë duke qenë se ajo shkaktohet kryesisht për shkak të PD dhe PS, dhe ajo që ndryshon në fakt pritet që të jetë luhatshmëria në bllok, andaj edhe punimi i merr të dyja nivelet e analizës në konsideratë: makro (sistemi partiak dhe blloqet partiake) dhe mezzo (partia). Sepse vetëm duke e parë luhatshmërinë elektorale për të tria këto njësi mund të jemi në gjendje t'i kuptojmë më mirë dinamikën e sistemit partiak në Shqipëri. Për më tepër, luhatshmëria në bllok është e nevojshme gjithashtu edhe për shkak se me ndryshimet zgjedhore të vitit 2008, tashmë konkurrenca partiake në dy zgjedhjet e fundit (2009 dhe 2013) është manifestuar si konkurrencë ndërmjet blloqesh.

Analiza në nivel partiak: financat – shoqëria – balanca e brendshme e pushtetit

Punimi mbështetet në qasjen neo-institucionaliste (van Biezen, 2003) dhe historiko-strukturore (Kitschelt et.al.1998) ku konteksti institucional dhe kuadri historik në të cilin shfaqet dhe operon partia luajnë rol determinues.

Në këtë linjë, pritshmëritë për partitë politike në vendet post-komuniste ishte që, konteksti në të cilin u shfaqën pjesa më e madhe e tyre, me të gjitha gjasat favorizon një zhvillimin organizacional të partisë ku partia në post publik (parlament dhe qeveri) shfaqet dhe fiton më tepër peshë para se të krijohet organizata jashtë-parlamentare, dhe për pasojë

kjo pasqyrohet në organizimin e partisë ku partia në post publik (Katz dhe Mair, 1994) ka më tepër peshë mbi partinë si të tërë. Për më tepër duke parë se partitë në demokracitë e reja iu desh që ta ndërtonin organizatën prej ‘hiçit’ dhe po kështu duke qenë se konteksti në të cilin u shfaqën me të gjitha gjasat çon drejt dhënies prioriteteve elektorale dhe jo strategjive për ndërtimin e organizatave me shtrirje të gjerë territoriale, pritshmëria për partitë politike në vendet post-komuniste ka qenë që lidhjet me shoqërinë të ishin të dobëta, anëtarësia të kishte rëndësi të paktë në organizatën në tërësi, dhe aktiviteti jashtë-parlamentar të ishte në varësi të profesionistëve dhe jo të anëtarëve që kryejnë punë vullnetare. Gjithashtu, për shkak të origjinës institucionale që patën, pritshmëria ishte që partitë të orientoheshin drejt dhe të kishin lidhje të forta me shtetin si edhe të karakterizoheshin nga një përqëndrim i lartë rreth udhëheqjes/sit.

Megjithatë, van Biezen (2003) vëren se jo të gjitha këto pritshmëri përmbushen. Kështu, në lidhje me balancën e brendshme të pushtetit, partitë politike në vendet post-komuniste e kanë më të zhvendosur balancën drejt organizatës sesa imazhit publik të partisë (van Biezen, 2001:14) për shkak të nivelit të ulët të institucionalizimit partiak sikurse edhe nivelit të ulët të besnikërisë ndaj partisë, gjë që sjell nivel të ulët stabiliteti ndër-partiak. Kjo mund të vihet re në numrin e madh të ndarjeve dhe shkrirjeve të partive, në një kohë që një fenomen i tillë në vendet me demokraci të qëndrueshme është i limitizuar (Mair, 1990). Andaj për të ruajtur unitetin e partisë, partitë politike në vendet post-komuniste e kanë parë forcimin e partisë jashtë-parlamentare si një mekanizëm për të kontrolluar partinë në post-publik. *Në këtë kontekst, pritshmëria është që edhe Shqipëria, sikundër edhe simotrat e saj, të inkorporojë një numër të madh deputetësh në ekzekutivin*

e partisë për të rritur kohezionin e saj, duke i dhënë më tepër kështu peshë, partisë jashtë-parlamentare sesa asaj në post publik.

Në lidhje me rëndësinë e anëtarësisë, profesionistëve dhe udhëheqjes së partisë, pritshmëria është që anëtarësia të ketë rëndësi të paktë në organizatën në tërësi, dhe se aktiviteti jashtë-parlamentar të jetë në varësi të profesionistëve dhe jo të anëtarëve që kryejnë punë vullnetare.

Për ta analizuar këtë është e rëndësishme të analizohet struktura organizacionale e krahut jashtë-parlamentar për të parë nëse mbështetet apo jo mbi anëtarësimin formal dhe ç'rol luan dega lokale. Po kështu është e rëndësishme të shihet se sa e vështirë është të bëhesh anëtar i partisë. Normalisht një kufi i ulët hyrjeje, pra një model i hapur anëtarësimi është tipar i partisë së masave, në përputhje me 'shpikjen Socialiste' dhe në ndryshim nga modeli i mbyllur i partisë së kuadrove (Duverger, 1954:23). Në modelin e partisë së masave dega lokale është vetëm pjesë e të tërës dhe nuk mund të jetojë më vete, në mënyrë autonome siç ndodh me *kaucusin* e partisë së kuadrove (fq.23). Andaj është e rëndësishme të shihet se ç'lloj 'artikulimi' kanë nivelet e ndryshme organizative brenda partisë. Në 'artikulimin' vertikal, tipar i partisë së masave, nivelet më të ulëta organizative përfaqësohen në organet më të larta, organizata partiake ka një strukturë 'piramide' (nga poshtë-lartë) me kongrese dhe asamble në të gjitha nivelet e saj, në të cilët marrin pjesë delegatë të zgjedhur në nivelet e ulëta dhe që janë të konceptuara si organe përfaqësuese të anëtarësisë së partisë. Tipar tjetër është që organet ekzekutive përgjithësisht zgjidhen dhe janë llogaridhënës ndaj këtyre asambleve/kongreseve. Së fundmi, një tipar tjetër i partisë së masave është se kongresi është autoriteti më i lartë vendim-marrës në organizatë. Ky tipar i partisë së masave është ruajtur në të gjitha partitë e Evropës Perëndimore (pavarësisht se

ato shfaqin tipologji të tjera partiake) dhe po kështu shfaqet në të njëjtën mënyrë edhe në vendet post-komuniste gjë që thekson rëndësinë, së paku formale, që i jepet ende anëtarësisë (van Biezen, 2003).

Tipar tjetër i partisë së masave është që anëtarësia është baza e vetme mbi të cilën strukturohet krahu jashtë-parlamentar i partisë. Pra, madhësia e saj është përcaktuese se ç'pjesë në përfaqësim do të zënë strukturat në nivelet e ulëta në kongreset e partisë, apo në organe të tjera kombëtare. Përkundër kësaj, partitë e orientuara elektoralisht dhe jo rreth anëtarësisë, adoptojnë një strukturë organizacionale që bazohet në nivelet e mbështetjes elektorale (van Biezen, 2003).

Për të analizuar rastin e Shqipërisë është e nevojshme të shihet nëse ndiqet e njëjta mënyrë tradicionale e përzgjedhjes së udhëheqësve të partisë apo kemi pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të anëtarësisë (një anëtar-një votë), të analizohet frekuenca me të cilën mbledhen kongreset e partisë, cili organ e ka peshën më të madhe ose të vetme të vendim-marrjes, niveli i centralizimit ose jo rreth lidshimit të partisë, rëndësia që ka anëtarësia vullnetare përkundërt profesionistëve që punësohen me pagesë për të kryer punët e partisë. Po kështu është e rëndësishme të shihet përqindja që zë përfaqësimi *ex officio* në organet e partisë, si për shembull në kongresin e partisë.

Pritshmëria është që ashtu sikurse në vendet post-komuniste, dallimi ndërmjet anëtarëve dhe jo-anëtarëve të jetë jo fort i qartë dhe që koncepti i anëtarësisë partiake ta ketë humbur relevancën e vet. Në këtë këndvështrim, ruajtja e imazhit të partisë si një organizatë e bazuar mbi anëtarësinë është kthyer në fakt një strukturë në letër që e ka humbur tërësisht thelbin e saj (van Biezen, 2003).

Marrëdhënia parti-shoqëri është e rëndësishme të analizohet sepse këtu mund të kuptohet sesa janë në gjendje partitë politike të angazhojnë qytetarët në politikë. Pritshmëria është që ashtu sikundër në vendet post-komuniste ku partitë politike nuk arrijnë t'i angazhojnë qytetarët në të njëjtën masë që e bënë në fillimet e tyre partitë politike në demokracitë e konsoliduara (van Biezen, 2003) edhe në Shqipëri shfaqet i njëjti fenomen. Për këtë duhet bërë një analizë diakronike e niveleve të anëtarësisë për të parë nëse partitë kanë patur apo jo mundësinë të zgjerohen nga njëra palë zgjedhje në tjetrën si edhe raportin që zë anëtarësia me elektoratin e partisë. Po kështu në këtë seksion është e rëndësishme të shihet shtrirja gjeografike e partive, pra cili është mbulimi i tyre territorial sikurse edhe prania e tyre në politikën lokale. Van Biezen (2001) merr si indikator të matjes së prezencës partiake në politikën lokale, afiliacionin partiak ose jo të kandidatëve në zgjedhjet lokale. Në rastin kur në zgjedhjet lokale kandidatët nuk kanë afiliacion politik, pra kandidojnë si të pavarur, kjo flet për një profil të ulët të partisë në shoqëri. Pra mund të thuhet se *kur ka një depërtim të ulët territorial të organizatës partiake dhe kur kandidaturat në zgjedhjet lokale janë të pavarura, kjo bën që partitë të jenë të distancuara prej sektorëve të gjerë të shoqërisë, dhe për pasojë lidhjet partizane nuk arrijnë të shërbejnë si kanale për të strukturuar marrëdhënien ndërmjet partisë dhe shoqërisë.*

Përveç dobësisë së lidhjeve partizane në vetvete, në këtë pjesë duhen parë edhe nëse natyra e marrëdhënieve ndërmjet partisë dhe shoqërisë formësohet prej lidhjeve direkte apo indirekte. Me lidhje indirekte kuptohet lidhja që krijon partia me shoqërinë përmes organizatave të rinisë, të gruas por sidomos me grupet e tjera të interesit si për shembull sindikatat. Duke qenë se *partitë politike në Shqipëri, ashtu sikundër në vendet e tjera*

post-komuniste, nuk lindën prej përplasjes së interesave të ndryshme sociale, kjo ka bërë që ato të mos zhvillonin lidhje të ngushta dhe të formalizuara me lëvizjet e organizuara, përfaqësuese të segmenteve të caktuara të shoqërisë.

Përveç kontekstit institucional, faktorë konjunkturalë të periudhës në të cilën u shfaqën partitë politike, veçanërisht aksesit në fondet publike dhe në *mass media*, kanë ndikuar gjithashtu në organizimin e partive politike. Ndërsa rolin e mass-medias e trajtuam në kapitullin hyrës të punimit, në seksionin e rrisë së tij, roli i fondeve publike trajtohet në një kapitull të veçantë.

Sipas Lewis (1996:13) për partitë politike në vendet post-komuniste ‘shteti mbetet një pikë kyçe vëmendjeje dhe një pikë qendrore orientimi’. Për sa i përket fondeve publike, mund të thuhet se shteti ka një ndikim kyç në organizimin partiak sepse ai ka forcuar lidhjet parti-shtet dhe në të njëjtën kohë ka përforcuar atë mënyrë organizimi të diktuar nga konteksti ku këto parti u krijuan. Ndërsa në demokracitë e vjetra, partitë politike patën mundësi të kishin akses ndaj fondeve publike vetëm pas institucionalizimit të sistemit partiak, në demokracitë e reja ato (partitë) u shfaqën në një kontekst politik ku ato kishin mundësi të sponsorizoheshin nga shteti. Sipas van Biezen ‘fondet shtetërore ... u sigurojnë partive një burim relativisht të qëndrueshëm dhe të sigurt të ardhurash, dhe për pasojë largojnë incentivat për të kërkuar burime të tjera fondesh’ (fq.40). Në këtë mënyrë partitë politike shqiptare pritet të kenë zhvilluar lidhje të forta financiare me shtetin që prej fillimit.

Për Duverger (1954), një prej faktorëve kryesorë që kontribuoi në krijimin e partisë së masave është se anëtarësia ishte e domosdoshme për të siguruar financat e partisë përmes kuotizacionit dhe punës vullnetare (fq.63). Në kontekstin e ri, financimi shtetëror i

partive e bën të panevojshëm kuotizacionin, duke reduktuar kështu nevojën për të krijuar parti masash. Për më tepër, sikurse e kanë vënë në dukje dhe Katz dhe Mair (1995), financimi shtetëror i partive politike rezultoi në krijimin e partisë kartel, sepse i çoi partitë në varësi të shtetit dhe i orientoi drejt tij. Një pasojë tjetër e fondeve publike është se, duke qenë se fonde të tilla alokohen mbi bazën e 'performancës elektorale të partive dhe përfaqësimit të tyre parlamentar, partitë i drejtohen më së shumti elektoratit në përgjithësi sesa anëtarësisë së tyre, duke u kthyer kështu në parti 'Catch-All' (kap gjithçka) (Kirscheimmer,1966) ose në parti elektorale-profesionale (Panebianco, 1988) dhe jo parti masash. Andaj, 'fondet publike mund të forcojnë orientimin e partive drejt lidhjeve të natyrës *ad hoc* dhe afat-shkurtra me elektoratin, sesa drejt zhvillimit të marrëdhënieve më strukturore dhe më të përhershme ndërmjet organizatës së partisë dhe shoqërisë (van Biezen, 2003: 40).

Në lidhje me sa më sipër, në analizën e rastit shqiptar është e rëndësishme të bëhet një analizë e legjislacionit shqiptar mbi financimin e partive politike për të parë nëse ky legjislacion inkurajon lidhje më të forta të partisë me shtetin apo me shoqërinë/anëtarësinë. Po kështu punimi merr në shqyrtim edhe fondet dhe shpenzimet e partive politike për ta parë se ç'përqindje zënë fondet publike dhe të ardhurat nga anëtarësia. Kur përqindja më e madhe e të ardhurave rezulton nga fondet publike, kjo flet për lidhje me të forta të partisë me shtetin dhe kur përqindja është më e lartë për fondet e siguruar nga anëtarësia atëherë kemi një parti të orientuar më tepër drejt shoqërisë.

Për ta përmbledhur modelin teorik, punimi fokusohet në analizën e:

- Sistemit partiak: Numri Efektiv i Partive – luhatshmëria e elektoratit
- Rëndësisë së Anëtarësisë, Profesionistëve dhe Udhëheqjes së Partisë.

- Lidhjes së Partisë me Shoqërinë.
- Balancën e pushtetit mes partisë parlamentare (partisë në post-publik) dhe partisë jashtë-parlamentare.
- Fondeve Publike tek partitë politike shqiptare për të parë nëse këto fonde publike ndikojnë apo jo në etatizimin e tyre.

Punimi teston hipotezën se: *Sistemi partiak shqiptar është i qëndrueshëm. Luhatshmëria e lartë në nivel partiak dhe sistemi, e shoqëruar me indeks fragmentizimi konstant dhe luhatshmëri të ulët në bllok, është indikator që partitë politike e kontrollojnë elektoratin dhe procesin e votimit. Kjo flet për lidhje të forta të partisë me elektoratin, gjë që në mungesë të ndarjeve të qarta shoqërore, dhe paqartësisë ideologjike të partisë dhe elektoratit, shpjegohet me natyrën klienteliste të marrëdhënieve mes elitave politike dhe elektoratit.*

Punimi është mbështetur si në analizën e burimeve primare ashtu edhe në ato sekondare. Burimet primare konsistojnë në raportet financiare të partive politike, statutin e partive, raportet e zgjedhjeve, ligjet mbi aktivitetin e partive politike në Shqipëri, raportet mbi mbulimin mediatik të partive politike, artikuj gazetash në lidhje me partitë politike. Burimet dytësore konsistojnë në literaturën e gjerë të shkruar mbi partitë politike në vendet perëndimore, post-komuniste dhe në Shqipëri.

Punimi ka edhe disa kufizime të cilat lidhen me mungesën e burimeve primare në lidhje me financat e partive politike për periudhën 1991-2005, apo me besueshmërinë e numrit të anëtarësisë së partive politike. Megjithatë po të kihet parasysh sasia e vogël e punimeve akademike të zhvilluara në lidhje me partitë politike, mungesa e të dhënave në

lidhje me to, sidomos në dekadën e parë, janë megjithatë të kuptueshme dhe nuk ja ulin aspak cilësinë.

KAPITULLI III – SISTEMI PARTIAK NË SHQIPËRI

3.1. Çfarë është Sistemi Partiak

Çfarë sistemi partiak kemi në Shqipëri? Sa i fragmentuar është dhe a ka luhatshmëri të lartë apo të ulët elektorale? Këto janë pyetjet kryesore të cilat synon të sqarojë ky kapitull. Studimi ekzaminon partitë politike në Shqipërinë post-komuniste në më shumë se dy dekadat e fundit me synimin për të ekzaminuar marrëdhëniet ndërmjet strukturave të brendshme të partive dhe mbështetjes së tyre elektorale.

Lane dhe Ersson (1994: 4-5) identifikojnë këta indikatorë që karakterizojnë sistemin partiak:

- Numri i çështjeve që krijojnë strukturën e ndarjeve në sistemin partiak dhe polarizimi (distanca ideologjike ndërmjet partive);
- Numri efektiv i partive dhe Indeksi i fraksionalizimit;
- Luhatshmëria totale: ndryshimi agregat i votave për partitë politike ndërmjet zgjedhjes të njëpasnjëshme.

Duke qenë se ndarjet programatike në vendet post-komuniste nuk janë të qarta dhe përgjithësisht partitë politike janë jo-programatike (Kitschelt et.al., 1998), në këtë kapitull do të fokusohemi vetëm në çështjet e mëposhtme:

- a- Numri efektiv i partive dhe fragmentizimi i sistemit partiak
- b- Luhatshmëria e elektoratit në nivel sistemi
- c- Luhatshmëria e elektoratit në nivel blloku partish
- d- Luhatshmëria e elektoratit në nivel partie

Numri efektiv i partive si edhe luhatshmëria elektorale janë indikatorë që flasin për qëndrueshmërinë e sistemit partiak dhe janë ngushtësisht të lidhur me tipologjinë partiake, lidhje për të cilën do flitet gjerësisht në kapitullin konkludues.

3.2 Sistemi Partiak në Shqipëri: përbërja e parlamentit dhe e qeverisë

Për të kuptuar dinamikën e sistemit partiak është e rëndësishme të kuptohet se cilat janë partitë e këtij sistemi. A janë të gjitha partitë e krijuara, të gjitha partitë që marrin pjesë në zgjedhje apo vetëm ato që bëjnë pjesë në parlament? ‘Numri i partive’ është një koncept i kontestueshëm sepse studjuesit shpesh nuk bien dakort se si t’i përlllogarisin partitë që kanë përmasa të ndryshme por edhe relevanca të ndryshme (Webb, 2000: 4-5). Ashtu sikundër është thënë edhe në pjesën e modelit analitik (pjesa 2.2) partitë që duhen numëruar në sistemin partiak janë ato relevante (Sartori, 1976:107, 119-25, 186-92, 300-4; 1994:33-40). Numri i partive relevante mund të ndihmojë të kapen tipare të rëndësishme të sistemit partiak. Sipas Sartorit:

...është e rëndësishme të dihet se sa parti janë. Një gjë është e sigurtë, numri i partive tregon menjëherë, megjithëse afërsisht, një tipar të rëndësishëm të sistemit politik: masën në të cilën pushteti politik është i fragmentizuar apo jo, i shpërndarë apo i përqendruar. Kështu, thjeshtë, duke ditur se sa parti janë, ne informohemi mbi numrin e ‘rrymave të mundshme të ndërveprimit’. ... dy parti lejojnë për një rrymë ndërveprimi reciprok, ... pesë parti për dhjetë, ... shtatë parti për njëzetënjë... Është e qartë se sa më i madh numëri i partive (që kanë zë), aq më i madh është kompleksiteti i sistemit ... në veçanti, taktikat e konkurrencës partiake dhe të opozitës shfaqen të lidhura me numrin e partive; dhe nga ana tjetër kjo ka pasoja mbi formimin e koalicioneve partiake dhe performancën e tyre (Sartori, 2005, fq.106).

Në këtë kontekst është e rëndësishme të dihet se si ka qenë kompozimi i Kuvendit të Shqipërisë përsa i përket përbërjes partiake dhe të shihet nëse të gjitha partitë parlamentare janë relevante ose jo. Në tabelën e mëposhtme tregohet shpërndarja e vendeve në parlament duke filluar që nga zgjedhjet e para pluraliste në vitin 1991 dhe duke vazhduar deri në zgjedhjet e fundit pluraliste të vitit 2013²:

Tabela 1: Numri i vendeve në parlament për partitë politike gjatë periudhës 1991-2013³

Partitë ⁴ / Viti i zgjedhjeve të përgjithshme	PS	PD	PR	PSD	PBDNJ	LSI	PDIU	PA	PAD	PDC	PDR	PVD	PVM	Pav.
1991	170 ⁵	75			5									
1992	38	92	1	7	2									
1996	10	122		3	3							2		
1997	102	26	1	9	4			1	2	1		8	1	

² Tabela paraqet të dhëna vetëm për përbërjen e Kuvendit të krijuar menjëherë pas zgjedhjeve. Ndryshimet e mëpasme që çdo legjislaturë ka pësuar si rezultat i ndarjeve partiake, apo shkëputjes së deputetëve prej një partie tek një tjetër, ose më vete, nuk janë pjesë e studimit sepse këto shkëputje nuk janë rezultat i votimit, por i zgjedhjeve individuale të deputetëve.

³ Burimi i të dhënave është marrë nga raportet mbi zgjedhjet të Komisionit Qendror Zgjedhor, OSBE-së, IFES (International Foundation for Electoral Systems) dhe për zgjedhjet e vitit 1991 dhe 1992 nga libri i Afrim Krasniqit, *Zgjedhjet në Shqipëri: 1990-2009*.

⁴ PS = Partia Socialiste; PD= Partia Demokratike; PR = Partia Republikane; PSD = Partia Social Demokrate; PBDNJ; Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut; LSI = Lëvizja Socialiste për Integrim; PDIU = Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet; PA = Partia Agrare; PAD = Partia Aleanca Demokratike; PDK = Partia Demokristiane; PDR = Partia Demokratike e Re; PVD = Parti të vogla në të djathtë; PVM = Parti të vogla në të majtë; Pav = Kandidatë të pavarur.

⁵ Në zgjedhjet e vitit 1991, në konkurim ishte Partia e Punës e Shqipërisë e cila më pas në po atë vit u quajt Partia Socialiste. Në këto zgjedhje ajo fitoi 169 vende në parlament. Megjithatë në këtë shifër është përfshirë edhe kandidati i Komitetit të Veteranëve, duke qenë se Komiteti i Veteranëve ishte një prej organizatave që vareshin prej Partisë së Punës.

Partitë ⁴ / Viti i zgjedhjeve të përgjithshme	PS	PD	PR	PSD	PBDNJ	LSI	PDIU	PA	PAD	PDC	PDR	PVD	PVM	Pav.
2001	73	32	5	4	3			3	3		6	9		2
2005	42	56	11	7	2	5		4	3		4	1	2	1
2009	66	68	1			4	1							
2013	66	49	3		1	16	4						1	

Në zgjedhjet e para demokratike në vitin 191, Parlamenti Shqiptar kishte 250 deputetë, ndërsa në zgjedhjet e mëvonshme ka patur 140 deputetë, me përjashtim të zgjedhjeve të vitit 1997 ku patur 155 deputetë. Është e rëndësishme të thuhet se tabela e mësipërme nuk e përmban të gjithë informacionin. Në rastin kur një parti nuk është shfaqur në më tepër se një palë zgjedhje apo nuk ka fituar ndonje vend në parlament në më tepër se një palë zgjedhje atëherë ajo nuk listohet më vete por vendoset nën titullin PVD (Parti të Vogla në të Djathtë) dhe tregon numrin e vendeve në parlament për më shumë se një parti që i përket spektrit të djathtë. Në rastin kur partia është e krahut të majtë, atëherë ajo vendoset nën titullin PVM që do të thotë Parti të Vogla në të Majtë dhe sërisht tregon numrin e vendeve në parlament për më tepër se një parti të majtë.

Në zgjedhjet e vitit 1991, 1997, 2001, 2013, fituese ka qenë PS me respektivisht 68%, 65.8%, 52.14 dhe 47.14% të vendeve në parlament. Në zgjedhjet e vitit 1992, 1996, 2005 dhe 2009 fituese ka qenë PD me respektivisht 65.7%, 87.14%, 40% dhe 48.57%. Sikurse e tregon edhe tabela, në vitet 1991, 1992, 1996, 1997 dhe 2001, partitë fituese, si PS ashtu edhe PD kanë qenë në gjendje ta formojnë vetë qeverinë, pa hyrë në koalicion me

parti të tjera. Ndërsa në vitet 2005, 2009 dhe 2013 ato e kanë patur të domosdoshme koalicionin me parti të tjera. Në këtë kuadër, sistemi partiak shqiptar duket sikur nuk ka parti relevante përveç dy partive kryesore në periudhën 1991-2001. Duket sikur asnjë parti ‘e vogël’ nuk ka potencial për koalicion apo për kërcënim. E megjithatë, në tabelën e mëposhtme që tregon shpërndarjen e portofoleve në kabinetet qeveritare gjatë periudhës 1991-2013, mund të vihet re edhe prezenca e partive të tjera të vogla.

Tabela 2: Shpërndarja e Portofoleve në Kabinetet Qeveritare: 1991-2013

Viti/Nr. i ministrave sipas përkatësisë partiake	PD	PS	PR	PSD	PBDNJ	LSI	PAA	PAD
1991		19 ⁶						
1992 ⁷	20 ⁸		1					
1996 ⁹	22	-	2	-	-	-	-	

⁶ Zyhdi Pepa dhe Vilson Ahmeti janë të pavarur por te propozuar nga Partia e Punës (më pas Partia Socialiste), andaj edhe këtu janë llogaritur si anëtarë të Partisë së Punës.

⁷ Shifrat e vitit 1992 flasin vetëm për Qeverinë e Parë të kryesuar nga Kryeministri z. Aleksandër Meksi e cila e ushtroi veprimtarinë e saj gjatë periudhës 13 prill 1992 – 6 gusht 1993. Më pas ka patur edhe 2 qeveri të tjera Meksi deri në zgjedhjet e vitit 1996, por ato nuk janë marrë në shqyrtim, duke qenë se qëllimi i punimit është të shikojë lidhjen që ekziston ndërmjet sistemit elektoral dhe shpërndarjes së pushtetit ndër partitë në koalicion. Qeveritë e tjera janë krijuar si rezultat rrethanash që nuk kanë lidhje me sistemin elektoral, por kanë të bëjnë me problem të Shqipërisë në tranzicion andaj edhe nuk janë shqyrtuar në këtë punim.

⁸ Në këtë shifër janë llogaritur edhe Ministrat Abdyl Xhaja dhe Kudret Cela që konsiderohen si të pavarur por të propozuar nga Partia Demokratike. Z. Abdyl Xhaja ka kandiduar si deputet i PD në vitin 1996 dhe 1997, ndërsa z. Kudret Cela ka kandiduar si deputet i PD në zgjedhjet e vitit 1996 dhe kjo është parë e mjaftueshme për të kuptuar afiliacionin e tyre politik. Po kështu në këto shifra janë llogaritur edhe poste në rang ministri si: Sekretari i Përgjithshëm (Vullnet Ademi), Kryetari i Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë (Maksim Konomi), Kryetari i Komisionit të Kontrollit (Blerim Çela) dhe Kryetari i Komitetit të ëish të përndjekurve politikë (Eduart Ypi).

⁹ Në këtë shifër janë përfshirë edhe Sekretarët e Shtetit, duke qenë se postet e tyre janë politike dhe konsiderohen si pjesë e kabinetit qeveritar.

1997	-	13	-	2	1	-	2	3
------	---	----	---	---	---	---	---	---

2001	-	17	-	-	1	-	1	
2005	11	-	2	-	-	-	1	
2009	9	-	1	-	1	3	-	
2013	-	15	-	-	-	6	-	

Prania e partive të vogla në përbërjen e kabinetit qeveritar shpjegohet për shkak të dy faktorëve. Faktori i parë ka të bëjë me kushtin konstitucional për të aprovuar ligje me shumicë të cilësuar. Për pasojë një shumicë e thjeshtë prej 50% + 1 nuk ishte e mjaftueshme. Sipas Kushtetutës Shqiptare në mënyrë që të aprovohen ligje të rëndësishme si edhe për të zgjedhur presidentin e Republikës, është i nevojshëm miratimi i 3/5 të parlamentit (84 deputetë) (Neni 81, 87)¹⁰. Tabela 1 tregon se në zgjedhjet e vitit 1992, 1996 dhe 1997 fituesit (respektivisht, PD, PD dhe PS) fituan më tepër se 3/5 e vendeve në parlament dhe për pasojë nuk kishin nevojë për të krijuar qeveri në koalicion. Prania e partive të vogla në kabinet shpjegohet me aleanca parazgjedhore dhe kanë më tepër kuptim simbolik. Për Partinë Demokratike, prania e Partisë Republikane në kabinet është e nevojshme për të treguar se fronti antikomunist është më i gjerë se sa Partia Demokratike, ndërsa prania e partive të vogla për Partinë Socialiste në kabinetin e vitit 1997 është gjithashtu i rëndësishëm për të treguar se fronti anti-Parti Demokratike është më i gjerë sesa Partia Socialiste. Me të vërtetë zgjedhjet e vitit 1997 u mbajtën në mënyrë të parakohshme dhe erdhën si pasojë e krizave piramidale ku humbën kursimet e tyre mijëra familje

¹⁰ Ky rregull ka qenë i vlefshëm deri në vitin 2008, ku me ndryshimet konstitucionale të miratuara nga dy partitë kryesore (PD dhe PS) votimi me shumicë të cilësuar nuk është më i domosdoshëm për zgjedhjen e presidentit, i cili në raundin e katërt dhe të pestë mund të zgjidhet edhe me një shumicë të thjeshtë, pra me 50%+1 i të gjithë deputetëve.

shqiptare, por edhe pasuan zgjedhjen shumë të kontestuara të vitit 1996 të fituara ndjeshëm nga Partia Demokratike. Pra, me anë të këtyre partive të vogla, si PD ashtu edhe PS u përpoqën të krijonin imazhin e një qeverisjeje gjithëpërfshirëse, në mënyrë që të rrisnin legjitimitetin e tyre politik si në mjedisin e brendshëm, ashtu edhe në sytë e komunitetit ndërkombëtar. Megjithatë përveç pranisë simbolike, partitë e vogla nuk mund të kushtëzonin veprimtarinë parlamentare apo qeveritare të PD dhe PS në këto vite, andaj mund të konkludohet se ato ishin me të vërtetë jo-relevante, pavarësisht vendeve që kishin në parlament.

Historia tregon një tjetër narrativë pas zgjedhjeve të vitit 1997. Duke filluar prej zgjedhjeve të vitit 2001, asnjë prej partive ‘të mëdha’ nuk ka qenë në gjendje të fitojë shumica të cilësuar apo madje as edhe shumicë të thjeshtë. Në këto kushte ishte e nevojshme prania e partnerëve në koalicion. Por cilat janë partitë relevante? Partitë ‘e mëdha’ i përzgjedhën vetë këto koalicione partiake. Kjo gjë u mundësua prej formulës elektorale. Gjatë periudhës 1992-2005 në Shqipëri janë organizuar pesë zgjedhje të përgjithshme, sipas sistemit elektoral të përzier: 100 deputetë zgjidheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë në zona një emërore sipas parimit të sistemit maxhoritar, ndërsa 40 deputetë zgjidheshin në mënyrë proporcionale prej listave partiake (Edgeworth and Soares, 1992, 39; De Gregorio et. al, 1996, 4; Kaplan dhe Knapp, 1997, 30; OSCE, 2001, 4; OSCE, 2005, 4, Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 64). Në zgjedhjet e vitit 2001 dhe 2005 Partia Demokratike dhe Socialiste aplikuan votimin strategjik duke i bërë thirrje elektoratit të votonin për partnerët në koalicion në votimin në proporcional, në këmbim të votave të simpatizantëve të partive të vogla në votimin në maxhoritar (ODHIR, 2001, 17-17; ODHIR, 2005, 30).

Ndërkaq, si në zgjedhjet e vitit 2009 ashtu edhe në ato të vitit 2013, as Partia Demokratike dhe as ajo Socialiste nuk arritën të fitonin shumicën e mjaftueshme për të krijuar qeveri, andaj edhe prania e partive të vogla është e domosdoshme.

Pra mund të thuhet se prania e partive të vogla në dekadën e parë pas rënies së komunizmit është simbolike, ndërsa në dekadën e dytë është mundësuar prej faktorëve institucionalë si sistemi elektoral.

3.3 Numri Efektiv i Partive dhe Fragmentizimi Partiak në Shqipëri

Koncepti i relevancës është i rëndësishëm dhe në hartën e shpërndarjes së portofoleve ministrore del qartë se cilat parti janë relevante dhe cilat jo. Megjithatë, për ta mbështetur më mirë argumentin është e nevojshme të përllogaritet masa relative e partisë në një sistem partiak. Në lidhje me këtë do t'i referohemi Indeksit të Laakso dhe Taagepera (1979) i cili tregon Numrin Efektiv të Partive Parlamentare (NEPP) dhe përllogaritet si më poshtë:

$$N = 1 / \sum s_i^2$$

ku 's' është proporcioni i vendeve që ka në parlament partia 'i'. Indeksi i Fragmentizimit është i vlefshëm kur përqipemi të zbulojmë partitë relevante sepse sikurse e thotë edhe Taagepera NEPP zakonisht i përafrohet përllogaritjeve të Sartorit në lidhje me numrin e partive relevante ose së paku 'i përafrohet aq afër sa ç'mundet një indeks operacional i bazuar thjeshtë mbi shpërndarjen e vendeve, pa patur njohuri të detajuara mbi një vend të caktuar (1999:498). Në rast se e aplikojmë këtë formulë në rastin Shqiptar atëherë NEPP do të ishte si më poshtë:

Tabela 3: Numri Efektiv i Partive Parlamentare

Election Year	NEPP
1991	1.81
1992	1.97
1996	1.31
1997	2.14
2001	2.99
2005	3.68
2009	2.21
2013	2.80

Megjithatë NEPP na tregon fragmentizimin e sistemit partiak por nuk na tregon se cilat janë partitë dhe çfarë peshe kanë ato në sistemin partiak. Për këtë na duhet ta lidhim NEPP-në me tipologjinë e sistemit partiak.

Një prej qasjeve më të vjetra dhe të njohura për të përshkruar sistemin partiak të një vendi është ajo e Blondel (1969) i cili në analizën e sistemit partiak përlllogarit jo vetëm numrin e partive por edhe masën dhe forcën e tyre relative dhe për pasojë ai dallon katër tipologji sistemi partiak: 1) sistem dy-partiak; 2) sistem dy-parti e gjysëm; 3) sistem multipartiak me një parti dominuese dhe 4) sistem multipartiak pa asnjë parti dominuese.

Sartori, gjithashtu ofron një tipologji të sistemit partiak duke u përqendruar edhe në natyrën dhe drejtimin e konkurimit partiak – nëse është centripetal apo centrifugal. Me fjalë të tjera, nëse partitë synojnë të pushtojnë qendrën ideologjike të sistemit partiak apo marrin pozicione ideologjike radikale dhe lëvizin drejt ekstremeve. Për pasojë Sartori krijoi këtë tipologji: 1) sistem partiak i predominuar (një parti merr më shumë se 50% të vendeve); 2) sistem dy-partiak; 3) pluralizëm i moderuar (sistem multipartiak i fragmentuar në shkallë të

moderuar me tendenca centripetale dhe 4) pluralizëm i polarizuar (sistem multipartiak i fragmentuar me tendenca centrifugale). Megjithatë sipas Mair (2002), pluralizmi i polarizuar nuk ekziston më si kategori analitike në vendet e Evropës Perëndimore por njëkohësisht është vështirë të gjesh një të tillë edhe në vendet post-komuniste (Taggart & Szczerbiak, 2004).

Por tipologjia më bashkëkohore është krijuar nga Siaroff (2000) i cili duke marrë në konsideratë masën dhe forcën relative të partive politike, balancën ndërmjet tyre dhe numrin e partive relevante krijoi një tipologji me tetë kategori: 1) sistem i pastër dy partiak (dy parti fitojnë 95% të vendeve në parlament); 2) sistem dy partiak e gjysëm; 3) sistem multipartiak i moderuar me një parti dominuese; 4) sistem multipartiak i moderuar me dy parti dominuese; 5) sistem multipartiak i moderuar me balancë ndërmjet partive; 6) sistem multipartiak ekstrem me një parti dominuese; 7) sistem multipartiak ekstrem me dy parti dominuese dhe; 8) sistem multipartiak ekstrem me balancë ndërmjet partive. Është e rëndësishme gjithashtu të sqarohet se Siaroff nuk i konsideron këto tipologji si sisteme partiake, por u referohet më së shumti si prirje, modele (*patterns*) të forcës së partisë, të cilat mund të ndryshojnë nga njëra palë zgjedhje në tjetrën.

Sipas Siaroff, klasifikimi i sistemit partiak përcaktohet nga kombinimi i një sërë faktorësh që janë: 1) numri mesatar i partive me të paktën 3% të vendeve në parlament – P3%S; 2) mesatarja e përqindjes së vendeve në parlament të dy partive kryesore – 2PSC; 3) mesatarja e raportit të vendeve ndërmjet partisë së parë dhe të dytë – SR 1:2; dhe 4) mesatarja e raportit të vendeve në parlament ndërmjet partisë së dytë dhe asaj të tretë – S2:3 (kap.3). Në tabelën e mëposhtme jepet lidhja që ekziston ndërmjet tipologjisë së sistemit partiak dhe vlerave të faktorëve të sipërpërmendur:

Tabela 4: Klasifikimi i Sistemit Partiak sipas dimensioneve të P3%S, 2PSC, SR 1:2 dhe SR 2:3 (Siaroff, 2000, kap.3)

Sistemi Partiak	P3%S	2PSC	SR 1:2	SR 2:3
Sistem 2 partiak	2	>95%		
Sistem 2 parti e gjysëm	3-5	80%-95%	<1.6	≥1.8
Sistem multipartiak i moderuar me një parti dominuese	3-5		≥1.6	
Sistem multipartiak i moderuar me dy parti dominuese	3-5		<1.6	≥1.8
Sistem multipartiak i moderuar me balancë ndërmjet partish	3-5		<1.6	<1.8
Sistem multipartiak ekstrem me një parti dominuese	>5		>1.6	
Sistem multipartiak ekstrem me 2 parti dominuese	>5		<1.6	≥1.8
Sistem multipartiak ekstrem me balancë ndërmjet partish	>5	<60%		

Burimi: Tabela është një adaptim personal i kriterëve të përcaktura nga Siaroff.

Ndërkaq Siarof krijon edhe një tabelë tjetër ku përpiqet të lidhë sistemin partiak me NEP, si më poshtë vijon:

Tabela 5: Klasifikimi i Sistemit Partiak i Siaroff (2000) në lidhje me NEPP

NEP	Klasifikimi i Sistemit Partiak
1.92	Sistem Dy Partiak
2.56	Sistem Dy Parti e Gjysëm
2.95	Sistem Multipartiak i Moderuar me një Parti Dominuese

3.17	Sistem Multipartiak i Moderuar me Dy Parti Dominuese
3.69	Sistem Multipartiak i Moderuar me Balancë ndërmjet Partish
3.96	Sistem Multipartiak Ekstrem me një Parti Dominuese
4.41	Sistem Multipartiak Ekstrem me Dy Parti Kryesore
5.56	Sistem Multipartiak Ekstrem me Balancë ndërmjet Partive

Aplikimi i këtyre rezultateve në rastin e Shqipërisë është si më poshtë:

Tabela 6: Dimensionet e Sistemit Partiak në Shqipëri 1991-2013 – Aplikim i skemës së Siaroff

Viti Elektoral	P3%S	2PSC	SR 1:2	SR 2:3	NEPP
1991	2	98%	2.27	15	1.81
1992	3	93%	2.42	5.43	1.97
1996	2	94%	12.2	3.33	1.31
1997	4	83%	3.92	2.89	2.14
2001	5	75%	2.28	3.56	2.99
2005	5	71%	1.33	3.82	3.68
2009	2	96%	1.03	16.5	2.21
2013	3	82%	1.35	3.06	2.80

Është e qartë që në vitin 1991 Shqipëria ka sistem të pastër dy partiak. Viti 1992 paraqitet disi problematik sepse, është e vërtetë që kemi tre parti me mbi 3%, 2PSC është më pak se 95% (megjithëse shumë afër saj) dhe SR 2:3 është më e madhe sesa 1.8, e megjithatë vështirë që në vitin 1992, Shqipëria të kishte një sistem dy partiak e gjysëm. Në fakt vlera e NEPP shumë më afër asaj të sistemit një partiak, diferenca shumë e madhe

ndërmjet partisë së dytë dhe të tretë (5.43) si edhe vlera e SR 1:2 jo vetëm që nuk është më e vogël se sa 1.6, por është 2.42, tregojnë se kemi më së shumti një sistem dy partiak ku me të gjitha gjasat partia e parë ka shumicën e vendeve në parlament. Edhe në vitin 1996 sistemi ka qenë dy partiak dhe indikatorët më të saktë për këtë janë P3%S që tregon se ka vetëm dy parti me mbi tre përqind, por edhe SR 1:2 që është 12.2 si edhe NEPP që është 1.31 që tregon se këto parti madje kanë edhe një diferencë shumë të madhe me njera-tjetrën.

Situata duket më e koklavitur në vitet 1997, 2001, 2005 ku numri i partive me mbi 3% të vendeve rritet përkatësisht në 4, 5, 5 por edhe përqindja që zënë dy partitë e mëdha zvogëlohet fillimisht në 83% dhe më pas në 75 dhe 71 përqind. Interesante këtu është që diferenca ndërmjet partisë së parë dhe të dytë fillon të bjerë (SR 1:2 lëviz nga 3.92 në 1997, në 2.28 në 2001 dhe në 1.33 – pothuajse e papërfillshme në 2005), në një kohë që diferenca ndërmjet partisë së dytë dhe të tretë rritet gradualisht (nga 2.89 që është SR 2:3 në 1997, në 3.56 në 2001 dhe në 3.82 në 2005). Kjo tregon se numri i partive të vogla është shtuar ndjeshëm në këtë periudhë. Për këtë arsye mund të thuhet se në Shqipëri në vitin 1997 kemi sistem multipartiak të moderuar me një parti dominuese dhe në dy ciklet e tjera elektorale në vijim sistem shkon drejt atij multipartiak të moderuar me dy parti dominuese.

Situata ndryshon sërisht në vitin 2009 ku sistemi duket sikur është dy partiak. Në fakt ky ndryshim shkon së bashku me ndryshimin e sistemit elektoral nga proporcional me mandate të përziera në proporcional rajonal me lista të mbyllura. Megjithatë po të shihet përbërja e kabinetit qeveritar në vitin 2009 (Tabela 2) shohim se partia e tretë, Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) zë një përqindje të konsiderueshme të posteve ministore, gjë që pavarësisht indekseve të Siaroff, na shtyn të konkludojmë se LSI është parti relevante

sipas konceptit të Sartorit. Me të vërtetë në rast se LSI nuk do të kishte kryer koalidcon me Partinë Demokratike me të gjitha gjasat vendi do të kishte shkuar në zgjedhje të parakohshme, sepse pavarësisht se të dyja partitë kanë 96% të vendeve në parlament, SR 1:2 prej 1.03 tregon se ato janë shumë afër njera tjetrës, madje janë pothuaj njësoj në përqindjen e vendeve në parlament, andaj asnjera prej tyre nuk mund të sigurojë shumicën e thjeshtë për të formuar e vetme kabinetin qeveritar. Sikurse e thotë edhe Sartori “Kemi një sistem dy partiak kurdoherë që prania e partive të treta nuk i pengon dy partitë e mëdha të qeverisin të vetme, që do të thotë kur koalicionet nuk janë të nevojshme. ...formati i dy-partizmit duhet të vlerësohet në bazë të shpërndajes së vendeve në parlament dhe jo të përqindjes së votave të fituara....qeveritë formohen dhe funksionojnë në varësi të forcës parlamentare’ (2005, 165).

Ndërkohë është shumë e rëndësishme të thuhet se në të gjitha zgjedhjet, dy partitë kryesore nuk kanë ndryshuar asnjëherë: PS dhe PD. Ajo që ka ndryshuar është partia e tretë, e cila më parë nuk ka qenë qartazi e përcaktuar (herë PR, herë PSD, herë PBDNJ), ndërsa në zgjedhjet e 2009 dhe 2013 është konstante: LSI.

Pra përfundimisht mund të thuhet si sistemi partiak në Shqipëri nuk është i fragmentizuar dhe është i dominuar nga dy parti kryesore, Partia Socialiste dhe Partia Demokratike, ndërsa partitë e vogla relevante kanë ndryshuar me shfaqjen në skenë të Lëvizja Socialiste për Integrim.

3.4 Luhatshmëria Elektorale

Luhatshmëria elektorale ndodh për shkak të proceseve dinamike dhe të ndërlidhura që ndodhin si në nivel partie ashtu edhe elektorati. Nga njëra anë, asnjë parti nuk mund të performojë njësoj gjithmonë. Partitë reagojnë ndaj kontekstit në të cilin operojnë dhe për pasojë ose i përshtaten kushteve të favorshme dhe përmirësojnë performancën e tyre, ose nuk arrijnë t'i shfrytëzojnë mundësitë dhe humbin vota. Për shkak të natyrës së tyre ndër-kohore, zgjedhjet janë të pasigurta dhe në të njëjtën kohë janë edhe kontrata afat-gjata ndërmjet të zgjedhurve dhe zgjedhësve (Lane, 2007:174). Votuesit kanë vetëm një mundësi për t'i dënuar partitë për premtimet e rreme, dhe kjo mundësi është të votohet për një parti tjetër në zgjedhjet e ardhshme. Të ndërgjegjshëm për këtë gjë, partitë politike e formësojnë diskurin e tyre dhe ndërmarrin strategji për ta bindur elektoratin për kapacitetin e tyre për t'a përfaqësuar atë.

Nga ana tjetër, elektorati nuk mund t'i ngrijë preferencat e tij. Struktura e elektoratit ndryshon, dhe për pasojë edhe prioritetet e tij ndryshojnë. Përveç burimeve natyrore të ndryshimit të përbërjes së elektoratit (vdekjet, migrimi) sjellja zgjedhore është gjithashtu produkt i hapësirës politike dhe propozimeve politike të bëra nga politikanët (Tavits, 2008). Me pak fjalë, ndryshimi në luhatshmërinë zgjedhore vjen si pasojë e një sërë faktorësh të hapësirës konkurruese (përbërja, strategjitë, premtimet e mëparshme) dhe reagimi i zgjedhësve nga kësaj.

Nuk ka ndonjë rregull se sa duhet të jetë një nivel i pranueshëm luhatshmërie elektorale, megjithatë luhatshmëritë ekstreme nuk janë të shëndetshme për partitë vetë dhe as për sistemin (Mainwaring dhe Scully, 1995) dhe vënë në pah një sërë problemesh: parti të dobëta politike që nuk ja dalin të përmbushin detyrat e tyre, mungesë të atashimeve

partizane dhe shtrirje të kufizuar të partisë në shoqëri. Nga ana tjetër, mungesa e luhatshmërisë, apo një luhatshmëri e ulët redukton shtysat për konkurrencë zgjedhore, duke ulur kështu nivelin e kontestimit. Një luhatshmëri e ulët elektorale tregon për një sistem partiak të qëndrueshëm, ndërsa një luhatshmëri elektorale e lartë tregon për një sistem partiak të paqëndrueshëm dhe për pasojë për një shoqëri në mobilitet e sipër interesat e së cilës janë në ndryshim të vazhdueshëm. Po kështu, përveçse indikon ndryshime sistematike, ajo është pjesë e debatit të madh në lidhje me ri-rreshtimin, largimin dhe pakënaqësinë e votuesve. Në këtë kontekst, luhatshmëria elektorale është veçse një ndër shumë indikatorët që tregojnë për ndryshimin strukturor të sjelljes zgjedhore (Dassonneville & Hooghe, 2011: 4).

Megjithatë është e rëndësishme të kuptohet se luhatshmëria nuk është thjesht matje e ndryshimit të mbështetjes elektorale për një apo disa parti politike. Në rast se do të kuptohej vetëm kështu luhatshmëria nuk do të merrte parasysh dinamikën e sistemit partiak si ndarjet, shkrirjet, ndryshimet e emrave dhe hyrjen e partive të reja, të gjitha këto shumë tipike për politikën post-komuniste.

Një indikator shumë i rëndësishëm që tregon për luhatshmërinë ose jo të një sistemi partiak është indeksi i luhatshmërisë së elektoratit apo siç njihet ndryshe Indeksi i Pedersenit. Sipas Pedersen 'edhe pse zgjedhjet nuk janë janë evenimente determinuese, ato mbeten megjithatë pika më avantazhuese për të studjuar ndryshimin, sepse ndryshimi ose do të jetë rezultati i zgjedhjeve, ose zgjedhjet do të regjistrojnë çdo ndryshim që mund të ndodhë në sistemin partiak' (1979:5). Me luhatshmëri elektorale kuptohet ndryshimi neto brenda sistemit partiak elektoral që rezulton prej transferimit të votave individuale nga një parti në një parti tjetër' (fq.3). Ai matet sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{Volatiliteti } (V_t) = 1/2 \times \text{TNC}_t$$

$$0 \leq V_t \leq 100$$

Ku V_t është vlera numerike e grumbulluar për të gjitha votat e fituara nga partitë fituese në sistemin partiak, vlera numerike e grumbulluar prej të gjitha votave të humbura nga partitë humbëse. Ajo shprehet në terma të përqindjes. Luhatshmëria tregon ndryshimet që ka mbështetja e një partie nga një palë zgjedhje në zgjedhjet e tjera pasuese.

3.5 'Manual' për Matjen e Luhatshmërisë Elektorale

Luhatshmëria elektorale tregon ndryshimin në preferencat elektorale me kalimin e kohës. Megjithatë ajo është një 'koncept shumë – shtresor dhe shumë – dimensional' (Crewe, 1985:8). Luhatshmëria e përgjithshme ose agregate ndërmjet dy palë zgjedhjesh të njëpasnjëshme është rezultat i kombinimit të tre faktorëve: 1) ndryshimit në mbështetjen që merr partia prej votuesve individualë të cilët votojnë në të dyja zgjedhjet; 2) ndryshimit të përbërjes së elektoratit si rezultat i hyrjes, daljes dhe abstenimi dhe; 3) ndryshimit në ofertën e partive si rezultat i hyrjes së partive të reja, daljes së partive të vjetra dhe ndryshimeve që ndodhin në formimin e koalicioneve. Ndërsa në pjesën më të madhe të demokracive të zhvilluara ka një vazhdimësi përse i përket ofertës politike nga njëra palë zgjedhje në tjetrën, vendet post-komuniste janë të karakterizuara nga një sistem partiak më pak i qëndrueshëm, ku oferta e partive politike ka reflektuar impulset e elitave politike për t'u ndarë apo bashkuar, pa marrë parasysh kërkesat, dëshirat apo preferencat e elektoratit (Birch, 2001: 3).

Gjetja e luhatshmërisë elektorale është disi e vështirë po të kihen parasysh ndarjet, bashkimet, koalicionet jo të qëndrueshme si edhe ndryshimet e emrave që kanë

karakterizuar vendet post-komuniste dhe në këtë kontekst as Shqipëria nuk bën përjashtim. Prandaj ashtu sikurse edhe Birch (2001) sugjeron, për të bërë identifikimin partiak do të përdoret kriteri i vazhdimësisë institucionale që nënkupton vazhdimësinë e burimeve organizacionale nga njëra palë zgjedhje në tjetrën sikurse edhe aspektet e identitetit partiak që do të thotë shkalla me të cilën votuesi është i ndërgjegjshëm për ndryshimin identitar të partisë (nëse ka patur të tillë) dhe megjithatë është i vendosur për ta ndjekur atë edhe nën petkun e ri vleror. Për rastin shqiptar sikurse edhe për vendet e tjera komuniste nuk ka studime që të jenë marrë me këtë aspekt identitar, andaj edhe i jam referuar Bartolini dhe Mair (2007:283-284) për të përcaktuar vazhdimësinë institucionale. Përlllogaritja e indeksit të volatilitetit është bërë duke patur parasysh sa më poshtë vijon:

- 1- Shifrat e luhatshmërisë rrumbullakosen prej dhjetëshes së dytë pas pikës;
- 2- Kur dy ose më shumë parti shkrihen për të formuar një parti, ose kur një ose më shumë parti shkrihen me një parti ekzistuese, luhatshmëria elektorale përlllogaritet duke zbritur votën e partisë së re prej shumës së votave të partive të shkriura në zgjedhjet që kanë paraprirë shkrirjen.
- 3- Kur një parti ndahet në dy ose më shumë parti, luhatshmëria elektorale përlllogaritet duke zbritur votën e kombinuar të partive të reja prej asaj të partisë origjinale në zgjedhjet që kanë paraprirë ndarjen.
- 4- Kur kemi ndryshim të emrit të partisë, luhatshmëria përlllogaritet sikur të ishte e njëjta parti. Këtu kemi rastin e Partisë Socialiste e cila u quajt e tillë pas zgjedhjeve të vitit 1991 ku ajo fitoi shumicën si Partia e Punës e Shqipërisë.
- 5- Luhatshmëria Totale (LT) dhe Luhatshmëria Totale Pa të Tjerë (LTPT):
Luhatshmëria Totale është përlllogaritur duke përfshirë edhe partitë e vogla, ndërsa

Luhatshmëria Totale Pa të Tjerë është përlogaritur duke përjashtuar partitë e vogla dhe kandidatët e pavarur. Në analizën e bërë përfshirja ose jo e partive të vogla nuk sjell ndonjë ndryshim të rëndësishëm, përkundrazi ndryshimi është shumë marxhinal ose irrelevant. Në këtë kontekst, në përlogaritjen e luhatshmërisë në Shqipëri nuk janë përfshirë partitë e vogla, sidomos kur këto nuk kanë marrë pjesë në të gjitha zgjedhjet. Përjashtim bëjnë partitë të cilat më pas janë përfshirë në aleanca me partitë e mëdha, sikurse e tregon qartë edhe tabela. Për të përcaktuar se çfarë e bën një parti të llogaritshme ose jo, është përdorur kriteri i Bartolini dhe Mair të cilët konsiderojnë si relevante në rast se përqindja e mbështetjes është 1 ose më tepër dhe si jo relevante në rast se kjo përqindje është më pak se 1 (fq.286).

- 6- Partnerët në Koalicion: Një aspekt tjetër për t'u patur parasysh në analizën e luhatshmërisë në Shqipëri është rasti i formimit të koalicioneve. Në lidhje me partnerët në koalicion, sipas Birch, në rast se partitë e kanë ruajtur identitetin e tyre dhe kanë marrë pjesë në zgjedhjet pararendëse si parti të ndryshme dhe në zgjedhjet e mëpasme si koalicion, ose anasjelltas, votat e partive do të mbledhen së bashku në të dyja rastet (2001: 19). Në rastin e Shqipërisë këtë e gjejmë të aplikuar në zgjedhjet e vitit 2005, 2009 dhe 2013 për të dyja partitë kryesore (PD dhe PS).

Megjithatë, përveç pikave të mësipërme të parashikuara nga Bartolini dhe Mair, rasti i Shqipërisë ofron edhe një panoramë tjetër. Më konkretisht kemi edhe rastin e Partisë Aleanca Demokratike e cila edhe pse u krijua pas ndarjes nga Partia Demokratike, mbas zgjedhjeve të vitit 1992, në zgjedhjet pasardhëse të vitit 1996 e tutje (deri në zgjedhjet e vitit 2013 ku ajo bën sërish aleancë me PD) ajo u zhvendos majtas duke bërë aleancë me Partinë Socialiste. Në këtë kontekst, ithtarët e saj e kishin të qartë ndryshimin identitar të

partisë andaj në këtë rast nuk mund të aplikohet pika tre më sipër, por PAD do të konsiderohet si parti e re. Një rast tjetër interesant është Partia Demokratike e Re e cila u shkëput prej Partisë Demokratike dhe garoi e vetme në zgjedhjet e vitit 2001 dhe 2005, por më pas u shkri sërisht me Partinë Demokratike. Në këtë rast, duke bërë një adaptim të pikave 2 dhe 3, luhatshmëria elektorale e Partisë Demokratike të Re nuk do të llogaritet fare, por ajo do të konsiderohet si të jetë një me Partinë Demokratike.

Një tjetër pikë e rëndësishme është që përveç luhatshmërisë totale të llogaritet edhe luhatshmëria në bllok. Luhatshmëria e blloqeve na tregon për qëndrueshmërinë ose jo të ndarjeve tek luhatshmëria totale, sepse kjo e fundit tregon për zhvendosje të preferencave të votuesve nga një parti në tjetrën po pa ndryshuar krahun ideologjik, ndërsa luhatshmëria e bllokut tregon nëse kemi zhvendosje nga e majta në të djathtë, ose anasjelltas, të spektrit ideologjik. Përcaktimi se cila parti i përket cilit bllok është problematike, e megjithatë në këtë rast është aplikuar rregulli i vazhdimësisë institucionale (Birch, 2001) që ka të bëjë me përcimin e burimeve njerëzore dhe materiale dhe ndërgjegjësimin e anëtarëve dhe simpatizantëve të partisë në lidhje me ndryshimin identitar të partisë.

Në lidhje me identifikimin e blloqeve dhe përkatësisë në blloqe, autori është bazuar në kriteret e mëposhtme:

- 1- Blloqet janë klasifikuar sipas kriterit 'E Majtë- E Djathtë': Bartolini & Mair (2007) e konsiderojnë ndarjen ideologjike si ndarjen më të rëndësishme, edhe pse ata e pranojnë se një sërë problemesh mund të dalin prej këtij klasifikimi (fq.285). Megjithatë në rastin e Shqipërisë, mund të jetë më pak problematike se sa në vendet e tjera sepse Shqipëria konsiderohet si një shtet etnikisht homogjen, dhe për pasojë ndarja etnike nuk është e rëndësishme dhe nuk mund t'i organizojë partitë politike

përreth këtij dimension. Përveç kësaj, tensioni Kishë-Shtet (Lipset & Rokkan, 1967) mungon, sepse Shqipëria doli nga një sistem komunist që e kishte ndaluar fene dhe për pasojë, me rënien e komunizmit, kisha u bë partnere me shtetin e ri demokratike, sepse ai e bëri sërish të ligjshëm praktikën fetare.

- 2- Koalicionet e krijuara nga vetë partitë konsiderohen si blloqe.
- 3- Në rastet kur partitë nuk kanë qenë ndonjëherë në koalicion përgjatë zgjedhjeve, por kanë një histori të të qenit gjithmonë së bashku (si në pozitë ashtu edhe në opozitë), kanë vepruar gjithmonë në një zë, ato janë konsideruar si të jenë në të njëjtin bllok. Në Shqipëri është rasti i Partisë Demokratike që ka qenë gjithmonë në koalicion me Partinë Republikane, Ballin Kombëtar, Lëvizjen e Legalitetit dhe Bashkimin Liberal.

Në lidhje me rregullat e kalkulimit të luhatshmërisë është i nevojshëm të bëhet edhe një specifikim tjetër. Studjuesit që kanë përllogaritur vlerën e luhatshmërisë së elektoratit e kanë bërë këtë duke marrë në shqyrtim një periudhë të gjatë kohore. Kështu Bartolini & Mair kanë llogaritur nivelin e luhatshmërisë në vendet e Evropës Perëndimore në periudhën 1885 – 1985, ndërsa Dassonneville & Hoghe (2011) kanë analizuar periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore. Një shtrirje e tillë kaq e gjatë kohore të jep mundësinë të kuptosh më mirë ciklet elektorale dhe të lësh jashtë analizës momentet e krizës, të cilat pikërisht se janë të tilla nuk përbëjnë normën por përjashtimin dhe andaj edhe mund të ndikojnë negativisht në saktësinë e rezultatit. Megjithatë, që prej rënies së komunizmit në Shqipëri janë organizuar vetëm tetë zgjedhje të lira, numër i cili paraprakisht mund të duket i mjaftueshëm për të dalë në konkluzione. Por në rast se shtojmë rregullin e Bartolini & Mair (2007) sipas të cilëve ‘në rastet e ndërprerjes së demokracisë ...periudhat me më pak se

katër zgjedhje të lira konsektive janë përjashtuar nga analiza' (fq.284), atëherë zgjedhjet para dhe në 1997 (kolapsi skemave piramidale) nuk do të duhej të përlogariteshin. Në rast se do të aplikonim një skemë të tillë në Shqipëri atëherë nuk do të mbetej shumë: vetëm zgjedhjet e vitit 2001, 2005, 2009 dhe 2013 dhe kjo nuk është e mjaftueshme për të dalë në një konkluzion. Andaj në këtë punim për të përlogaritur luhatshmërinë elektorale janë analizuar të gjitha zgjedhjet e mbajtura në Shqipëri që prej vitit 1991 dhe deri ato të fundit të vitit 2013.

Një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm është që të përcaktohet se ç'kuptohet me luhatshmëri të lartë apo të ulët. Pjesa më e madhe e vendeve post-komuniste konsiderohet të ketë një sistem partiak 'të hapur' që do të thotë se konkurenca partiake nuk është e mirë-stabilizuar dhe për pasojë partitë politike nuk kanë një bazë mbështetëse të qëndrueshme (Mair, 1997). Në studimin e tyre klasik mbi zhvillimin e sistemit partiak në vendet e Evropës Perëndimore në periudhën 1885-1985, Bartolini dhe Mair treguan se luhatshmëria mesatare gjatë kësaj periudhe ka qenë 9.1. Luhatshmërinë më të lartë e ka patur Gjermania ndërmjet 1919 dhe 1920 me 32.1 e ndjekur nga Franca që gjatë periudhës 1902-1906 e ka patur luhatshmërinë 31.1 (2007: 302, 305). Ndërkaq, në vendet post-komuniste nivelet e luhatshmërisë kanë qenë shumë të larta, duke arritur edhe 43.8. Ka patur raste ku luhatshmëria ka qenë mbi 30 (Rumania 1990-1992, Moldavia 1994-1998, dhe Lituania 1996-2000). Vetëm në pak raste kjo luhatshmëri ka qenë më i ulët se mesatarja e vendeve të Evropës Perëndimore (Republika Çeke 1990-1992 dhe 1996-1998, dhe Sllovakia 1990-1992) (Birch, 2001:5). Në këtë kontekst, në analizën e rastit shqipëtar, do të konsiderohet se niveli i luhatshmërisë është i ulët në rast se është 10% ose më pak. Në rast se varion

midis 11% - 20% atëherë do të konsiderohet si nivel mesatar dhe në rast se është mbi 20% do të konsiderohet si nivel i lartë.

3.6 Luhatshmëria e sistemit partiak dhe sistemi elektoral në Shqipëri

Tabela e mëposhtme tregon nivelin e luhatshmërisë duke filluar që prej vitit 1991 kur janë zhvilluar zgjedhjet e para demokratike. Sikurse e tregon edhe tabela, indeksi i luhatshmërisë është i lartë në vitin 2005-2009 (65.26), i ndjekur nga 1996-1997 (37.63) dhe më pas nga 2001-2005 (27.14). Niveli më i ulët i luhatshmërisë është në 1997-2001 (11.04) i ndjekur nga 2009-2013 (11.34).

Tabela 7: Luhatshmëria në nivel sistemi dhe në nivel partie në Shqipëri: 1991- 2013

Luhatshmëria / Partia	1991-1992	1992-1996	1996-1997	1997-2001	2001-2005	2005-2009	2009-2013
PD	23.42	-6.56	-29.84	7.35	-2.92	32.51	-9.55
PR	-1.06	5.04	-3.33			-17.85	0.91
PLL	0	2.07	1.21			-2.8	-0.36
PBK	0	4.97	-2.63			-1.34	-0.06
BL	0	1.97	-1.17			-1.06	0
PDR						2.34	-7.42
PDK	0.35	0.93	-0.3	0.05	2.23	-2.38	-0.11
PBKD	0	0	0	0	0	-0.29	-0.14
BLD	0	0	0	0	0	0.33	-0.17
LZHK	0	0	0	0	0	0.71	-0.4

PBD	0	0.72	0.12	-0.24	-0.06	-0.47	-0.03
PDIU	0	0	0	0	1.17	-0.22	1.66
PAD	0	1.56	1.17	-0.19	2.22	-4.45	-0.23
PS	-30.4	-5.36	32.38	-11.24	-24.22	31.96	0.51
LSI						-3.55	5.61
PSD	5	-3.48	0.97	1.15	13.35	-10.98	-1.17
PDSSH	0	0	0	0		-3.57	0.01
PBDNJ	0.67	2.64	-1.33	-0.1	1.76	-2.94	-0.34
PAASH	0.63	-0.63	0.8	1.76	4	-5.68	-0.73
G99							-0.69
Luhatshmëria	30.77	17.97	37.63	11.04	27.14	65.26	11.34
Totale							

Mund të shihet se nivelet e luhatshmërisë janë më të larta në dekadën e dytë se sa në të parën, në kundërshtim me atë që thotë literatura në lidhje me vendet post-komuniste (Birch, 2001). Një shpjegim për këtë gjë mund të jetë ndryshimi i sistemit elektoral. Bartolini & Mair (2007:160) komentojnë se një ndryshim në sistemin elektoral mund të pasohet nga një rritje e nivelit të luhatshmërisë. Shqipëria e ndryshoi sistemin e saj elektoral në 2009: duke ndryshuar nga Sistem Miks Me Mandate të Përziera në Proporcional me Listë (rajonal). Kjo mund të shpjegonte disi ngritjen e nivelit të luhatshmërisë nga 27.14 në 2001-2005 në 65.26 në 2005-2009. Megjithatë një rritje kaq radikale nuk mund të shpjegohet vetëm me ndryshimin e sistemit elektoral. Madje as ndryshimi i regjimit nuk prodhoi një nivel kaq të lartë luhatshmërie. Nëse ndjekim të njëjtën logjikë të kalkulimit të luhatshmërisë elektorale pas rënies së komunizmit dhe

llogaritim se Partia e Punës së Shqipërisë kishte 100% të votave, ndërsa në zgjedhjet e vitit 1991 mori 56.13% të votave, atëherë luhatshmëria për atë vit do të ishte 43.87, që është shumë më pak sesa luhatshmëria 65.26 në periudhën 2005-2009. Për më tepër luhatshmëria në vitin 1992-1996 është 17.97 dhe ky është një ndër nivelet më të ulta në historinë e shkurtër të pluralizmit në Shqipëri edhe pse jemi vetëm në fazat a para të vendosjes së demokracisë dhe zakonisht kjo periudhë në vendet post-komuniste është shoqëruar nga një nivel i lartë luhatshmërie.

Studjuesit komentojnë se edhe ndryshimi i sistemit elektoral shkakton nivel të lartë luhatshmërie elektorale. Në këtë kontekst, Shqipëria ka përjetuar ndryshime të shpeshta të sistemit elektoral. Zgjedhjet e vitit 1991 u zhvilluan sipas sistemit maxhoritar (Krasniqi, 2008, 31). Ato të vitit 1992 u zhvilluan sipas sistemit proporcional me mandate të përziera me dy raunde për aspektin maxhoritar dhe me pjesën proporcionale që synonte të korrigjonte ‘padrejtësitë’ e maxhoritarit (Edgeworth and Soares, 1992, 39). Zgjedhjet e vitit 1996 dhe 1997 u zhvilluan me sistemin miks paralel me dy raunde (pa aspektin proporcional të proporcionalit) (De Gregorio et.al, 1996, 4; Kaplan dhe Knapp, 1997:30). Sistemi ndryshoi sërish në 2001 dhe 2005. U bë sërish një miks i maxhoritarit dhe proporcionalit, por në 2001 ai mbeti me dy raunde duke rimarrë aspektin kompensues dhe në 2005 bë më i thjeshtë duke ruajtur aspektin kompensues të proporcionalit dhe duke e kthyer maxhoritarin në një raund (OSCE, 2001:4; OSCE, 2005, 4). Së fundmi sistemi ndryshoi sërish në vitin 2008 dhe zgjedhjet e vitit 2009 dhe 2013 janë zhvilluar sipas sistemit proporcional rajonal me lista të mbyllura (OSCE, 2009, 6). Sikurse mund të shihet sistemi ka qenë subjekt ndryshimesh dhe për pasojë më tepër ka qenë pre e ndryshimeve të liderëve partiake se sa k ndikuar në formësimin e sistemit partiak. Me të vërtetë reflekton

atë që komenton edhe Diamond the Platneer se ‘ndër variablat struktural dhe historik që ndikojnë demokracinë, pak janë më të hapur nadj ndryshimeve të shpeshta se sa sistemi elektoral’ (2006, ix). Tabela e mëposhtme paraqet sistemin elektoral dhe nivelin e luhatshmërisë në vitin respektiv:

Tabela 8: Sistemi Elektoral dhe Luhatshmëria e Sistemit Partiak

Viti	Luhatshmëria e Sistemit Partiak	Sistemi Elektoral
1991		Maxhoritar- I Parti Fiton
1992	30.77	Proporcional me Mandate të Përziera/ me 2 Raunde
1996	17.97	Paralel/ 2 Raunde
1997	37.63	Proporcional me Mandate të Përziera/ me 2 Raunde
2001	11.04	Proporcional me Mandate të Përziera/ me 2 Raunde
2005	27.14	Proporcional me Mandate të Përziera/ me 1 Raund
2009	65.26	Proporcional me Lista të Mbyllura Rajonal
2013	11.34	Proporcional me Lista të Mbyllura/ Rajonal

Siç edhe mund të shihet, megjithëse ka një ndryshim në sistemin elektoral në vitin 1996, ka një rënie në nivelin e luhatshmërisë dhe jo një rritje sikurse argumenton edhe Bartolini & Mair 2007. Megjithatë, ajo që spikat më së shumti është se me ndryshimin e sistemit elektoral, niveli i luhatshmërisë herë është rritur në mënyrë të ndjeshme dhe herë

është ulur. Dhe po ta lidhësh këtë më indeksin e fragmentizimit të sistemit partiak, i cili ka qenë më konstant, mund të konkludosh se një luhatshmëri e tillë nuk është reale dhe pavarësisht se partitë politike kanë përjetuar zhvendosje të mëdha të elektoratit, ato kanë mbajtur përgjithësisht të njejtin nivel përfaqësimi në parlament. Andaj, pikërisht për të plotësuar boshllëkun që krijon matja e luhatshmërisë elektorale në nivel sistemi dhe partie (tabela 7), duhet të masim edhe nivelin e luhatshmërisë në nivel blloku.

3.7 Luhatshmëria në Bllok në Shqipëri

Analiza e luhatshmërisë në nivel sistemi dhe në nivel partie (tabela 7) për periudhën 1991-2013 mbetet ende e pashpjegueshme, sepse pavarësisht vlerave të saj të larta, ajo nuk është reflektuar në sistemin partiak i cili ka mbetur i qëndrueshëm me prezencën e përhershme të dy partive kryesore: PS dhe PD. Andaj na duhet një analizë më e thellë për të shpjeguar ndryshimet në mbështetjen ndaj partive politike nga njëra palë zgjedhje në tjetrën. Tabela e mëposhtme tregon vlerat në përqindje të mbështetjes ndaj partive politike që prej vitit 1991. Sikurse mund të shihet dy partitë kryesore politike, Partia Socialiste dhe Partia Demokratike kanë ‘pjesën e luanit’, me përjashtim të vitit 2005, ku Partia Demokratike mori vetëm 7.67% të votës totale dhe Partia Socialiste mori 8.89% të kësaj vote.

Tabela 9: Mbështetja elektorale ndaj partive politike (në %) ¹¹

Zgjedhjet / Partia	1991	1992	1996	1997	2001	2005	2009	2013
PD	38.68	62.1	55.54	25.7	36.8	7.67	40.18	30.63
PR	1.76	0.7	5.74	2.41		19.96	2.11	3.02
PLL			2.07	3.28		3.51	0.71	0.35
PBK			4.97	2.34		1.68	0.34	0.28
BL			1.97	0.8		1.06	0	0
PDR	NA	NA	NA	NA	5.08	7.42	0	0
PDK		0.35	1.28	0.98	1.03	3.26	0.88	0.77
PBKD							0.27	0.13
BLD							0.33	0.16
LZHK							0.71	0.31
PBD			0.72	0.84	0.6	0.54	0.07	0.04
PDIU						1.17	0.95	2.61
PAD			1.56	2.73	2.54	4.76	0.31	0.08
PS	56.13	25.73	20.37	52.75	41.51	8.89	40.85	41.36
LSI	NA	NA	NA	NA	NA	8.4	4.85	10.46
PSD		5	1.52	2.49	3.64	12.74	1.76	0.59
PDSSH						4.25	0.68	0.69
PBDNJ	0.73	1.4	4.04	2.71	2.61	4.13	1.19	0.85
PAASH	0	0.63		0.8	2.56	6.56	0.88	0.15
G99	NA	NA	NA	NA		NA	0.86	0.17

Kuptimi i këtyre të dhënave mund të japë çelësin për të kuptuar sjelljen elektorale të votuesve shqiptarë. Arësyeja për luhatshmërinë e lartë në 2001-2005 dhe 2005-2009,

¹¹ Të dhënat për tabelën janë marrë nga Krasniqi, A. (2008) Zgjedhjet në Shqipëri (1991-2008); Raportet e OSBE-së mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Shqipëri dhe IFES Reports.

qëndron pikërisht në të dhënat e vitit 2001 dhe 2005. Në vitin 2005, partitë politike shqiptare aplikuan votimin strategjik dhe manipuluan sistemin elektoral (Proporcional me Mandate të Përziera). Të dyja partitë krijuan koalicione para-elektorale me aleatët e tyre të vegjël dhe instruktuan votuesit e tyre të mbështesnin këta aleatë në votimin në proporcional (listat partiake) në këmbim të votave të partive të vogla në votimin në maxhoritar. Në këtë mënyrë ata rritën shanset e tyre për të fituar në zonat njëmërore në votimin në maxhoritar dhe rritën shanset e aleatëve të tyre për të fituar sa më shumë kandidatë nga listat partiake. Për pasojë, situata në vitin 2005 është e tillë që edhe pse PD fitoi 7.67% të votës totale, ajo siguroi 56 vende ose 40% të vendeve në parlament, ndërsa PS megjithëse fitoi 8.89% të votës totale, pati 42 deputetë ose 30% të vendeve në parlament.

Votimi strategjik i vitit 2005 u frymëzua nga ai i vitit 2001, vit në të cilin ai u zbatua në një shkallë më të vogël nga PS. Ajo e aplikoi atë në një zonë zgjedhore duke ndihmuar kështu aleatët e saj të vegjël, Partinë Aleanca Demokratike dhe Partinë Agrare të kalonin pragun 2.5% dhe të hynin në parlamentet (Krasniqi, 2008, 229). Në vitin 2001, PD nuk e aplikoi votimin strategjik sepse ishte në koalicion me katër parti të tjera. Kjo shpjegon edhe pse diferenca në mbështetjen e votuesve është e dukshme vetëm për Partinë Socialiste dhe jo për Partinë Demokratike. Përkundrazi në përlogaritjen e luhatshmërisë për periudhën 2005-2009, ndryshimi në përqindje të mbështetësve të PD dhe PS është i dukshëm (për shkak të manipulimeve të vitit 2005), sepse megjithëse në 2005 të dyja partitë ishin pjesë të një koalicioni ato u votuan individualisht dhe për pasojë mbështetja elektorale është e qartë. Megjithatë ka edhe raste të tjera të votimit strategjik dhe manipulimit. Kështu, në vitin 2005, përveç votës taktike, PD kreu edhe strategji të tjera për të rritur numrin e deputetëve *de facto* të saj. Më konkretisht, sipas vëzhgimit të OSBE-së:

Para zgjedhjeve, Partia Demokratike nënshkroi marrëveshje me shtatë partitë aleate të Koalicionit Aleanca për Liri, Drejtësi dhe Mirëqenia (ALDM), sipas së cilës PD dhe secila prej shtatë partive në koalicion do të regjistronin së paku një kandidat në zonat një-emërore nën logon e PD-së. Me të vërtetë, formalisht, PD-ja vendosi 100 kandidatë në të 100 zonat zgjedhore një-emërore, sikurse e kërkonte dhe ligji, por 15 prej tyre ishin përfaqësues të aleatëve të PD-së, në përputhje me marrëveshjen e sipërpërmendur. Në lidhje me listat partiake, PD dhe koalicioni ALDM regjistruan lista të veçanta kandidatësh. Megjithatë është e rëndësishme të thuhet se lista e PR, një parti e koalicionit të ALDM, kishte emrat e 30 anëtarëve të PD-së, duke përfshirë këtu edhe parlamentarë të zgjedhur si kandidatë të PD-së në zgjedhjet e vitit 2001 (2005:10).

Në këto rrethana është e vështirë të kuptosh se cila është mbështetja e vërtetë në vota që ka një parti e caktuar. Për shkak të këtyre manovrave me shumë gjasa nuk do të merrnim shifra reale edhe sikur të llogarisnim luhatshmërinë bazuar në përqindjen e vendeve që partitë politike kanë në parlament, sikurse sugjeron Mair & Bartolini (2007).

Në këtë mënyrë për të kuptuar më mirë sjelljen elektorale të votuesve shqiptarë, qasja më e përshtatëshme do të ishte matja e luhatshmërisë në bllok, sepse ‘...çdo matje e bazuar luhatshmërinë në nivel *partie individuelle* – LP sikurse dhe LT – nuk janë të përshtatshme për të analizuar stabilitetin, forcën, apo persistencën e ndarjeve. Për çdo linjë specifike ndarjeje – qoftë kjo klasore, fetare, apo ndonjë tjetër – luhatshmëria e rëndësishme, qoftë kjo në terma të persistencës apo ndryshimit të ndarjes, është luhatshmëria që ndodh ndërmjet blloqeve të partive që përfaqësojnë anët e kundërta të ndarjeve’ (Bartolini dhe Mair, 2007, 42). Në lidhje me Shqipërinë, luhatshmëria në bllok do të kalkulohet duke filluar nga zgjedhjet e vitit 1997, ku edhe krijimi i blloqeve fillon e bëhet më qëndrueshëm dhe i dukshëm. Për të krijuar blloqet është parë sjellja historike e partive dhe koalicionet që kanë krijuar. Tabela e mëposhtme tregon luhatshmërinë në bllok për periudhat 1997-2001, 2001-2005, 2005-2009 dhe 2009-2013.

Tabela 10: Luhatshmëria në Bllok (LB) 1997 – 2013

Zgjedhjet / Partia	1997	2001	LB	2001	2005	LB	2005	2009	LB	2009	2013	LB			
PD	25.7		11.1		7.67	2.76	7.67	40.18	1.47	40.18	30.63	-9.55			
PR	2.41				19.96			19.96		2.11			2.11	3.02	
PLL	3.28				3.51			3.51		0.71			0.71	0.35	
PBK	2.34				1.68			1.68		0.34			0.34	0.28	
BL	0.8	36.8			36.8		1.06			1.06	0			0	
PDK	0.98	1.03			1.03		3.26			3.26	0.88			0.88	0.77
PDR	0	5.08			5.08		7.42			7.42	0			0	
PBKD											0.27			0.27	0.13
BLD											0.33			0.33	0.16
LZHK											0.71			0.71	0.31
PBD	0.84	0.6			0.6		0.54			0.54	0.07			0.07	0.04
PDIU							1.17			1.17	0.95			0.95	2.61
PAD	2.73	2.54		-0.19	2.54		4.76	-3.13		4.76	0.31		7.02	0.31	0.08
PS	52.75	41.51	41.51		8.89	8.89	40.85		40.85	41.36					
LSI	0	0	0		8.4	8.4	4.85		4.85	10.46					
PSD	2.49	3.64	3.64		12.74	12.74	1.76		1.76	0.69					
PDSSH					4.25	4.25	0.68		0.68	0.85					
PBDNJ	2.71	2.61	2.61		4.13	4.13	1.19		1.19	0.59					
PAASH	0.8		2.56		6.56	6.56	0.88		0.88	0.15					
G99	0		NA		NA	0	0.86		0.86	0.17					
Luhat. në Bllok			5.65			2.95			4.25			5.03			

Siç mund të shihet, kur përlogaritet luhatshmëria në bllok, niveli i luhatshmërisë është i ulët. Të dhënat tregojnë se niveli më i lartë i luhatshmërisë është në periudhën 1997-

2001 (5.65) dhe më i ulëti është në periudhën 2001-2005 (2.95). Megjithatë edhe në zgjedhjet e tjera niveli i luhatshmërisë është i ulët, pa e kapur asnjëherë shifrën 6 dhe kjo gjë tregon se blloqet e konkurrencës në Shqipëri janë krijuar dhe konsoliduar dhe se ka një stabilizim të elektoratit shqiptar.

3.8 Përfundime

Në këtë kapitull u eksplorua institucionalizimi i sistemit partiak në Shqipëri dhe u mat luhatshmëria e elektoratit. Të dy këta indikatorë janë të rëndësishëm për të kuptuar natyrën e sistemit partiak, gjë që është një ndër synimet e punimit, por në të njëjtën kohë shërbejnë për të na dhënë informacion në mënyrë indirekte mbi tipologjinë e partive politike shqiptare.

Në analizën e rastit shqiptar pamë se sistemi partiak është tashmë i institucionalizuar, me dy parti kryesore të mirë stabilizuara të cilat në fazat e hershme i kanë dhënë sistemit formën e sistemit dy-partiak. Shfaqja e partive të vogla, ka rezultuar e paqëndrueshme, dhe megjithë kohën e shkurtër mund të thuhet se tashmë është shfaqur në mënyrë të konsoliduar një parti e tretë, pra sistemi partiak në Shqipëri është dy parti e gjysëm. Stabiliteti i sistemit partiak flet për një ankorim të qëndrueshëm të partive në elektorat. Kjo premisë vërtetohet edhe nga analiza e luhatshmërisë elektorale në Shqipëri e cili tregoi se ndarja ndërmjet dy blloqeve kryesore politike është e qëndrueshme, luhatshmëria ndërmjet blloqesh është e vogël dhe për pasojë kjo luhatshmërie e ulët flet gjithashtu për lidhje të forta të partisë me shoqërinë.

Pra si konkluzion mund të thuhet se partitë politike shqiptare kanë lidhje të forta me elektoratin, lidhje këto që sipas Gherghina (2013), në mungesë të ndarjeve të qarta

shoqërore (tipar i vendeve të komunizmit patrimonial sipas Kitschelt, et.al, 1998), mund të shkaktohen si rezultat i një anëtarësie të lartë dhe me depërtim të thellë territorial. Megjithatë në Kapitullin VI Përfundimi, bëhet një ndërthurje e të dhënave të tri kapitujve analitikë: sistemi partiak – luhatshmëria e elektoratit, financat dhe balanca e brendshme e pushtetit, ku të dhënat mbi numrin efektiv të partive si edhe luhatshmëria e elektoratit nuk jepen vetëm si të dhëna deskriptive që ofrojnë një panoramë të sistemit partiak (edhe pse kjo është gjithashtu pjesë e synimit të punimit) por si indikatorë që ndihmojnë për të kuptuar natyrën e lidhjeve ndërmjet partive politike, anëtarësisë dhe elektoratit.

Së fundmi, kapitulli ndihmoi për të përzgjedhur edhe partitë relevante, ato që duhen marrë në shqyrtim në këtë punim, të cilat janë: PS, PD dhe LSI.

KAPITULLI IV. ORGANIZIMI PARTIAK, ANËTARËSIA DHE BALANCA E BRENDSHME E PUSHTETIT

4.1 Hyrje

Teza kryesore e analizës van Biezen (2003) mbi organizimin partiak në demokracitë e reja është se partitë politike që lindin në një kontekst ku demokratizimi fillimisht kërkon vendosjen e parimeve të kontestimit publik në një regjim hegjemonik do të ndjekin një tjetër rrugë të organizimit partiak nga partitë që shfaqen në kontekstin ku oligarkia konkruuese transformohet në demokraci të plotë. Ndërsa shumë prej demokracive liberale të Evropës Perëndimore ndoqën rrugën prej oligarkisë konkruuese në demokraci, vendet post-komuniste nuk e patën këtë mundësi. Konteksti institucional, i adoptuar nga tipologjia e regjimeve politike e Dahlit, ka një rëndësi thelbësore për të kuptuar formimin e partive politike, sepse ky kontekst kushtëzon oportunitetet dhe barrierat për ndërtimin organizativ të partive politike. Konkretisht van Biezen (2003) ka argumentuar se mjedisi në të cilin u shfaqën partitë politike në vendet post-komuniste, favorizoi një sekuencë të zhvillimit organizacional, ku partia në post publike lind dhe fiton rëndësi përpara se të zhvillohet një organizatë jashtë-parlamentare. Për pasojë ‘partia në poste-publike’ predominon organizatën në tërësi.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm për t’u diskutuar është se, duke qenë se shumë prej partive në demokracitë e reja iu desh ta ndërtonin organizatën partiake prej fillimit si edhe duke qenë që konteksti në të cilin ato u shfaqën bëri që këto parti të orientoheshin drejt elektoratit dhe jo drejt strategjive depërtuse të partisë në shoqëri, pritshmëria ishte që lidhjet partizane me shoqërinë të ishin të dobëta, se organizata bazë do të kishte pak rëndësi

në organizatën partiake në tërësi, dhe se aktiviteti jashtë-parlamentar do të mbështetej tek profesionistët dhe jo tek anëtarët vullnetarë. Në të njëjtën kohë, duke patur parasysh origjinën e tyre institucionale dhe rëndësinë e ndërtimit të institucioneve, pritshmëria ishte që partitë të kishin një orientim dhe lidhje të fortë me shtetin dhe se do të karakterizoheshin nga një centralizim i lartë rreth lidhjes së partisë. Po kështu, pati pritshmëri që faktorët konjunkturalë në lidhje me kohën kur u shfaqën partitë, dhe veçanërisht aksesin në fondet publike dhe media, ta përforconin këtë mënyrë organizimi. Në këtë kontekst është e rëndësishme të shihet nëse të gjitha këto pritshmëri janë të vlefshme edhe për rastin shqiptar.

4.2 Organizimi Partiak - Anëtarësia

Madhësia e Anëtarësisë

Literatura mbi vendet komuniste tregon se, përsa i përket anëtarësisë dhe shtrirjes territoriale ka një dallim midis partive trashëgimtare të partive komuniste dhe partive të reja, duke anuar balancën nga të parat. Kjo i detyrohet faktit që partitë pasuese të partive komuniste trashëguan anëtarësinë dhe shtrirjen territoriale të partisë mëmë, duke i vendosur thellësisht në disavantazh partitë opozitare (van Biezen, 2003). Megjithatë për sa i përket partive politike shqiptare të marra në shqyrtim nuk mund të thuhet e njëjta gjë. Partia Demokratike ka të njëjtën shtrirje territoriale sikurse edhe Partia Socialiste. Tabela e mëposhtme tregon shifrat e anëtarësisë së partive të marra në shqyrtim në këtë punim:

Tabela 11: Anëtarësia e Partive politike Shqiptare: 1991-2013¹²

Viti	Partia		
	Partia Socialiste	Partia Demokratike	LSI
1991	166,000 ¹³	50,000	---
1992	63,000	100,000	---
1996	90,000	130,000	---
2001	95,000	70,000	---
2002	65,000	60,000	---
2005	60,000	72,000	37,000
2007	77,864		---
2009	82,304	76,000	---
2011	79,886	91,000	31,000
2013	73,000	100,000	31,000

Është e qartë që për shkak se Partia Socialiste trashëgoi një strukturë organizative të ndërtuar dhe një numër të madh anëtarësie ajo ishte më e organizuar dhe më e mbështetur në elektoratë në vitin 1991 gjë që tregohet edhe nga rezultati i zgjedhjeve, të cilat u fituan prej saj. Në vigjilje të tranzicionit, Partia e Punës (para-ardhësja e PS) kishte një strukturë organizacionale të mirë-strukturuar dhe të shtrirë në të gjithë shoqërinë. Duke qenë se organizatat disidente ishin të ndaluara me ligj gjatë sistemit komunist, partitë opozitare patën mundësi të lindnin vetëm gjatë tranzicionit. Konkretisht Partia Demokratike pavarësisht përpjekeve për t'u shtrirë territorialisht, për shkak të kohës së shkurtër që pati në dispozicion (zgjedhjet e para u organizuan në mars 1991, vetëm tre muaj pas krijimit të saj) nuk arriti ta realizonte këtë gjë dhe fitoi përfaqësim parlamentar, përpara se të arrinte të

¹² Krasniqi, A. (2009) dhe të dhënat zyrtare të partive politike.

¹³ Shifra i përket Partisë së Punës së Shqipërisë, por është vendosur tek Partia Socialiste, duke qenë se Partia Socialiste trashëgoi anëtarësinë, ndërtesat, strukturën organizacionale prej Partisë së Punës.

krijonte rrjetin organizacional mbi të cilin në fakt mund të mbështetej vetëm Partia e Punës (më pas Socialiste).

Për shkak të origjinës së ndryshme, organizimi i Partisë Socialiste dhe asaj Demokratike u zhvillua në kahe të kundërta: në rritje për Partinë Demokratike dhe në zbritje për atë Socialiste. Në zgjedhjet e dyta parlamentare të vitit 1992, anëtarësia e Partisë Socialiste ishte reduktuar ndjeshëm duke rënë nga 166,000 në 63,000 (Krasniqi, 2009). Por në ndryshim nga simotrat e saj në vendet e tjera post-komuniste që përjetuan rënie drastike të anëtarësisë (van Biezen, 2003), Partia Socialiste e Shqipërisë arriti t'i rezistojë tkurrjes dhe ta rimerte veten, duke patur shifra anëtarësie që variojnë në shifrat 60,000- 95,000 vetë.

Partia Demokratike, si parti e re opozitare, e cila ishte ende në fazën embrionale të organizimit partiak në vigjilje të tranzicionit, ndoqi një trajektore të kundërt. Duke qenë se ajo ishte e përfshirë paralelisht në përmbysjen e sistemit dhe në organizimin e zgjedhjeve të përgjithshme, ajo nuk pati si prioritet kryesor ndërtimin organizacional dhe rekrutimin e anëtarësisë. Krijimi i organizatës jashtë-parlamentare ishte ende në fazat e para kur u kryen zgjedhjet e para pluraliste të vitit 1991 (Meksi,2012; Krasniqi, 2009). Megjithatë shifrat e anëtarësisë së partisë vazhduan të ngrihen dhe kjo është në ndryshim me vendet e tjera post-komuniste, ku nuk vihet re i njëjti fenomen (van Biezen, 2003). Megjithatë, vetëm Partia Demokratike ia doli të krijonte një strukturë organizacionale të shtrirë në territor dhe të madhe në numër. Partitë e tjera nuk e arritën këtë gjë.

Në ndryshim nga vendet e tjera post-komuniste, niveli i anëtarësisë partiake si përqindje e elektoratit, është relativisht i lartë. Ajo që vihet re (Tabela 12 dhe 13) është se përgjithësisht përqindja që zë anëtarësia në elektorat lëviz midis 9-12% dhe këto janë shifra

shumë më të larta se ato të vendeve post-komuniste ku shifrat shkojnë rreth 3% të elektoratit (van Biezen, 2003).

Tabela 12: Numri i votuesve dhe Pjesëmarrja në zgjedhje në Shqipëri: 1991-2013:¹⁴

Viti	Pjesëmarrja në zgjedhje	Vota Totale
2013	53.31%	1,744,261
2009	50.77%	1,566,079
2005	48.73%	1,389,320
2001	54.95%	1,373,210
1997	72.56%	1,412,929
1996	89.08%	1,963,344
1992	91.50%	1,830,000
1991	98.92%	1,963,568

Tabela 13: Anëtarësia e Partive Politike në Shqipëri (% e votave)¹⁵:

Partia	Njesia	1991	1992	1996	2001	2005	2009	2013
PS	Anetaresia	166000	63000	90000	95000	60000	82304	105,160
	Elektorati	1,963,568	1,830,000	1,963,344	1,373,210	1,389,320	1,566,079	1,744,261
	A/E	0.0845	0.03442	0.04584	0.06918	0.04318	0.05255	0.06028
PD	Anetaresia	50,000	100,000	130,000	70,000	72,000	76,000	100,000

¹⁴ Burimi: IDEA (Institute for Democracy and Electoral Assistance – www.idea.int/vt/countryview.cfm?id=7)

¹⁵ Burimi: Për anëtarësinë shih Tabelën 11. Për votat elektoratin shih IDEA në www.idea.int/vt/countryview.cfm?id=7

	Elektorati	1,963,568	1,830,000	1,963,344	1,373,210	1,389,320	1,566,079	1,744,261
	A/E	0.02546	0.05464	0.06621	0.05097	0.05182	0.04852	0.05733
LSI								
	Anetaresia					37,000	31,000	31,000
	Elektorati					1,389,320	1,566,079	1,744,261
	A/E					0.02663	0.01979	0.01777
Total								
	A/E	0.110004	0.089071	0.112054	0.120156	0.121642	0.120878	0.116955

Një pikë tjetër e rëndësishme për t'u analizuar është edhe përqindja që zë anëtarësia partiake në raport me votat e marra (A/V). Në tabelën e mëposhtme jepet numri i anëtarësisë së partive të marra në shqyrtim në raport me votat e marra prej secilës prej partive në zgjedhjet 1991-2013.

Tabela 14: Anëtarësia partiake në Shqipëri si përqindje e votave partiake¹⁶

Partia	Njesia	1991	1992	1996	2001	2005	2009	2013
PS	Anetaresia	166000	63000	90000	95000	60000	82304	105,160
	Vota	1,102,936	433,600	335,402	549,588	121,412	620,586	713,407
	A/V	0.15	0.145	0.269	0.173	0.494	0.133	0.147
PD	Anetaresia	50,000	100,000	130,000	70,000	72,000	76,000	100,000
	Vota	760,097	1,046,193	914,218	336,167	487,314	610,463	528,373
	A/V	0.066	0.096	0.142	0.208	0.148	0.125	0.189
LSI	Anetaresia					37,000	31,000	31,000
	Vota					115,498	73,678	180,470
	A/V					0.320	0.421	0.172

¹⁶ Burimi: Për anëtarësinë shih Tabelën 11. Për votat e marra shih Krasniqi (2009) për zgjedhjet 1991-2009 dhe Rezultatet e Zgjedhjeve në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve www.ccc.al për zgjedhjet 2013.

Ajo ç'ka vihet re nga tabela është se, në ndryshim nga partitë në vendet e tjera post-komuniste, partitë politike përpqien të mos vendosin vetëm lidhje elektorale me shoqërinë. Kështu partitë politike përpqien të përfshijnë një pjesë të madhe të mbështetësve të tyre në rradhët e partisë, gjë që është tipike për partinë e masave dhe jo partinë elektorale – profesionale apo kartel.

Konceptimi i anëtarësisë partiake

Anëtarët e partisë luajnë një rol të vogël në krahasim me profesionistët dhe udhëheqjen e partisë, edhe pse duhet theksuar se partitë politike shqiptare përpqien të ruajnë së paku në aparençë modelin e një organizate partiake të mbështetur tek anëtarësia. Kështu në raportin e saj vjetor financiar të vitit 2011, Partia Socialiste deklaroi se ka 4,848 organizata socialiste, 384 Asamble të Bashkive dhe Komunave, 37 Degë të saj në rrethe dhe 12 Këshilla koordinues në nivel qarku (2011:1). Me ndryshime shumë të vogla, ku respektivisht organizatat socialiste rriten në 4,856 dhe Asamble të Bashkive dhe Komunave rriten në 385 për vitin 2012, në 4920 dhe 385 për vitin 2013 (Raport Financiar Vjetor, 2012:1; Raport Financiar Vjetor, 2013:1) Ndërsa në raportin e saj financiar të vitit 2009, Partia Demokratike deklaroi se ka 407 seksione dhe 4,407 grup seksione (2012:6; 2013:2).

Rëndësia që i jepet anëtarësisë mund të vihet re tek struktura e organizatës partiake jashtë-parlamentare. Të tria partitë e analizuar këtu janë mbështetur mbi regjistrimin formal të anëtarësisë. Kushtet për t'u anëtarësuar janë përgjithësisht të lehta dhe partitë kanë adoptuar një strukturë organizacionale në të cilën dega lokale është njësia bazë organizacionale. Ashtu sikurse partitë politike në vendet post-komuniste, edhe partitë politike shqiptare kanë huazuar modelin organizativ prej simotrave të tyre në vendet e

Evropës Perëndimore përta i përket strukturës organizacionale ku dega logale (dhe celulat) janë vetëm një pjesë e të tërës. Ndërsa, sipas Duverger (1954:23), *caucus*-i tradicional ‘evokon një realitet autonom, të aftë të qëndrojnë më vete’, ekzistenca më vete, e ndarë e degëve është e papërfytyrueshme.

Në një kuptim, partitë politike janë modeluar sipas modelit të ‘shpikjes socialiste’ me degë relativisht të hapura gjë që kontrastonte me modelin e bazuar në blloqe, ku mund të hyej ose përmes ko-optimit ose përmes nominimit formal (Duverger, 1954:23). Për të ilustruar argumentin mjafton të thuhet se tashmë mund të hysh *online* në faqen e internetit të partive politike dhe të aplikosh për të anëtarësohesh. Informacioni i vetëm që kërkohet për t’u anëtarësuar në Partinë Demokratike është: Emri/Mbiemri, Atësia, Datëlindja, Vendlindja, Vendbanimi, Gjinia, Nr. Personal i identitetit, Nr. Telefoni Celular, Nr. Telefon fix dhe e-mail-i (www.pd.al/index.php/anetaresohu). Po kaq të lehtë e ka anëtarësimin edhe Partia Socialiste. Sërisht mund të bëhesh anëtar duke aplikuar online dhe brenda një jave nga momenti i aplikimit, koordinatori i Partisë Socialiste në zonën ku banon vihet në kontakt me aplikuesin duke i çuar kartën e anëtarësisë. Të njëjtën strategji ndjek edhe LSI nën seksionin “Bashkohu me Ne” ku mjafton të japësh emrin, numrin e telefonit dhe minibashkine ku bën pjesë dhe menjëherë bëhesh pjesë e organizatës. Kriteret e anëtarësimin janë përgjithësisht të lehta dhe aspak të vështira për t’u plotësuar nga çdokush. Kështu me nenin 12, PD përcakton se “Anëtar i PD mund të jetë, çdo qytatar shqiptar që a) është mbi 15 vjeç; b) pranon kushtet e anëtarësimin; c) të mos jetë anëtar i partive politike apo organizatave që nuk janë në një partneritet të deklaruar dhe të pranuar nga PD”. Të njëjtat kritere përsëriten edhe për Partinë Socialiste dhe Lëvizja Socialiste për Integrim, vetëm se në rastin e PS dhe LSI, mosha për të hyrë në parti është së paku 16 vjeç.

Në të tria rastet u vu re se mund të bëheshe anëtar partia pa mbushur moshën për të votuar. Përgjithësisht partitë politike shqiptare e vlerësojnë ekzistencën e anëtarësisë në organizatë, dhe për pasojë anëtarët konsiderohen si të rëndësishëm, siç mund të ilustrohet edhe nga fushatat e rekrutimit të zhvilluara herë pas here nga partitë politike për të rekrutuar anëtarë. Legjitimiteti që vjen nga një anëtarësi e madhe është po aq i rëndësishëm sa ai që vjen nga fitorja në elektorat (Shih Tabela 11: Anëtarësia e Partive politike Shqiptare: 1991-2013).

Koncepti i anëtarësisë, megjithatë, në partitë politike shqiptare, ngjashëm me partitë në vendet post-komuniste ka pësuar një lloj ‘zgjerimi’ kuptimor që vjen si pasojë e nevojës për të propozuar kandidatë për poste publike, veçanërisht në zgjedhjet lokale. Partitë politike, sidomos PS dhe PD kanë qenë gjithmonë në gjendje të vendosin anëtarë të partisë, ose të anëtarësojnë kandidatë të fortë në partitë e tyre, por kandidatët për kryetar bashkie nuk kanë qenë gjithmonë anëtarë të partisë. Van Biezen, argumenton se kjo vjen si rezultat i një depërtimi të dobët territorial (2003: 143), gjë që manifestohet me një profil të ulët të partive në politikën lokale. Për të kompensuar mungesën e kandidatëve potencialë për poste publike, partitë politike në vendet post - komuniste shpesh kanë vendosur kandidatë pa afiliacion politike nën emrin e partisë. Në rastin e Shqipërisë, këta kandidatë shpesh kanë ardhur nga bota e biznesit dhe ndonjë herë edhe janë marrë nga rradhët e një partie tjetër (rasti i kandidatit të PS në zgjedhjet lokale të 2011 ku në Kavajë konkuroi me kryetarin aktual të bashkisë që e pat fituar mandatin në vitin 2007 si kandidat i PD-së). Kjo mund të shihet si një dobësi e partive politike sepse vë në dukje mungesën e aftësisë për të ushtruar një prej funksioneve më të rëndësishme, së paku tradicionalisht, të partive politike: atë të furnizimit të posteve zyrtare me anëtarë të partisë.

Sidoqoftë kjo jo domosdoshmërit flet për paaftësinë e partisë në drejtim të rekrutimit. Në fakt rekrutimi i anëtarëve jashtë organizatës, mund të shihet edhe si një strategji e re, një mekanizëm alternativ ndaj kanaleve tradicionale, për më tepër që kjo nuk bie ndesh edhe me orientimin drejt qytetarit dhe jo politikës që zgjedhjet vendore kanë marrë së fundmi. Kështu koalicioni i djathtë në zgjedhjet e vitit 2011, u quajt ‘Aleanca për Qytetarin’ dhe ideja që përshkoi të gjithë fushatën ishte ajo e të kryerit të një fushate për qytetarin dhe jo të një fushatë politike¹⁷.

Shpesh autorët e shohin rekrutimin e kandidatëve jo-partiakë si problematik në lidhje me disiplinën dhe kohezionin e partisë. Megjithatë, problemi më i madh që vjen prej një përzgjedhjeje të tillë ka të bëjë me kthimin e politikës në personale: kandidatët me influencë në zonë e kanë më të lehtë kontrollin e votës dhe për pasojë e kanë më të lehtë edhe ushtrimin e praktikave klienteliste dhe atyre të patronazhit. Dhe pikërisht një qasje e tillë ndaj zgjedhjeve është një indikator që flet për natyrën klienteliste të partive politike shqiptare. Praktika të tilla të përzgjedhjes së kandidatëve për poste publike në zgjedhjet vendore, janë vërejtur edhe në vende të tjera post-komuniste, megjithatë kjo është shoqëruar edhe me nivel të ulët anëtarësie, gjë që indikon se partitë janë relativisht indiferente ndaj konceptit të anëtarësisë (van Biezen, 2003:145). Megjithatë, rritja gjithmonë e më tepër e anëtarësisë së partive politike shqiptare e shoqëruar me rënie të relevancës së tyre, tregon se këto parti politike e përdorin numrin e madh të anëtarësisë për të rritur legjitimitetin e tyre, por jo për të kryer funksionet që tradicionalisht i përkasin anëtarësisë.

¹⁷ Gabimi konceptual që shoqëron këtë ndarje të fushatës: në për qytetarin dhe politike nuk është pjesë e fokusit të këtij punimi, andaj edhe nuk do të ndalem këtu.

Partitë dhe grupet e interesit

Marrëdhënia ndërmjet Partisë së Punës dhe sindikatave (Fronti Demokratik) u ndërpre menjëherë pas zgjedhjeve të para, ku edhe Fronti Demokratik reshti së ekzistuari. Sindikatat që u krijuan më pas trashëguan asetet e Frontit Demokratik, por patën një aleancë të shprehur me Partinë Demokratike. Megjithatë shumë shpejt rëndësia e tyre ra dhe ato reshtën së shërbyeri si lidhëse mes PD dhe shoqërisë. Mungesa e ndihmës financiare prej sindikatës për PD, është një indikator që tregon se lidhja mes tyre nuk është e fortë, dhe për pasojë nuk mund të shërbejë si një urë që lidh partinë me shoqërinë.

Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë, pasuese e Frontit Demokrati, nuk ka afiliacion politik (Statuti i KSSH, neni 3). Ajo nuk ka përfaqësues të saj në strukturat drejtuese të partisë, dhe nuk ndikon në procesin e vendimmarrjes. Në këtë sens, në ndryshim nga vendet e Evropës Perëndimore, sindikata nuk luan rol lidhës të partisë me shoqërinë.

Në Shqipëri, anëtarësia në parti është individuale. Nuk ka anëtarësim kolektiv. Një përpjeke e partive politike shqiptare për të rritur lidhjet me shoqërinë, është krijimi i organizatave rinore apo të gruas, të cilat janë të pranishme në strukturën ekzekutive të partisë dhe në organet e tjera të vendim-marrjes. Një qasje e tillë është e ngjashme me modelin klasik të partisë së masave. Kështu Partia Socialiste ka Forumin Rinor Eurosocialist Shqiptar, dhe Forumin e Gruas Socialiste. Partia Demokratike ka Forumin Rinor të Partisë Demokratike dhe Forumin e Gruas. Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, ka të njëjtat organizata degë: Lëvizja Rinore për Integrim dhe Lëvizja e Gruas për Integrim.

Megjithatë më tepër se sa lidhës të partisë me shoqërinë, këto organizata shërbejnë për të rekrutuar të rinjtë dhe gratë si anëtarë të partisë.

4.3 Struktura Organizacionale

Organet Kombëtare të Partisë

Të tria partië politike të marra në shqyrtim janë organizuar mbi baza territoriale, duke patur celulën (organizata socialiste për PS, seksion për PD dhe Organizata pranë Qendrës së Votimit për LSI) – degën lokale si njësinë më të vogël organizative. Dega lokale është e organizuar për çdo bashki dhe përputhet me zonën zgjedhore.

Partitë e marra në shqyrtim shfaqin një nivel të lartë artikulimi vertikal, me lidhje të forta midis niveleve të ndryshme organizacionale përmes përfaqësimit të shtresave më të ulëta në ato më të larta. Organizatat partiake përgjithësisht janë strukturuar me drejtim nga poshtë-lart, dhe kanë krijuar kongrese, konventa apo kuvende në të gjitha nivelet e organizimit të cilat zakonisht përbëhen kryesisht nga delegatë të zgjedhur në nivelet më të ulëta dhe që perceptohen si organe përfaqësuese të organizatës bazë. Organet ekzekutive zgjidhen nga dhe japin llogari tek këto asamble. Së fundmi, kongresi/kuvendi/konventa e partisë është autoriteti më i lartë i partisë. Kjo gjë thekson rëndësinë që i jepet organizatës partiake të bazuar tek anëtarësia dhe është një indikator i ndikimit që kanë ushtruar modelet tashmë ekzistuese të organizimit partiak në perëndim tek partitë politike shqiptare.

Më konkretisht, në nenin 4 të Statutit të PD thuhet: “Partia Demokratike e Shqipërisë është një organizim politik i qytetarëve të grupuar me vullnet të lirë në strukturat e saj të organizuara mbi bazën e ndarjes territoriale të vendit. Me vendim të Kryesisë së PDSH mund të formohen struktura organizative edhe mbi baza socio-profesionale”.

Ndërsa neni 17 mbi Organizimin Lokal të partisë specifikon se “Organizimi i PD bëhet mbi bazën e njësive territoriale administrative, njësive elektorale ose në nivel kombëtar mbi bazën e kriterëve specifike. Njësitë organizative të PD janë: -seksionet; grupseksionet; nëndega e Partisë Demokratike; degët e Partisë Demokratike”. Organi më i lartë për nëndegët, degët dhe partinë në tërësi janë kuvendet të cilat mbledhen një herë në katër vjet (neni 21 dhe neni 36).

E njëjta situatë shfaqet edhe për Partinë Socialiste. Në nenin 13 të statusit të PS specifikohet se “Organizata Socialiste është njësi bazë organizative dhe elektorale e PS....Organizata Socialiste ngrihet sipas vendbanimit në bazë fshati, lagjeje ose grupi banesash në qytet sipas parimit një OS për një qendër votimi”. Më pas në statusin e partisë përshkruhen njësitë më të mëdha të cilat rriten gradualisht dhe konkretisht, pas organizatës socialiste vijnë me rradhë duke u rritur në madhësi dhe hierarki Asambleja Socialiste e bashki/komunës (neni 15), Kryetari i partisë i bashkisë/komunës (neni 17), Asambleja Socialiste e Rrethit (neni 18), Kryetari i Partisë i Rrethit (neni 19), Këshilli Koordinues i Partisë në Qark (neni 20). Ndërkaq organet drejtuese qendrore të partisë janë Kongresi i Partisë si organi më i lartë vendim-marrës (neni 24), Asambleja Kombëtare e PS (neni 27), Kryesia e Partisë Socialiste (neni 29), Kryetari i Partisë Socialiste (neni 30) dhe Sekretariati Ekzekutiv i Partisë Socialiste (neni 31). Organi më i lartë për bashkitë, komunat, rrethin dhe organet drejtuese në qendër janë Asambleja Socialiste e bashki/komunës (neni 15), Asambleja Socialiste e Rrethit (neni 18) dhe Asambleja Kombëtare e PS (neni 27), ndërsa organi më i lartë është Kongresi i Partisë Socialiste (neni 24) i cili mbledhet një herë në katër vjet dhe përbëhet nga përfaqësues të të gjitha organizatave bazë.

Edhe LSI pohon në statutin e saj se është “parti politike me organizim vertikal nga baza në qendër sipas ndarjes së zonave zgjedhore, e cila në themel të organizimit të saj ka demokracinë e brendshme në parti, lirinë e shprehjes dhe besimit, të drejtën për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur sipas parimit “një anëtar - një votë” (pika 9.1). Në pikën 9.3 të statudit sqarohet se partia operon në nivel vendor dhe qendror. Në nivel vendor ajo ka këtë organizim: a) Organizata pranë Qendrës së Votimit; b) Komiteti Drejtues pranë Njesisë Vendore; c) Konventa e Rrethit; d) Komiteti Drejtues i LSI-së së Rrethit; e) Kryesia e LSI-së së Rrethit (pika 9.4). Ndërsa në nivel qendror, LSI ka këtë organizimi: a) Konventa Kombëtare; b) Komiteti Drejtues Kombëtar; c) Kryesia; d) Kryetari; e) Zëvendëskryetari; g) Sekretari i Përgjithshëm (pika 9.5).

Në raportet financiare të partive politike vihet re se Partia Socialiste ka 36 degë dhe Partia Demokratike ka 39 degë. Në raportin financiar të LSI nuk figuron numri i degëve por në statutin e saj thuhet se ajo është “parti politike me organizim vertikal nga baza në qendër sipas ndarjes së zonave zgjedhore...” (pika 9.1) dhe se ajo e “ushtron aktivitetin e saj në të gjithë territorin e vendit dhe jashtë vendit ku ka struktura të ngritura në përputhje me Statutin e LSI-së” (pika 9.2).

Ajo çka vihet re është se në statusin e tyre, partitë politike shqiptare janë të organizuara sipas konceptimit të partisë së masave. Organizimit të partisë me degë dhe nën-degë, kongrese, kuvende apo konventa si dhe funksionimit dhe funksioneve të tyre i është kushtuar një pjesë shumë e madhe e statusit, gjë që përpiqet të japë mesazhin se anëtarësia është me të vërtetë ‘zinxhiri i transmisionit’ i partisë . Në këtë kuadër, është e rëndësishme të thuhet se për të tria partitë e marra në studim, anëtarësia e organizatës është baza ekskluzive mbi të cilën strukturohet e gjithë organizata jashtë-parlamentare. Kjo do të thotë

që madhësia e partisë është vendimtare për shpërndarjen e përfaqësimit të strukturave më të ulëta në kongresin/konventën/kuvendin e partisë apo në organet e tjera kombëtare, sikurse edhe për numrin e përfaqësuesve në organe në nivelet më të larta të partisë në përgjithësi. Por po aq e rëndësishme është të thuhet se organizatat bazë janë të vendosura pranë qendrave elektorale gjë që flet edhe për një orientim elektoral të partive politike shqiptare.

Në linjë me atë që u tha më sipër, në rastin e Partisë Demokratike, seksioni është njësi më e vogël organizative e partisë dhe organizohet mbi bazën territoriale të qendrave të votimit. Kryesia e tij përbëhet nga 3-7 vetë në varësi nga numri i anëtarësisë (neni 18). Ndërkaq kryetari i grupseksionit që është një nivel më lartë se seksioni, zgjidhet me votim të fshehtë nga kryesia e grupseksionit e cila është e përbërë ndër të tjera edhe nga kryesitë e seksioneve (neni 19). Dhe kjo qartazi tregon që seksionet me peshë më të madhe (me numër më të madh) ushtrojnë influencë më të madhe sidomos po të kihet parasysh se sipas pikës 4 të nenit 19 “në rastet kur përfaqësimi ... deformon dukshëm përfaqësimin që bazohet mbi numurin e anëtarësisë dhe të votave të marra dhe kur aktivi i zgjeruar është shumë i madh, atëherë përbërja e aktiveve të zgjeruara të grupseksioneve bazohet 50% në numurin e anëtarëve të PD në seksione dhe 50% në numurin e votave të marra nga çdo seksion ndaj totalit të votave të territorit të grupseksionit”. Pra numri i anëtarësisë përcakton edhe peshën e seksionit në grupseksion. E njëjta logjikë operon edhe në përzgjedhjen e kryetarit të nën-degës, kandidatura e të cilit propozohet nga seksionet dhe grupseksionet (neni 23) dhe e njëjta logjikë vazhdon deri në ekelonet më të larta të partisë dega apo organet qendrore. Një ndër kategoritë përbërëse të Kuvendit Kombëtar e përbëjnë anëtarët e zgjedhur nga kuvendet e nëndegëve në përputhje me numrin e përcaktuar nga Këshilli Kombëtar dhe që bazohet 50% në numrin e anëtarësisë së nëndegës dy muaj para

datës së Kuvendit dhe 50% në votat e marra në zgjedhjet e fundit parlamentare (neni 38, pika2.a). *Kjo pikë e fundit tregon se përveçse i jep peshë numrit të anëtarësisë, Partia Demokratike i jep rëndësi gjithashtu edhe peshës elektorale të njësive të saj.*

Partia Socialiste shpreh një orientim më të fortë drejt elektoratit. Njësia bazë organizative e saj është Organizata Socialiste e cila ngrihet sipas parimit një Organizatë Socialiste një qendër votimi. Një nivel më lartë është Asambleja e partisë e bashki/komunës. Kryetarët e partisë të bashki/komunës propozohen nga Organizatat Socialiste që e përbëjnë këtë bashki/komunë dhe miratohen nga Kryesia e PS (neni 13.3.a dhe neni 17.1). Kjo tregon se anëtarësia ka një peshë të rëndësishme por në të njëjtën kohë tregon se partia ka një orientim drejt elektoratit dhe se propozimet mund të kenë kah nga poshtë-lartë por autoritetit final vjen nga Kryesia, gjë që ia ul peshën anëtarësisë. E njëjta logjikë vazhdon me Asamblenë Socialiste të Rrethit (neni 19.1 dhe 19.2). Një element tjetër që flet për orientimin elektorale të partisë është se sipas nenit 21.1 dhe 21.2 “Në të gjitha nivelet organizative vendore të partisë krijohen strukturat koordinuese të menaxhimit elektorale. Për çdo OS, AS bashki/komunë, ZAZ emërohet koordinatori elektorale përkatës dhe ngrihet struktura e aktivitetit elektorale. Në shkallë qarku ngrihet këshilli koordinues elektorale i qarkut i përbërë nga anëtari i Kryesisë së Partisë i ngarkuar për qarkun, deputetët e qarkur, kryetarët e partisë të rretheve, koordinatorët elektorale të ZAZ-ve dhe drejtuesit e njësive vendore përfaqësues të PS”.

Pra mund të thuhet se koordinatorët elektorale janë struktura paralele me organizmat e tjerë të partisë dhe duke qenë se sipas nenit 21.3 “mënyrat e përzgjedhjes dhe emërimit, përbërja, varësia, detyrat specifike dhe modalitetet e bashkëveprimit të kësaj strukture elektorale me strukturat e zgjedhura politike të partisë përcaktohen me udhëzim të

Kryesisë së PS” mund të thuhet se ky rregullim cënon rëndësinë e anëtarësisë në favor të profesionistëve të partisë dhe Kryesisë së Partisë. Pra flet më tepër për një model drejtimi nga lart-poshtë dhe jo anasjelltas. Po kështu neni 24 dhe 25 që specifikojnë zgjedhjen dhe kompetencat e Kongresit si organi më i lartë vendimmarrës i partisë nuk tregojnë se si ruhet çështja e përfaqësimit në përzgjedhjen e delegatëve në kongres. Kështu neni 25.1 specifikon se “Delegatët e Kongresit zgjidhen nga anëtarësia e Partisë e bashkive/komunave sipas parimit një anëtar një votë dhe normës së përfaqësimit të miratuar nga AK [Asambleja Kombëtare] e PSSH”, por nuk specifikon se ç’farë kriteresh përdor AK, duke e lënë këtë çështje në dorë të organeve qendrore të partisë dhe jo duke u mbështetur në peshën specifike të anëtarësisë për nën-degë apo degë.

Në analizën e Lëvizja Socialiste për Integrim vihet re se statusi është më pak i detajuar se sa ai i Partisë Demokratike apo Socialiste. Në ngjashmëri me dy partitë e tjera megjithatë vihet re se edhe kjo parti i organizon strukturat e saj në varësi të qendrës së votimit. Kështu neni 10.1 specifikon se “Njësia bazë e organizimit të LSI-së është Organizata pranë Qendrës së Votimit”. Përsa i përket peshës së anëtarësisë statuti i partisë nuk tregon se si ndikon numri i anëtarësisë i njësive organizative në vendimmarrje, pra nuk specifikon nëse respektohen rregullat e përfaqësimit në varësi të numrit të anëtarëve, gjë që e bën ambig procesin duke i dhënë më shumë rol Kryesisë së partisë sesa anëtarësisë.

Partitë politike shqiptare i kanë kufizuar mundësitë e anëtarësisë për përfshirje dhe pjesëmarrje. Ato pasqyrojnë reformat e ndërmarra nga partitë politike në vendet e Evropës Perëndimore, si rezultat i të cilave anëtarësia bëhet gjithmonë e më pak relevante. Shumë prej ndryshimeve organizacionale çojnë drejt marginalizimit të anëtarësisë, dhe humbjes së demokracisë së brendshme. Kështu rënia e frekuencës së kongreseve të partisë mund të

shihet si një shembull i mekanizmave përmes të cilave anëtarësia po e humbet gjithmonë e më tepër rëndësinë e saj dhe udhëheqja e partisë po fiton gjithmonë e më tepër terren në kurriz të saj.

Në një farë mënyre lidhjet e dobëta të partisë me shoqërinë kanë shtruar rrugën për të patur një rol më të dominues të elitave partiake. Ashtu sikurse e parashikojnë statutet e partive, por edhe sikurse e tregon praktika politike, është kryesia e partisë ajo që kontrollon funksionimin e apartit partiak, procesin e vendimmarrjes dhe përzgjedhjen e kandidatëve në postet publike. Jo rrallë ka ndodhur që janë zgjedhur individë në poste publike dhe më pas janë anëtarësuar në partitë politike. Megjithëse organizata bazë mund të ketë deri diku zë në përzgjedhjen e kandidaturave për poste publike, kryesia kombëtare e partisë ruan të drejtën e aprovimit final apo të vetos.

Niveli i lartë i centralizimit rreth lidhshimit të partisë bëhet më i dukshëm nga pozicioni dominues i udhëheqësit të partisë brenda organizatës, i cili, jo vetëm në praktikën politike por edhe për shkak të statutit, gëzon një pozicion të privilegjuar.

Së fundmi duhet nënvizuar se anëtarët e partive politike shqiptare janë më pak të rëndësishëm sesa profesionistët e paguar për aktivitetin e brendshëm të partisë. Edhe këtu partitë politike shqiptare shfaqin prirjet e partive politike në perëndim dhe në vendet post-komuniste (van Biezen, 2003, 205). Kështu sipas raportit vjetor financiar të Partisë Socialiste për vitin 2012, 2013, ajo ka 28 punonjës ose 3.9 punonjës për 10,000 anëtarë. Nëse këtë e krahasojmë me vendet e Evropës Perëndimore si dhe me ato post-komuniste ku raporti është respektivisht 6.3 dhe 12.9 për 10,000 anëtarë, në pamje të parë duket sikur në rastin e Partisë Socialiste, anëtarësia predominon mbi profesionistët. Megjithatë duhet patur parasysh se partitë politike shpenzojnë shuma të jashtëzakonshme për konsulencë dhe

reklama televizive për të përçar mesazhin tek audienca, punë këto që dikur kryeheshin nga anëtarësia. Kështu për t'u shënuar është vlera e jashtëzakonshme prej 44,882,548 lekë që PD shpenzoi në fushatën e vitit 2009 për konsulencë. Në të njëjtën linjë sipas raportit të auditimit për fushatën elektorale 2013, Partia Socialiste shpenzoi 154,725,626 lekë për median dhe 7,874,686 lekë për konsulencë në një kohë që në të njëjtin vit, PS shpenzoi vetëm 30,480,197 lekë për personelin në terma të pagave, shpenzimeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, pra shumë më pak se ç'pagoi për median dhe konsulencën.

4.4 Shpërndarja e brendshme e pushtetit

Struktura organizacionale e partive politike shqiptare dhe balanca e brendshme e partisë bazohet mbi parimet e centralizimit demokratik. Këto parime indikojnë se përveç zgjedhjes me drejtim nga posht-lart të organeve drejtuese të partisë dhe llogaridhënies që këto të fundit duhet t'i japin organeve zgjedhore, pakica i nënshtrohet shumicës dhe se vendimet e organeve ekzekutive janë të detyrueshme për të gjitha nivelet e ndryshme të organizatës.

Më konkretisht, sipas statutit të Partisë Socialiste “1. demokracia e brendshme në Parti është kusht politik, organizativ dhe moral i ekzistencës dhe i zhvillimit të saj. Personaliteti dhe dinjiteti i anëtarit të partisë janë të pacënueshëm. ... 4. PS në veprimtarinë e saj harmonizon demokracinë direkte me demokracinë përfaqësuese. Anëtari i partisë e shpreh vullnetin drejtpërdrejtë ose me delegim. Delegatët zgjedhës, si rregull, kanë mandate me kohëzgjatje të njëjtë me të zgjedhurit e tyre. ... Disiplina në Parti bazohet në konvergencën e mendimeve për alternativat e zhvillimit. Pas votimit të vendimit, zbatohet vullneti i shumicës” (neni 1). Me anë të nenit 2 të statutit të saj Partia Socialiste njeh lirinë e mendimit dhe garanton votimin e fshehtë (pika 1 dhe pika 2) dhe se organet drejtuese të

partisë janë të detyruara të shqyrtojnë propozimet e anëtarëve të partisë dhe t'u kthejnë përgjigje brenda një muaji (pika 4) gjë që e bën partinë burokratike duke krijuar distancë midis anëtarësisë dhe organeve drejtuese. Por ndërsa garanton mendimin e lirë dhe ndryshe, Partia Socialiste udhëhiqet nga parimi i kolegjalitetit dhe më konkretisht sipas nenit 3 të statutit të partisë “drejtimi i Partisë në çdo pjesë të strukturës së saj është kolegjal. Organizata socialiste dhe organet drejtuese në veprimtarinë e tyre zbatojnë parimin e kolegjalitetit dhe të punës në ekip.Iniciativa personale e anëtarit të partisë, e shprehur në emër të PS, duhet të jetë në përputhje me Programin dhe Statutin e saj” (pika 1 dhe 4). Kështu që në këtë kuadër është e vështirë të shprehet mendimi ndryshe kur autoritetin për të përcaktuar përputhshmërinë ose jo me programin e partisë e kanë organet drejtuese dhe kur pavarësisht mendimit ndryshe të gjithë duhet të zbatojnë parimet e kolegjalitetit.

Përsa i përket Partisë Demokratike, ajo njeh parimin e demokracisë së brendshme por nuk specifikon ndonjë dispozitë për mendimin ndryshe. Më konkretisht sipas nenit 8 të statutit thuhet se “funksionimi i PD bazohet në demokracinë e brendshme, e shprehur përmes votës së anëtarëve të saj. Vota e përfaqësuar u njihet vetëm përfaqësuesve të mandatuar prej anëtarëve” (pika 1). Ndërsa përsa i përket Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, ajo ashtu sikurse dy partitë e tjera funksionon sipas parimit të demokracisë së brendshme dhe kolegjalitetit por njeh edhe fraksionimin. Më konkretisht sipas nenit 14: “LSI-ja njeh dhe garanton përfaqësimin e fraksioneve në forumet e saj. Rregulla të hollësishme mbi mënyrën e legalizimit dhe të përfaqësimit të fraksioneve në forumet e LSI-së i përcakton Konventa Kombëtare”.

Pra ndër partitë e marra në shqyrtim, vetëm LSI i njeh me statut fraksionet, ndërsa dy partitë e tjera jo. Megjithatë edhe në rastin e LSI-së, pavarësisht se njihen me statut, nuk

janë vënë re fraksionime të ligjëruara brenda partisë që prej momentit të krijimit të saj në vitin 2004. Përkundrazi, tentativat për mendim ndryshe kanë rezultuar me largimin e “të ndryshmëve” nga partia. Po kështu prezenca e liderëve historik në parti janë një indikator i përqëndrimit të pushtetit në duart e kryesisë në dëm të demokracisë së brendshme. Kështu historia e Partisë Demokratike është historia e fraksionimit dhe “eliminimit” të kundërshtarit politike. Ajo ç’ka është vënë re tek Partia Demokratike është pikërisht mungesa e kohezionit të elitave (Xhaferaj, 2011: 49-50). Lideri historik i PD-së, Sali Berisha dha dorëheqjen nga kryesia e partisë vetëm në vitin 2013, pas humbjes së zgjedhjeve elektorale duke qenë *de facto* dhe në pjesën më të madhe edhe *de jure* (me përjashtim të periudhës 1992-1997 kur ka qenë president i vendit) për 22 vite kryetari i partisë. Po kështu edhe kryetari i LSI-së është në krye të kësaj partie që prej vitit 2004, vitit të krijimit të saj. Ai u rikonfirmua si kryetar i saj në vitin 2012, pra 8 vite pas krijimit të partisë, edhe pse konventat e partisë do të duhej të mbaheshin një herë në katër vjet. Përsa i përket Partisë Socialiste, rotacioni i liderëve drejtues ka qenë më i hershëm në këtë parti. Lideri historik i partisë, Fatos Nano dha dorëheqjen në vitin 2005, pas humbjes së zgjedhjeve të përgjithshme, dhe që prej asaj kohe në krye të partisë është Edi Rama, i cili u rikonfirmua në këtë post në vitin 2009, pas humbjes së zgjedhjeve të përgjithshme por nuk është rikonfirmuar ende si kryetar i partisë nga kongresi i partisë që do të duhej të mbledhej në vitin 2013, por nuk u mbledh sipas parimit që kryetari që e ka çuar partinë drejt fitores së zgjedhjeve është automatikisht i konfirmuar si i tillë, pra legjitim.

Një aspekt tjetër, shumë i rëndësishëm që flet për balancën e brendshme të pushtetit është edhe ai financiar. Vendimet për çështjet financiare zakonisht ndjekin një zinxhir që shkon nga lart-poshtë, pra nga qendra drejt degëve dhe nën-degëve. Pavarësisht autonomisë

financiare të degëve lokale, siç është grumbullimi i të ardhurave të kuotizacioneve të anëtarëve të vetë degës, nivelet e ulëta në hierarkinë organizative janë të kushtëzuar prej qendrës në marrjen e fondeve për zhvillimin e akativiteteve të tyre. Shpërndarja e buxhetit dhe miratimi i shpenzimeve bëhet në qendër, gjë që e ul ndjeshëm mundësinë e njërive organizative në nivelet e ulëta për të manovruar. Për më tepër duke qenë se shumica e partive e marrin pjesën më të madhe të buxhetit prej fondeve shtetërore që grumbullohen në nivel qendror, nivelet e ulëta të organizimit partiak kanë pak liri për të manovruar, dhe kjo liri u lihet për shuma të vogla të cilat në fakt përcaktohen në nivel qendror. Kështu neni 51 i Statutit të Partisë Socialiste specifikon se “Rezultatet financiare dhe buxheti vjetor i Partisë, në shkallë vendi, shqyrtohen dhe miratohet në Kryesinë e PS” (pika 1). Më tej në status specifikohet se “Për drejtimin dhe koordinimin e veprimtarisë financiare të Partisë si dhe kontrollin mbi administrimin e tyre në të gjitha nivelet e strukturave të Partisë funksionojnë financierët e Partisë dhe Komisionet e Revizorëve të emëruar sipas kriterëve të përcaktuara në këtë Statut” (pika 2) dhe së fundmi “Veprimtaria ekonomike e financiare e Partisë shtrohet për shqyrtim në mbledhjen e parë të vitit të AK të PS dhe më shumë se një herë në vit në Kryesinë e Partisë” (pika 3). Në të njëjtën linjë është edhe Partia Demokratike. Kështu në nenin 30, pika 1. të statutit të saj specifikohet se “Financimi i strukturave lokale bëhet nga shuma në formë granti që akordon kryesia qendrore”. Në pika të tjera të po këtij neni specifikohet se të ardhura të degëve janë edhe kuotizacionet apo kontributet e anëtarëve të zonës apo të kryetarëve të komunave, bashkive apo asambleve në këto zona, megjithatë siç do të shihet edhe më poshtë, është kryesia në qendër ajo që përcakton se sa dhe ku do të shkojnë fondet e partisë. Ndërkaq, situata është edhe më e paqartë tek Lëvizja Socialiste për Integrim. Sipas nenit 16.2 të statutit të partisë “Veprimtaria financiare dhe

ekonomike e LSI-së drejtohet nga Financieri i LSI-së” i cili zgjidhet për një periudhe kohore 4 vjeçare nga Komiteti Drejtues Kombëtar. Por neni nuk specifikon se kush do të përfitojnë nga të ardhurat e partisë dhe në asnjë moment nuk e përmend financimin e degëve të partisë prej qendrës.

Një indikator shumë i vlefshëm që tregon për centralizimin e pushtetit në qendër dhe rënien e rëndësisë së degëve janë shpenzimet vjetore dhe ato për fushatë. Nga analiza e shpenzimeve të partive politike shihet se kontributi më i madh shkon për konsulenca, koncerte, anëtarësime në organizma të tjerë, gjë që tregon se shpenzimet e përditshme të partisë dhe pagat e personelit zënë një vend mjaft të vogël. Ka megjithatë një problem me pasqyrimin e shpenzimeve, sepse audituesit e partive të marra në shqyrtim nuk kanë ndjekur të njëjtin format dhe për më tepër i kanë pasqyruar së bashku si shpenzimet e bëra në qendër ashtu edhe ato të kryera në degë. Vetëm Partia Demokratike e ruan këtë ndarje dhe konkretisht mund të shihet se si prevalojnë shpenzimet e kryera në qendër mbi ato të kryera në të gjitha degët e marra së bashku. Kështu në fushatën e vitit 2013, Partia Demokratike ka shpenzuar 96,610,377 lekë në total nga të cilat në degë janë shpenzuar 31,836,160 lekë ndërsa në qendër 65,310,108 lekë ose më tepër se dyfishin e shumës së të gjitha degëve të marra sëbashku. Ndërsa në vitin 2009, Partia Demokratike ka shpenzuar 54,114,178 lekë në të gjitha degët e partisë dhe 102,936,889 lekë në qendër dhe sërisht shuma e shpenzuar në qendër është pothuaj sa dyfishi i asaj të shpenzuar në të gjitha degët e partisë, edhe pse partia ka 36 degë. Përsa i përket Partisë Socialiste dhe LSI-së është e vështirë të gjykosh sepse ato nuk i kanë ndarë shpenzimet në shpenzime në qendër dhe shpenzime në degë. Megjithatë po të shihet raporti i shpenzimeve vjetore në vitin 2013 mund të vihet re se shuma e paguar në fushatën elektorale të vitit 2013 është 187,183,915

lekë nga të cilat 162,600,312 lekë ose 86% e fondit janë përdorur për spote televizive, media në Greqi dhe konsulenca. Për pasojë, janë kryer shumë pak shpenzime të tipit qera ambjenti, kancelari, fletëpalosje, foni-ndriçim, baner etj. që janë shpenzime që kryhen në qytetet dhe zona të ndryshme të vendit dhe janë shpenzimet tipike që do të kryente një parti masash. Kjo tregon se fushat menaxhohet tërësisht në nivel qendror. Për më tepër Partia Socialiste në këtë fushatë ka paguar vetëm 80,078,542 lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 107,105,373 lekësh nuk është paguar. Pjesën më të madhe të kësaj shume, dhe konkretisht 106,409,373 e përbëjnë reklamat televizive, gjë që flet sërisht për një lloj aleance të partive me median në përgjithësi dhe një mosvarësi nga anëtarësia dhe për pasojë më pak shpenzime për të.

Për sa i përket, përzgjedhjes së kandidatëve për postet lokale, procesi është relativisht i decentralizuar, ose duket i tillë në statut. Kjo do të thotë se për vendimet e marra në nivel lokal apo rajonal, zyrtarët në qendër nuk e kanë pushtetin për të ndërhyrë në përzgjedhjen e këtyre kandidatëve. Megjithatë në praktikë është disi ndryshe. Propozimet për listat e kandidatëve diskutohen në nivel të organeve qendrore, të cilët ndërhyjnë dhe ndryshojnë përmbajtjen e listës, sidomos për sa i përket pozicioneve kryesore. Përzgjedhja e kandidatëve për postet publike në rang kombëtar është më e centralizuar, e cila vërtet duket sikur propozohet nga organizata bazë në terren, por lista përfundimtare miratohet nga kryesia. Pavarësisht procesit formal me qasje nga poshtë-lartë për përzgjedhjen e kandidatëve, drejtuesit e partisë në qendër kanë në fakt një ndikim të madh në hartimin e listës së kandidatëve, si me statut ashtu edhe në jetën praktike.

4.5 Partia Jashtë Parlamentare vs. Partia në Poste Publike

Në parim, marrëdhënia ndërmjet partisë jashtë-parlamentare dhe partisë në ofiqe publike mund të ketë një rën nga këto forma: a) partia në post publik mund të dominojë mbi partinë jashtë-parlamentare; b) ka një balancim midis forcës së partisë jashtë-parlamentare dhe partisë në post publike dhe c) partia jashtë-parlamentare dominon mbi partinë në post-publike (Duverger, 1954: 182-202). Sipas van Biezen (2003:158) në partitë politike në vendet post-komuniste partia në post publik dominon mbi atë jashtë-parlamentare. Një ndër arsëyet për këtë gjë është se, pjesa më e madhe e partive post-komuniste u krijuan prej nivelit zero. Ato u formuan ose shumë pak para se të mbaheshin zgjedhjet e para demokratike ose u krijuan prej rradhëve të lëvizjeve apo partive që konkuruan në zgjedhjet e para. Për pasojë, ato fituan përfaqësim parlamentar në një fazë të hershme të zhvillimit të tyre. Në shumë raste ato u kufizuan vetëm me prezencë parlamentare dhe qeveritare në një kohë që u mungonte një strukturë organizacionale që të dilte përtej kufijve të zyrës. Kështu që prej fillimit, partia në postin publik mori rolin më të rëndësishëm, dhe kështu që edhe iniciativat për të ndërtuar një strukturë organizacionale të shtrirë në terren e patën zanafillën tek ajo (van Biezen, 2003:158). Nëse do t'i referoheshim tipologjisë partiake të Duverger (1954), këto parti u krijuan prej së brendshmi, nëse një origjinë e tillë ka të njëjtën vlerë dhe kuptim që pati marrëdhënia ndërmjet partisë jashtë-parlamentare dhe partisë në post publik në vendet e Evropës Perëndimore. Po kështu, po të kemi parasysh edhe Panebianco (1988) sipas të cilit është origjina gjenetike e partisë ajo që përcakton më së shumti strukturën organizacionale të partisë, atëherë pritshmëria është që partia në post publik të ruajë pozicionin e saj predominues në parti, sidomos edhe sepse është pikërisht

kjo pjesë e partisë që inicioi dhe më pas kontrollloi zhvillimin e mëpasëm organizacional të partisë.

Pika tjetër e rëndësishme është që partitë në vendet post-komuniste patën një origjinë institucionale dhe jo shoqërore. Ndërsa partia e masave në vendet e Evropës Perëndimore përfaqësonte interesat e një segmenti të caktuar të shoqërisë, në vendet post-komuniste nuk kishte stratifikim shoqëror dhe ekonomik të shoqërisë dhe për pasojë as interesa të mirë-përcaktuara. Përkundrazi, konflikti ndërmjet partive ishte më së shumti institucional dhe debatet ndërmjet partive u krijuan mbi bazën e qëndrimeve të ndryshme që ato patën në lidhje me çështje institucionale, dhe veçanërisht me shtrirjen dhe drejtimin e ndryshimit të regjimit. Për këtë arsye, partitë politike ia kushtuan kohën e tyre arenës parlamentare dhe jetës qeveritare dhe për pasojë e fokusuan vëmendjen e tyre tek partia në postin publik. Për këta arsye, kjo fytyrë e partisë fiton një pozicion të rëndësishëm në organizatën partiake në tërësi.

Faktori i tretë që influencon predominancën e partisë në post publik përkundër asaj jashtë-parlamentare është se partitë kanë prirjen të fokusohen më shumë në strategjitë elektorale të cilat kërkojnë më pak kohë dhe janë më të lehta për të mobilizuar elektoratin. Me pak fjalë, partitë politike kanë prirjen që të investojnë më shumë për të krijuar një lidhje të drejtpërdrejtë mes partisë dhe elektoratit sesa të kanalizojnë kërkesat e shoqërisë përmes organizatës jashtë-parlamentare (van Biezen, 2003: 159).

Për të parë se cila ‘fytyrë’ e partisë mbisundon jam fokusuar në dy aspekte:

1. Kuptimi që ka partia mbi balancën e pushtetit ndërmjet krahut jashtë-parlamentar dhe partisë në post publik. Ky aspekt është analizuar përmes investigimit të rregullave zyrtare të partisë, duke u fokusuar kryesisht në ato pjesë të statutit të partisë që trajtojnë

poziconin e krahun jashtë-parlamentar të partisë vis- à- vis krahut të partisë në post publik. Kështu janë parë normat e sjelljes së përfaqësuesve parlamentarë të partisë, rregullat e brendshme të grupit parlamentar dhe përzgjedhja e drejtuesit të grupit. Në funksion të punimit, objektivi kryesor i hulumtimit është të përcaktojë nëse partia në post publik gëzon një pozicion të pavarur apo në një farë mënyre është në varësi të krahut jashtë-parlamentar dhe është në varësi të tij për veprimet që ndërmerr.

2. Aspekti i dytë që merret në konsideratë është shkalla e mbivendosjes së personelit të partisë jashtëparlamentare me atë në post publik. Kjo do të thotë është parë nëse zyrtarët që kanë poste publike dhe drejtuesit partiakë jashtë parlamentit gëzojnë përfaqësim *ex officio* në organet institucionale të njeri-tjetrit. Po kështu, në këtë kuadër është analizuar edhe mbivendosja aktuale e personelit ndërmjet ekzekutivit të partisë dhe partisë në post publik. Duke patur parasysh origjinën institucionale të Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim, pritshmëria është që së paku për këto dy parti, prania në masë të konsiderueshme e zyrtarëve në poste publike, në organet jashtë-parlamentare të partisë të jetë një indikator i predominancës së partisë në post publik, duke bërë të mundur kështu që ‘fytyra’ në post publik të ruajë një pozicion drejtues brenda partisë si edhe kontrollin mbi strukturat jashtë-parlamentare.

3. Aspekti i tretë ka të bëjë me analizën e shpërndarjes së burimeve financiare në dy krahët e partisë. Analiza është fokusuar mbi rregullat dhe praktikën e financimit partiak, duke u përqëndruar kryesisht në shumën që shteti i alokon organizatës jashtë-parlamentare dhe grupit parlamentar. Sigurisht që paratë janë një burim politik i rëndësishëm dhe metoda e shpërndarjes së fondeve në ‘fytyrat’ e ndryshme të partisë është një indikator i rëndësishëm i balancës së pushtetit ndërmjet atyre të dyjave.

Konceptimi i brendshëm i balancës së pushtetit

Në analizën e statuteve të partive politike shqiptare të marra në shqyrtim vihet re se partia në postin publik shfaqet edhe si një organ i pavarur por edhe si një organ nën kontrollin e partisë jashtë-parlamentare. Kjo vihet re pikërisht nga mungesa e referencave ndaj grupit parlamentar në statutin e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partisë Demokratike. Kështu në nenin 49 mbi Grupin Parlamentar, në statutin e PD specifikohet se grupi parlamentar përfaqëson PD në Parlament dhe siguron aty mbrojtjen e platformës, programit dhe interesave të PD si edhe i propozon Këshillit Kombëtar të partisë për çështje që janë kompetencë e këtij të fundit. Përsa i përket pikave të tjera, grupi ka autonomi në hartimin e programit në parlament, përcakton mënyrën e veprimit të deputetëve, vendos për ndarjen e anëtarëve të tij në komisionet parlamentare dhe harton rregulloren e funksionimit të tij. Ndërsa në statutin e LSI e vetmja referencë që bëhet në lidhje me grupin parlamentar është se anëtarët e grupit parlamentar janë automatikisht pjesë e Këshilli Drejtues të Partisë.

Ndërsa në statutin e Partisë Socialiste vihet re një fokusim më i madh në mënyrën sesi organizohet dhe vepron grupi parlamentar. Me nenin 37 përcaktohet se Grupi Parlamentar Socialist (GPS) është strukturë politike e partisë. Ky grup mbron në Kuvend qëndrimin e Partisë Socialiste në zbatim të programit të saj. Në lidhje me shkallën e autonomisë së deputetëve në parlament, ajo vendoset paraprakisht në varësi të rëndësisë dhe natyrës së projektligjit që do të miratohet. Në rast se kërkohet unanimitet në votim në parlament, kjo vendoset paraprakisht dhe vendimi i marrë me shumicë votash duhet të respektohet. Në statutin e Partisë Socialiste parashikohen edhe masa ndëshkuese ndaj anëtarëve “të pabindur”. Kështu, në rast se një deputet i grupit parlamentar nuk merr pjesë, voton kundër apo abstenon ndaj vendimit politik për çështje si miratimi i ligjeve

kushtetuese që kërkojnë një shumicë të cilësuar; miratimi i buxhetit të shtetit; votbesimet për qeverinë, përbërjen dhe programet që ajo paraqet; zgjedhjen e personaliteteve të larta shtetërore, deputeti mund të ç’regjistrohet nga grupi parlamentar, gjë që automatikisht e nxjerr atë jashtë anëtarësisë së partisë. Së fundmi, marrëdhëniet midis grupit parlamentar dhe PS përcaktohen me rregullore të veçantë të cilën e miraton Asambleja Kombëtare. Pra shihet qartë që ‘fytyra’ jashtë parlamentare e PS mbizotëron mbi atë në post publik. Ky statut i Partisë Socialiste është miratuar në nëntor 2011, në një kohë kur kryetari i Partisë Socialiste nuk mbante asnjë post zyrtar pas humbjes së zgjedhjes si Kryetar i Bashkisë së Tiranës në maj 2011. Andaj kjo shpjegon se pse autoriteti final mbi veprimtarinë e partisë në parlament mbetet në duart e partisë jashtë-parlamentare.

Megjithatë, edhe mungesa e referencës ndaj grupit parlamentar në statutin e Partisë Demokratike dhe LSI shpjegohet me arësyetimin se partitë politike kanë qenë më të fokusuara të organizojnë jetën e partisë si të tillë, andaj edhe referencat ndaj grupit parlamentar kanë qenë më të pakëta.

Akumulimi i mandateve

Nga analiza e mësipërme doli se në rastin e PD dhe LSI nuk shihet një predominancë e partisë jashtë-parlamentare mbi atë parlamentare, ndërsa në rastin e PS kjo predominancë ishte e dukshme. Megjithatë, pozicioni i privilegjuar i përfaqësuesve të partisë që mbajnë poste publike është i dukshëm në praninë e tyre në organet jashtë-parlamentare. Kështu kryetari i grupit parlamentar për Partinë Socialiste është anëtar i kryesisë së partisë. Po kështu, deputetët anëtarë të partisë janë pjesë e Asamblesë Kombëtare. Po kështu deputetët socialist që nuk janë anëtarë partie kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë

Kombëtare e cila organizon gjithë punën dhe veprimtarinë e PS në periudhën midis dy kongreseve të partisë, pra në pjesën më të madhe të kohës po të kihet parasysh se kongreset mbledhen një herë në katër vjet. Po kështu, deputetët e partisë që janë anëtarë të partisë kanë të drejtë automatikisht të marrin pjesë si delegatë në Kongres. Edhe në rastin e Partisë Demokratike, kryetari i grupit parlamentar është anëtar i kryesisë dhe deputetët e partisë janë pjesëtarë të Kuvendit Kombëtar të Partisë. Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, nuk ka ndonjë specifikim për këtë, megjithatë ajo që në fillim u krijua prej një grupi deputetësh që u larguan nga Partia Socialiste, andaj edhe kontrolli i partisë në post publik është i vazhdueshëm mbi partiën jashtë-parlamentare.

Megjithatë është edhe një element tjetër i rëndësishëm për t'u parë, dhe konkretisht duhet parë nëse ka mbivendosje mandatesh ndërmjet partisë në post publik dhe partisë jashtë-parlamentare. Nëse shikohen listat e deputetëve në parlament, vihet re se kemi një mbivendosje mandatesh me përfaqësuesit e partisë në nivelet më të larta të saj. Kështu kryesia e PS është e përbërë nga 17 vetë, 13 janë deputetë të PS, 2 janë ministra, por që ishin edhe deputetë por pas marrjes së detyrës si ministër dhanë dorëheqjen, një është kryetar bashkie dhe një zv.Kryeministër pasi dha dorëheqjen si kryetari i bashkisë së Korçës. Nëse shihet përbërja e sekretarëve të partisë, ajo është e përbërë nga tetë vetë, katër prej të cilëve janë ministra dhe tre deputetë. Vetëm njëri prej sekretarëve është pa post publik. Po kështu, janë disa figura të rëndësishme të PS të cilët kanë fituar post publik dhe më pas janë anëtarësuar në partinë që i ka mbështetur. Rasti më ezkemplar është ai i Edi Ramës, kryetarit të Partisë Socialiste prej vitit 2005, i cili fillimisht u mbështet nga Partia Socialiste si Minister i Rinisë, Kulturës dhe Sporteve në vitin 1998 dhe më pas u mbështet nga e njëjta parti në zgjedhjet për Kryetar Bashkie në Tiranë të cilat edhe i fitoi. Edi Rama

u anetaresua ne parti në vitin 2003. Kastriot Isami është një tjetër figurë historike e PS, por ai nuk ka qenë që në fillim anëtar i partisë. Aktualisht nje tjetër depute e PS, Eglantina Gjermani megjithëse është deputet e PS që prej vitit 2009, është anëtarësuar në PS në vitin 2012 dhe tashmë është edhe pjesë e kryesisë së partisë. Pra rruga për të kaluar në post publik nuk ka qenë gjithmonë përmes partisë, por e vlefshme është edhe e anasjellta, pra partia që fton figura të rëndësishme, i promovon dhe më pas i integron në strukturat e saj. Është e qartë, se nuk mund të bëhet karrierë publike pa përkatësi partiake, sidomos për poste politike. Pra mund të thuhet se partia në post publik është partia jashtëparlamentare.

Një situatë e tillë e ngjashme është edhe tek Partia Demokratike. Në analizë është marrë kryesia e partisë e zgjedhur në vitin 2011 dhe është krahasuar me deputetët e legjislaturës 2013-2017 për të parë se si ndikon kryesia në përzgjedhjen e kandidatëve për deputet. Sipas analizës, kryesia e PD përbëhet nga 27 anëtarë ku 18 janë deputetë, një është zgjedhur President i Republikës dhe katër kanë qenë deputet në legjislaturën 2009-2013. Mbivendosja mes partisë jashtë-parlamentare dhe asaj parlamentare nuk është aq e ndjeshme sa në rastin e PS megjithatë edhe në këtë rast mund të thuhet se partia në post publik është partia jashtë-parlamentare. Megjithatë mbivendosje ka patur që në momentin e krijimit të partisë dhe pjesëmarrjes në zgjedhje. Kështu në zgjedhjet parlamentare 1991, 13 nga 17 anëtarët e kryesisë ishin deputetë. Po kështu në zgjedhjet e vititn 1992, nga 19 anëtar që kishte kryesia e PD 19 ishin deputetë (Meksi, 2010). Në vitin 1996, kryesia e partisë kishte 19 vetë nga të cilët 17 ishin deputetë në parlament (Meksi, 2010; Krasniqi 2009). Pra mund të thuhet se që në fillimet e saj Partia Demokratike patur një mbivendosje të mandateve mes krahut jashtë-parlamentar dhe atij parlamentar të partisë.

Situata ndryshon tek Lëvizja Socialiste për Integrim. Këtu mbivendosja nuk është aq e madhe sa në rastin e dy partive të tjera, kjo edhe për faktin se përfaqësimi publik i partisë është më i pakët se sa kryesia e saj prej 25 vetësh. Kryesia e partisë është e përbërë nga 25 veta, nga të cilët tetë janë deputetë dhe tetë të tjerë kanë postin e ministrit ose zv.ministrit. Aktualisht LSI ka 16 deputetë por vetëm tetë prej tyre janë pjesë e kryesisë. Është e vështirë të kuptohet kjo ndarje mes partisë jashtë-parlamentare dhe asaj parlamentare sidomos po të kihet parasysh se kryesia është miratuar në vitin 2012, pra një vit para zgjedhjeve dhe një pjesë e saj nuk janë figura të njohura në jetën politike. Në këtë kontekst duket sikur pushteti më i madh anon në kahun e partisë në post publik, aq më tepër po të kihet parasysh se Kryetari i Partisë, Ilir Meta është njëkohësisht edhe Kryetari i Kuvendit Popullor. Megjithatë, po shihen veprime më të hershme të kryesisë së partisë, balanca ka anuar më tepër nga partia jashtë parlamentare. Ja si përshkruhet ndryshimi në nivel postesh publike, për shkak të nevojave të partisë në gazetën [shqiptarja.com]:

Një sërë ndryshimesh pritet që të ndodhin në qeverinë Berisha. Ministri i Shëndetësisë, Petrit Vasili, ka ofruar dorëheqjen nga posti që mban pasi do të jetë organizatori i Konventës Zgjedhore Kombëtare të LSI, njoftoi sot kreu i kësaj force politike, Ilir Meta. Dorëheqja e ministrit Vasilit ka krijuar një seri lëvizjesh që përfshijnë tre ministri dhe postin e një zëvendës kryetari të Kuvendit. Kështu, LSI propozoi Vangjel Tavon në postin e mbajtur deri më sot nga Vasili ndërsa Nasip Naço do të kalojë në postin vakant të krijuar nga Tavo si zv/kryetar i Parlamentit. Meta njoftoi gjithashtu se Edmond Haxhinasto do të vijojë të mbajë postin e zv/kryeministrit, por do të kalojë nga Ministria e Jashtme te ajo e Ekonomisë e Tregtisë. Në krye të diplomacisë shqiptare Meta ka propozuar Edmond Panaritin.

Këto lëvizje, sipas Metës, justifikohen nga nevojat organizative të Konventës Zgjedhore Kombëtare të LSI që do të zhvillohet më 29 dhe 30 shtator (23.06.2012, seksioni: news).

Ajo ç'ka vihet re është se posti publik është nën drejtimin e krahut jashtë-parlamentar. Një arsye për këtë, është se të tria partitët kanë përjetuar periudha kur liderët

e tyre, kanë qenë pa post publik. Partia Socialiste, e ka përjetuar tre herë këtë. Fillimisht kur kryetari i saj, Ramiz Alia, nuk fitoi si deputet në zgjedhjet e vitit 1991. E megjithatë, duke qenë në krye të partisë arriti të bëhej President i vendit. Më pas me burgosjen e kryetarit Fatos Nano në periudhën 1993-1997, partia drejtohej nga jashtë dhe së fundmi, në periudhën 2011-2013, kur kryetari i Partisë Edi Rama, humbi zgjedhjet si për Kryetar Bashkie në Tiranë, duke e drejtuar kështu partinë, pa patur asnjë post publik. Madje, gjatë periudhës 2005-2011, posti publik që ka patur ka qenë ai i kryetarit të Bashkisë së Tiranës, dhe jo ai i deputetit. Partia Demokratike po e përjeton së fundmi, ku kryetari i Partisë, Lulzim Basha, pasi vendosi të mos kandidonte më si Kryetar Bashkie në Tiranë, që prej qershorit të vitit 2015, periudhë kur u zhvilluan zgjedhjet lokale, e drejton aktivitetin parlamentar të partisë prej së jashtmi, pra prej krahut jashtë-parlamentar. Përsa i përket partisë LSI, pas hetimit që filloi kundër zv.Kryeministrit dhe Kryetarit të Partisë, Ilir Meta, u ndodh në situatën e dorëheqjes së këtij të fundit, si nga posti i deputetit ashtu edhe nga ai i zv. Kryeministrit, duke përjetuar kështu të njëjtën situatë sikurse edhe Partia Socialiste deri më atë atëherë.

Një arsye për forcimin e krahut jashtë-parlamentar kundrejt atij në post-publik, vjen edhe për shkak të ndarjes që shpesh kanë pësuar partitë. Për shkak të moshës së re të partive politike (për partitë e reja) dhe për shkak të ndryshimeve rrënjësore të sistemit (për Partinë e Punës më pas Partia Socialiste) është e kuptueshme që edhe besnikëria partiake të ishte e ulët. *Andaj mund të thuhet se partitë politike shqiptare për të ruajtur partinë nga ndarjet që u manifestuan me largimin e deputetëve nga njera parti (si nga Partia Demokratike ashtu edhe ajo Socialiste) dhe krijimin e partive të reja parlamentare (krijim prej së brendshmi sipas Duverger, 1954) forcuan krahun jashtë-parlamentar*

përkundër atij në post-publik duke e zhvendosur balancën e pushtetit drejt ekzekutivit të partisë. Pra kontrollimi prej majës së partisë i procesit të rekrutimit të personave që në të ardhmen do të kishin poste publike është një ndër mënyrat sesi partitë politike në Shqipëri kompensojnë mungesën e rezervuarit të besnikëve të partisë dhe përpiqen të sigurojnë kohezionin e partisë përmes ‘disiplinës së imponuar’. Duke qenë se ndarjet shpesh ndodhnin në parlament, ku përgjithësisht një grup i një partie shkëputej për të krijuar një parti tjetër, partisë ‘mëmë’ i duhej të legjitimonte veprimet dhe vendimet e saj, dhe legjitimimin mund ta merrte vetëm nga partia. Andaj, sado që partia të ‘përçahet’ në nivel parlamentar, ajo duhej të mbetej solide. Dhe kjo mund të garantohe vetëm po të forcohej partia jashtë-parlamentare.

Megjithatë në të tria partitë vihet re një mbivendosje e partisë jashtë-parlamentare nga ajo në post publik që është më e theksuar për Partinë Socialiste. Megjithëse rregullat partiake lejojnë një lloj mbivendosje midis ky krahëve të partisë, sërisht kjo mbivendosje është shumë e madhe në realitet. Një arsye është se në asnjërën prej partive pozicioni i atij që mban post publik nuk bie ndesh me pozicionin e tij në parti. Po kështu legjislacioni nuk shikon ndonjë kontradiktë midis mandateve parlamentare dhe atyre ministrore. Vetëm në qeverinë e kryesuar nga PS që fitoi zgjedhjen në 2013, këto mandate janë të papërputhshme dhe të gjithë deputetët që kanë pranuar poste ministrore kanë dhënë dorëheqjen nga të qenit deputetë. Por në të gjitha legjislaturat e tjera këto mandate nuk kanë qenë në kontradiktë me njeri tjetrin dhe përgjithësisht ata që mbanin poste ministrore ishin edhe deputetë në parlament. Kështu në qeverinë 2009-2013, të gjithë ministrat ishin edhe deputetë në parlament.

Në këtë mënyrë, prezenca e jashtëzakonshme e përfaqësuesve parlamentarë dhe anëtarëve të qeverisë në ekzekutivin e partisë konfirmon pritshmërinë se partia në post publik zë një vend të rëndësishëm në partinë jashtë-parlamentare por njëkohësisht se partia jashtë-parlamentare, apo ekzekutivi i partisë është i domosdoshëm për për një karrirë të mundshme politike.

Alokimi i fondeve shtetërore

Në kuadër të investigimit të balancës së pushtetit ndërmjet partisë jashtë-parlamentare dhe partisë në post publik, është e rëndësishme të shihet se deri në ç'masë dy krahët e partisë janë financiarisht të lidhur me njeri-tjetrin, si edhe ç'pjesë zë secili krah në shumë totale të burimeve financiare që partia përfiton prej shtetit. Pavarësisht pozicionit që së paku zyrtarisht konsiderohet si i pavarur, mund të vihet re se grupet parlamentare japin kontribute financiare për partinë jashtë-parlamentare, por në asnjë prej raporteve mbi aktivitetin vjetor të partive nuk figuron që partia jashtë-parlamentare të japë koontribute për grupin parlamentar.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur donacionet që partia ka marrë prej deputetëve krahasuar me kuotat e anëtarësisë së partisë.

Tabela 15: Të ardhurat nga anëtarësia dhe deputetët për periudhën 2011-2013

2011¹⁸		
Partia	Kuotat e Deputetëve (lekë)	Kuotat e anëtarësisë
PS	3,702,000	0
LSI	0	0
2012¹⁹		
PS	3,492,000	350,000
PD	2,900,000	0
LSI	0	0
2013²⁰		
PS	0	14,712,900
PD	4,275,000	0
LSI	0	1,749,500

Raportet vjetore të tri viteve nuk mund të japin një informacion edhe aq të qartë për të kuptuar mirëfilli se ç'rol luajnë kuotat e deputetëve apo të anëtarësisë. Megjithatë, këto ishin të dhënat e vetme që mund të grumbulloheshin. Përveç kësaj ka raste ku raportet e partive nuk e specifikojnë se sa janë marrë nga kuotat e deputetëve dhe sa nga anëtarësia,

¹⁸ Raportet financiare vjetore për vitin 2011 parë në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve: <http://www.cec.org.al/sq-al/Publikimet/Raporte-Financiare/Raportet-vjetore-financiare-t%C3%AB-partive-politike/Raportet-vjetore-financiare-p%C3%ABr-vitin-2011>

¹⁹ Raportet financiare vjetore për vitin 2012 parë në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve: <http://www.cec.org.al/sq-al/Publikimet/Raporte-Financiare/Raportet-vjetore-financiare-t%C3%AB-partive-politike/Raportet-vjetore-financiare-p%C3%ABr-vitin-2012>

²⁰ Raportet financiare të partive politike për vitin 2013, parë në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve: <http://www.cec.org.al/sq-al/Publikimet/Raporte-Financiare/Raportet-vjetore-financiare-t%C3%AB-partive-politike/Raportet-vjetore-financiare-t%C3%AB-partive-politike-p%C3%ABr-vitin-2013>

siç është rasti i Partisë Socialiste për vitin 2013. Për dy vitet e tjera, 2011 dhe 2012, është e qartë që kuotat e deputetëve janë shumë më të mëdha sesa kuotat e anëtarësisë: në vitin 2011 kuotat e anëtarësisë kanë qenë zero lekë, ndërsa një vit më vonë kanë qenë 10-fish më të pakta se kuotat e deputetëve. Situata paraqitet akoma më ‘dramatike’ përse i përket kuotave të anëtarësisë në rastin e Partisë Demokratike, ku kuotat janë zero. Ndërsa LSI është partia ku kuotat e deputetëve për tri vite rradhazi janë zero.

Një shpjegim i mundshëm për këtë është që në rastin e PS dhe PD krahu në post publik i nënshtrohet krahit jashtë-parlamentar, ndërsa në rastin e LSI, përforcon idenë e shprehur në seksionin mbi *Akumulimin e Mandateve*, që dy krahet janë njësoj të fuqishëm dhe deri diku të pavarur nga njeri-tjetri.

Legjislacioni shqiptar, i shpërndan fondet (shih kapitullin V) në përputhje me përfaqësimin parlamentar, por fondet shtetërore i jepen partisë, e cila më pas vendos mbi mënyrën sesi do të shpenzohen këto fonde. Në ndryshim nga vendet e tjera post-komuniste, ku subvencionet shtetërore ndahen midis partisë jashtë-parlamentare dhe grupit parlamentar (van Biezen, 2003), në Shqipëri grupi parlamentar nuk përfiton fonde shtetërore. Duke patur parasysh se si fondet për aktivitetin vjetor ashtu edhe ato për fushatën elektorale i jepen krahit jashtë-parlamentar të partisë, kjo përforcon më shumë rolin e këtij krahu kundrejt partisë në post publik. Partia jashtë-parlamentare është kështu në një pozicion financiar shumë më të mirë se partia në post publik. Kjo nënkupton që në ndryshim nga partitë politike në vendet e Evropës Perëndimore ku ka predominancë të partisë në post-publik kundrejt krahit jashtë-parlamentar, partitë politike në Shqipëri karakterizohen nga një predominancë e krahit jashtë parlamentar.

5. Konkluzion

Nga analiza e bërë në këtë kapitull duket se, me përjashtim të balancës së pushtetit mes partisë jashtë-parlamentare dhe partisë në poste publik, partitë në Shqipëri kanë adoptuar stile organizacionale që janë të ngjashme me atë të simotrave të tyre në demokracitë më të vjetra. Në fakt, në shumë aspekte, këto parti i shfaqin në mënyrë edhe më të theksuar tiparet e partive bashkëkohore në perëndim. Kjo është e vërtetë si për lidhjet e dobëta me shoqërinë, ashtu edhe për rënien e rëndësisë së anëtarësisë, predominancës së profesionistëve dhe udhëheqjes së partisë apo të asimilimit të partisë në shtet.

Një tjetër qasje e këtij kapitulli ishte premisa se partia në post publik do të ishte fytyra predominuese e partive politike. Kjo premisë mbështetej nga teoritë e formimit të partive politike si edhe nga eksperiencia e partive politike në Evropën Perëndimore, sikurse edhe nga konteksti i veçantë në të cilën lindën partitë politike në vendet post-komuniste, ku edhe Shqipëria bën pjesë. Megjithatë nga të tri dimensionet e matura këtu, kjo nuk u vërtetua. Mbajtësit e posteve publike me të vërtetë gëzojnë të drejta të konsiderueshme për të qenë të përfaqësuar në organet e partisë jashtë-parlamentare. Për më tepër, përbërja aktuale e ekzekutiveve kombëtarë tregon se këto ekzekutive janë kryesisht të përbërë nga deputetë në parlament dhe qeveritarë.

Megjithatë, në lidhje me statusin e partisë në poste publike vis-à-vis organizatës jashtë-parlamentare, statuti i partive tregonte se partia jashtë-parlamentare kishte një pushtet shumë të fortë dhe kontrollonte atë në parlament, sidomos në rastin e Partisë Socialiste. Kjo gjë bien në kundërshtim me premisën sipas së cilës është partia në post-publik ajo që predominon krahun jashtë parlamentar. Partia në post publik më tepër se organ autonom duket se është e nënshtruar në mënyrë të konsiderueshme ndaj partisë

jashtë-parlamentare. Megjithatë raporti mes tyre do të analizohet edhe më thellë në kapitullin pasardhës ku analizohen më me detaje financat e partive politike dhe ndikimi që ato kanë mbi strukturën dhe organizimin e tyre.

KAPITULLI V – NDIKIMI I FINANCAVE MBI PARTITË POLITIKE

- “MË THUAJ SI FINANCOHESH TË TË THEM SE Ç’PARTI JE”

5.1 Hyrje

Në vitet e fundit aktivitetet e brendshme dhe të jashtme të partive politike janë bërë gjithmonë e më tepër subjekt i rregullave shtetërore që përcaktojnë veprimtarinë e këtyre partive. Jo më kot Katz komenton se partitë janë kthyer në ‘objekte legjitime të rregullave shtetërore në një shkallë që i tejkalon limitet e asaj që do të ishte e pranueshme për një shoqëri private në një shoqëri liberale’ (2002: 90). Shumë prej këtyre rregullave u hartuan në periudhën kur shteti filloi të ofronte fonde publike për partitë, sepse dhënia e këtyre fondeve kërkonte pashmangshmërisht një sistem të qartë dhe të mirëpërcaktuar që kontrollonte regjistrimin dhe aktivitetin e partive politike. Po kështu u pa si nevojshmëri edhe kontrolli i aksesit që partitë politike kishin ndaj medias publike, gjë që nga ana tjetër kërkonte hartimin apo zgjerimin e një sistemi rregullash që do ta organizonte këtë pjesë.

Vendosja e rregullave shtetërore mbi partitë politike pati ndikim të rëndësishëm mbi aspektin financiar dhe organizativ të partisë dhe në të njëjtën kohë vështirësoi hyrjen e partive të reja në sistemin partiak (van Biezen & Rashkova, 2011:2). Në lidhje me aspektin organizativ të partisë Katz dhe Mair (1995) vunë re se vendosja e subvencioneve shtetërore për partitë politike i ka bërë këto të fundit gjithmonë e më tepër të varura nga shteti dhe në të njëjtën kohë ka ndikuar në mënyrën se si ato organizohen. Ata vunë re se rritja e aksesit ndaj fondeve publike, ka çuar në orientimin e partive drejt shtetit dhe në largimin e tyre prej shoqërisë. Për pasojë partia e masave nuk është më forma dominante e organizimit partiak: masat tashmë nuk sigurojnë më burimin kryesor financiar të të ardhurave të partive

politike. Tipologjia më e re partiake është ajo e partisë kartel, e cila bëhet palë me shtetin dhe nuk lejon hyrjen e partive të reja në sistemin partiak. Në epokën e partisë kartel, partitë kryesore bashkëpunojnë së bashku dhe përfitojnë nga burimet e shtetit – si subvencionet shtetërore, aksesit ndaj medias, ose patronazhi partiak – për të siguruar mbijetesën e tyre kolektive (Katz dhe Mair, 1995). Gjithashtu van Biezen (2003) vë re se rritja e varësisë së partive prej shtetit, si financuesi kryesor i aktivitetit të tyre, ka rezultuar në rritje të përqëndrimit të pushtetit brenda partisë (177).

Fondet publike shfaqen si një fenomen akoma më i përhapur në demokracitë e reja. Ato ndikojnë mbi forcën dhe natyrën e lidhjeve të partive politike me shoqërinë dhe shtetin, dhe për pasojë edhe mbi zhvillimin organizacional të partive politike. Ndërsa në demokracitë e vjetra liberale financimi shtetëror u vendos vetëm pas një kohe të gjatë të institucionalizimit të sistemit partiak dhe konsolidimit të regjimit demokratik, vendet post-komuniste u karakterizuan nga parti politike që u krijuan në një situatë ku shteti filloi t'i financonte ato që në fazat e para të krijimit të tyre, duke u hequr kështu incentivat për të kërkuar fonde prej burimeve të tjera në shoqëri (van Biezen, 2003:38). Duke qenë se pjesa më e madhe e partive politike në vendet post-komuniste (me përjashtim të ish partive komuniste) e nisën akvitetin e tyre me struktura organizacionale të pazhvilluara, që për pasojë nuk mund të shfrytëzoheshin si burim financiar, shteti luan një rol akoma më të madh se sa ç'ka luajtur në vendet e Evropës Perëndimore. Andaj edhe ky kapitull analizon financimin partiak, duke u fokusuar në analizën e rëndësisë së shtetit dhe shoqërisë si kontribues të aktivitetit partiak dhe të pasojave që ata kanë mbi organizimin partiak. Punimi merr në shqyrtim si aspektin ligjor në lidhje me rregullat e financimit ashtu edhe fondet aktuale publike që partitë kanë marrë prej shtetit.

5.2 Korniza ligjore e Fondeve Publike dhe ndikimi i tyre mbi partitë politike

Financimi i partive politike është një koncept kompleks që përfshin një sërë aspektesh. Përgjithësisht studjuesit i referohen skemës treshe të von Beyme (1985) sipas së cilës burimet e financimit të partive politike janë burime të jashtme, që përbëhen nga fondet publike dhe donacionet private si edhe nga burimet e brendshme që përbëhen prej të ardhurave të anëtarësisë. Megjithëse këto nuk janë burimet e vetme të të ardhurave, ato megjithatë përbëjnë pjesën më të madhe, të zakonshme dhe të ligjshme të të ardhurave për të blerë asetet e nevojshme për suksesin e partisë (Burnell, 1998). Pa fonde, partitë politike janë të paafta të konkurojnë në mënyrë të suksesshme, dhe kjo mund të jetë katastrofike për sistemin partiak. Andaj edhe në sistemet ku mungojnë burimet e domosdoshme, kemi një sistem partiak që karakterizohet nga një paqëndrueshmëri e lartë.

Duke parë rëndësinë e partive dhe të sistemit partiak, shumë prej vendeve post-komuniste, dhe këtu nuk bën përjashtim as Shqipëria, u kanë dhënë partive politike asistencë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë (Kopecky, 2007). Ndhima e tërthortë zakonisht mori formën e kohës falas në radio dhe televizion dhe është përdorur për të ndihmuar partitë të shpërndajnë mesazhin e tyre politik (Ikstens et al., 2002; Moser, 2001; Roper, 2002). Ndërsa ndihma e drejtpërdrejtë ka përfshirë ose rimbursim të shpenzimeve për fushatat elektorale ose fonde për të mbuluar shpenzimet ndërmjet fushatave, pra për aktivitetin organizativ të partive (Both & Robbins, 2010, 633; Gherghina dhe Chiru, 2013:113).

Është vënë re se subvencionet shtetërore rrisin orientimin elektoral të partive politike, duke qenë se shpërndahen në përputhje me mbështetjen elektorale dhe

përfaqësimin parlamentar dhe për pasojë performanca elektorale përkthehet në mënyrë të drejtpërdrejtë në të ardhura financiare. Andaj edhe partitë nuk mund ta neglizhojnë performancën e tyre elektorale. Në këtë sens, fondet publike forcojnë orientimin e partive drejt lidhjeve 'ad hoc' dhe afat-shkurtra me elektoratin dhe jo drejt zhvillimit të marrëdhënieve strukturore dhe permanente me shoqërinë (van Biezen, Kopecky, 2001: 402; Van Biezen, 2003: 39).

Burimi i dytë i jashtëm i të ardhurave janë donacionet private që përfshijnë donacione prej individëve, korporatave apo grupeve të huaja të interesit. Megjithëse paratë apo subvencionet shtetërore janë qartësisht të rëndësishme për partitë për të mbuluar shpenzimet e tyre, rregullat në lidhje me financimin e fushatave elektorale janë gjithashtu të rëndësishme për dy arsye (Casas-Zamora, 2005). Kur partitë përballen më rregulla shtrënguese në lidhje me financimin e fushatave elektorale, shanset për të mbijetuar shpesh bien sikurse bie edhe aftësia e tyre për të grumbulluar fonde të mjaftueshme. Kjo do të thotë se në shtetet ku ligjet për fushatën elektorale i ndalojnë donacionet prej aktorëve privatë (individë, korporata, grupe interesi, të ardhura nga jashtë vendit, etj.), partive u duhet të mundohen më shumë për të grumbulluar fondet e duhura. Përgjithësisht kjo rezulton me pamundësinë e partive për të financuar aktivitetet e tyre dhe në të njëjtën kohë influencon aftësinë e tyre për të ndërvepruar me elektoratin sepse atëherë kur ka kufizime në kontribuimin financiar të grupeve private të interesit, ka edhe një rënie në kultivimin e lidhjeve me shoqërinë, sepse partitë e humbin interesin për t'iu drejtuar donatorëve individual, korporatave apo donatorëve të huaj. *Përfundimisht mund të thuhet se në rast se është i ndaluar grumbullimi i fondeve prej aktorëve privatë, atëherë kemi lidhje të dobëta*

të partisë me shoqërinë, sistem partiak të dobët dhe paqëndrueshmëri të lartë elektorale (Both & Robbins, 2010: 633-634).

Ka edhe një aspekt tjetër të rëndësishëm për t'u analizuar në lidhje me rregullat që rregullojnë shpërndarjen e fondeve publike. Duhet parë pra se deri në ç' masë këto rregulla mund të përdoren për të mbrojtur privilegjet e partive në pushtet përkundër partive të reja dhe opozitës jashtë-parlamentare. Në rast se partitë janë të afta t'i mbajnë larg partitë e reja dhe opozitën jashtë-parlamentare kjo do të tregonte masën në të cilën partitë në demokracitë e reja janë në gjendje të formësojnë zgjedhjet dhe të menaxhojnë mjedisin politik dhe social për të rritur benefitet e tyre. Përgjithësisht, partitë politike në vendet post-komuniste i hartuan rregullat në mënyrë të tillë që të lehtësonte mbijetesën e atyre që morën pushtetin dhe postet qeveritare që në fillim. Partitë që nuk e patën këtë mundësi që në fillim apo që u krijuan më vonë, u disavantazhuan nga rregullat e vendosura dhe e patën të vështirë të depërtojnë në sferën e pushtetit (Biezen and Kopecky, 2001: 420-421). Është gjithashtu e rëndësishme të shihet se në ç'proporcion i ndihmon shteti partitë politike. *Përgjithësisht, një sistem i cili jep shuma fikse është më i favorshëm për partitë e vogla, sepse në këtë rast ato marrin një shumë më të madhe parash se sa në rastin ku mbështetja financiare kryhet në përputhje me mbështetjen elektorale të partive. Përkundër, sistemet që i shpërndajnë subvencionet financiare shtetërore mbi bazën e proporcionalitetit, favorizojnë kryesisht partitë e mëdha* (van Biezen, 2004: 709).

Ndërkaq, *fondet publike kanë një ndikim të rëndësishëm në balancën e brendshme të partisë sepse ato inkurajojnë përqëndrimin e pushtetit në majat e piramidës partiake.* Kjo është veçanërisht e vërtetë në rast se shuma e fondeve publike grumbullohet në nivel kombëtar dhe autoriteti vendim-marrës mbi shpërndarjen e brendshme të fondeve ndodhet

në majtat më të larta të organizatës. Duke qenë se paratë transferohen nga maja drejt degëve të organizatës në terren, ku organet kombëtare vendosin se për cilat aktivitete do të shpenzohen paratë dhe se si do të shpërndahen ato nëpër degë, një varësi e madhe ndaj fondeve shtetërore inkurajon një model organizimi nga lart-poshtë dhe karakterizon nivele të larta centralizimi (van Biezen, 2003: 39).

5.3 Korniza Ligjore e Financimit të Partive Politike në Shqipëri

Në Shqipëri, ashtu sikundër në vendet e tjera post-komuniste, sistemi partiak u ‘popullua’ nga tri kategori partishë politike: partia trashëgimtare e partisë komuniste, partitë e para-luftës apo partitë e rigjallëruara dhe partitë e reja. Prej tyre, vetëm Partia Socialiste, trashëgimtare e Partisë së Punës, gëzonte një rrjet organizacional të përhapur në të gjithë territorin, godina dhe burime njerëzore. Në këtë kontekst, vendet komuniste, me qëllimin për të krijuar një opozitë të qëndrueshme kundër *ancient regime* (Both & Robins, 2010:632) i dhanë mundësi partive politike të përfitonin prej subvencioneve shtetërore. Financimi i partive prej fondeve publike u duk si mbështetja më e mirë sepse krijonte një sërë avantazhesh për aktorët politikë (si p.sh. kosto organizacionale apo subvencione për fushatat elektorale). Për më tepër burimet do t’u krijonin mundësi partive politike të zhvillonin organizata komplekse, të rekrutonin kandidatë me profil të lartë, të forconin lidhjet me elektoratin dhe të mobilizonin votuesit (Lewis, 1998; Grzymala – Busse, 2002; van Biezen 2003; Booth & Robbins 2010:633).

Ligji për financimin e partive politike në Shqipëri ka ndryshuar vazhdimisht, megjithatë gjithmonë është specifikuar se partitë politike e përfitojnë këtë lloj subvencioni dhe e vetmja gjë që ka ndryshuar është sasia dhe mënyra e përlllogaritjes së buxhetit. Tabela

e mëposhtme tregon në mënyrë të përmbledhur se si ka ndryshuar legjislacioni mbi sponsorizimin e partive politike gjatë periudhës 1991-2013.

Tabela 16: Tabelë përmbledhëse mbi rregullat e financimit të Partive Politike në Shqipëri: 1991-2013²¹

Komponentët kyç	Ligji 7502 (25.07.1991) ²²	Ligji 7591 (21.04.1994) ²³	Ligji 8580 (17.02.2000) ²⁴	Ligji 10019 (29.12.2008) ²⁵	Ligji 74/12 (19.07.2012) ²⁶
1. Fonde Private					
1.1 Kuotat e Anëtarësisë	E lejuar	E lejuar	E lejuar	E lejuar	E lejuar
1.2 Asetet	E lejuar	E lejuar	E lejuar	E lejuar	E lejuar
1.3 Donacione nga persona fizikë	E paspecifikuar	E paspecifikuar	E lejuar	E lejuar: jo më shumë se 1,000,000 lekë për person	E lejuar: jo më shumë se 1,000, 000 për person
1.4 Donacione nga persona juridikë	E paspecifikuar	E paspecifikuar	E lejuar	E lejuar: jo më shumë se 1,000,000 lekë për person	E lejuar: jo më shumë se 1,000,000 lekë për person.
1.5 Donacione nga institucione	E ndaluar	E ndaluar	E ndaluar	E ndaluar	E ndaluar

²¹ Format i tabelës është marrë nga Gherghina & Chiru, 2013.

²² Ligji Nr. 7502, datë 25.7.1991 “Për Partitë Politike” parë në Qendra e Botimeve Zyrtare më 13 tetor 2013, parë në: <http://qzb.gov.al:81/doc.jsp?doc=docs/Ligj%20Nr%207502%20Dat%C3%AB%2025-07-1991.htm>

²³ Ligj Nr.7818, date 21.04.1994 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7502, datë 25.7.1991 “Për partitë Politike”, ndryshuar me ligjin nr.7591, date 16.7.1992, parë më 13 tetor 2013, parë në Qendra e Botimeve Zyrtare: <http://qzb.gov.al:81doc.jsp?doc=docs/Ligj%20Nr%207818%20Dat%c3%AB%2021-04-1994.htm>

²⁴ Ligji Nr.8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, parë në Qendra e Botimeve Zyrtare [www.qzb.gov.al:81/doc.jsp?docs/Ligj Nr 8580 Datw 17-02--2000.htm](http://www.qzb.gov.al:81/doc.jsp?docs/Ligj%20Nr%208580%20Dat%2017-02-2000.htm)

²⁵ Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Parë në Qendra e Botimeve Zyrtare në: <http://qzb.gov.al:81.doc.jsp?doc=docs/Ligj%20Nr%2010019%20Dat%C3%AB%2029-12-2008.htm>

²⁶ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Miratuar me ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 dhe ndryshuar me ligjin nr. 74.2012, datë 19.07.2012), parë në Komisioni Qendror i Zgjedhjeve: [www.cec.org.al/images/stories/ElectoralCode2012\(alb\).pdf](http://www.cec.org.al/images/stories/ElectoralCode2012(alb).pdf)

Komponentët kyç	Ligji 7502 (25.07.1991) ²²	Ligji 7591 (21.04.1994) ²³	Ligji 8580 (17.02.2000) ²⁴	Ligj 10019 (29.12.2008) ²⁵	Ligji 74/12 (19.07.2012) ²⁶
publike					
1.6 Donacione Anonime	E paspecifikuar	E paspecifikuar	E paspecifikuar	E paspecifikuar	E paspecifikuar
1.7 Donacione të Huaja	- E ndaluar për entet publike të huaja. - E lejuar për parti ose bashkime partish në një masë jo më të madhe se buxheti i shtetit.	- E lejuar për parti ose bashkime partish deri në masën që nuk kalon ndihmën maksimale vjetore të dhënë nga shteti për secilën parti	E ndaluar për qeveri dhe ente publike ose private të huaja dhe e lejuar për parti ose bashkime partish, organizata dhe fondacione politike.	E ndaluar	E ndaluar
2. Financim nga Fonde Publike					
2.1 Shuma Totale	Buxheti i Shtetit	Buxheti i Shtetit	Jepet por e paspecifikuar	I paspecifikuar	I paspecifikuar
2.2 Metoda e Alokimit	- Fushatë elektorale dhe veprimtari vjetore e partive. - 10% e buxhetit të shtetit për partitë politike ndahet në mënyrë të	- Fushatë elektorale dhe veprimtari vjetore e partiak. - Në momentin e krijimit - 10% e buxhetit të shtetit për partitë politike	- Vetëm për veprimtarinë vjetore: 70 % e ndihmës shtetërorë në përputhje me votat e fituara, pavarësisht nëse ka vend në Kuvend; 20% në mënyrë të barabartë mes partish që kanë grup parlamentar; 10% në mënyrë të barabartë mes partish që kanë marrë pjesë në dy zgjedhjet e	- Për veprimtarinë vjetore mbetet në fuqi i njëjti ligj si më parë. - Në fushatë elektorale: 50% e shumës ndahet proporcionalisht me numrin e mandateve ndërmjet partive që kanë mandate në	- Për veprimtarinë vjetore mbetet në fuqi i njëjti ligj si më parë. - Në fushatë elektorale: 95% të shumës e fitojnë partitë politike që kanë marrë jo më pak se

Komponentët kyç	Ligji 7502 (25.07.1991) ²²	Ligji 7591 (21.04.1994) ²³	Ligji 8580 (17.02.2000) ²⁴	Ligji 10019 (29.12.2008) ²⁵	Ligji 74/12 (19.07.2012) ²⁶
	<p>barabartë ndërmjet partive që kanë jo më pak se 5,000 anëtarë. Pjesa tjetër ndahet në përpjestim me numrin e votave të marra në zgjedhjet e fundit ku nuk fitojnë ato parti që kanë marrë më pak se 2%.</p> <p>- Në momentin e krijimit të numrit të anëtarëve dhe shtrirjes territoriale.</p> <p>-Ndhima financiare jo më shumë se 2% e buxhetit vjetor të caktuar për financimin e partive</p>	<p>që kanë mbi 5 mijë anëtarë. 30% në mënyrë të barabartë ndërmjet partive që kanë grupe parlamentare dhe 60% në përpjestim me numrin e votave ndërmjet partive që kanë marrë jo më pak se 2% të votave.</p>	<p>fundit parlamentare me lista kombëtare.</p> <p>- E pa specifikuar për fushatën elektorale</p>	<p>Kuvend.</p> <p>- 50% ndahet midis partive që kanë jo më pak se 2 mandate në kuvend në proporcion me mandatet e marra.</p> <p>- Në rast mospajtimi mandatesh në zgjedhjet aktuale, partitë që kanë fituar fonde duhet t'i kthejnë mbrapsht.</p>	<p>0.5% të votave në shkallë vendi në zgjedhjet pararendëse në proporcion me votat e marra. 5% e përfitojnë partitë politike që janë regjistruar si subjekte zgjedhore. Në përfundim të zgjedhjeve bëhet rillogaritja dhe partië politike duhet të kthejnë ose të marrin më shumë fonde në varësi të rezultatit të dalë sipas të njëjtës formulë të mësipërme.</p>

Komponentët kyç	Ligji 7502 (25.07.1991) ²²	Ligji 7591 (21.04.1994) ²³	Ligji 8580 (17.02.2000) ²⁴	Ligji 10019 (29.12.2008) ²⁵	Ligji 74/12 (19.07.2012) ²⁶
	politike.				
3. Financim Indirekt					
3.1 Akses pa pagesë në median publike	E garantuar	E garantuar	E garantuar	E garantuar	E garantuar
3.2 Mënyra e Alokimit	E paspecifikuar	E paspecifikuar	E paspecifikuar	30 min. në TV publike dhe 30 min. në radion publike për partitë parlamentare që kanë marrë më shumë se 20% të vendeve në kuvend, dhe 15 minuta në TV publik dhe 15 min në radion publike për partitë e tjera parlamentare. Për partitë jashtëparlamentare jepen 10 min. në TV publik dhe 10 min në radion publike.	30 min. në TV publike dhe 30 min. në radion publike për partitë parlamentare që kanë marrë më shumë se 20% të vendeve në kuvend, dhe 15 minuta në TV publik dhe 15 min në radion publike për partitë e tjera parlamentare. Për partitë jashtëparlamentare jepen 10 min. në TV publik dhe 10 min në radion

Komponentët kyç	Ligji 7502 (25.07.1991) ²²	Ligji 7591 (21.04.1994) ²³	Ligji 8580 (17.02.2000) ²⁴	Ligj 10019 (29.12.2008) ²⁵	Ligji 74/12 (19.07.2012) ²⁶
					publike.
3.3 Paisja me Zyra	E paspecifikuar	E pa sepcifikuar	E garantuar për partitë parlamentare.	E garantuar për partitë parlamentare.	E garantuar për partitë parlamentare
4. Rregullat e Transparencës					
4.1 Raportet Financiare	E detyruar	E detyruar	E detyruar : Për subvencionet/donacionet publike dhe private	E detyruar : Për subvencionet/donacionet publike dhe private	Për subvencionet, donacionet publike dhe private.
5. Autoriteti Kontrollues	Kuvendi Popullor	Kuvendi Popullor	Kontrolli i Lartë i Shtetit	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
6. Sanksione	E paspecifikuar	E paspecifikuar	Detyrimet ndaj shtetit (gjoba, gjyqe të humbura, fatura konsumi etj.) në rast mospagese, mbahen nga buxheti shtetëror vjetor.	- Detyrimet ndaj shtetit (gjoba, gjyqe të humbura, fatura konsumi etj.) në rast mospagese, mbahen nga buxheti shtetëror vjetor. - Sanksione për mos respektim të rregullave të vendosura nga KQZ.	- Detyrimet ndaj shtetit (gjoba, gjyqe të humbura, fatura konsumi etj.) në rast mospagese, mbahen nga buxheti shtetëror vjetor. - Sanksione për rregulla të mosvendosura nga KQZ.

Financimi i drejtpërdrejtë i shtetit ndaj partive politike konsiston në dy elementë: subvencion vjetor për aktivitetet rutinë të partisë dhe subvencion për shpenzimet elektorale. Përveç këtyre partitë përfitojnë edhe ndihma në natyrë dhe financime indirekte si për shembull, minutazh falas në televizionin dhe radion publike.

Lloji i parë i subvencionit ka të bëjë me paratë që partitë marrin nga shteti në mënyrë që të mbulojnë shpenzimet e aktiviteteve vjetore. Kjo është një shumë fikse, e përlllogaritur rast pas rasti, e cila jo domosdoshmërisht duhet shpenzuar e gjitha brenda vitit dhe nuk ndahet sipas linjave buxhetore (*lump sum*). Ajo përdoret për të mirëmbajtur organizatën partiake, për të paguar stafin si dhe për të financuar aktivitetet jashtëparlamentare. Ndërsa lloji i dytë i financimit shtetëror ka të bëjë me subvencionet që partitë marrin për shpenzimet e fushatave elektorale. Në këtë punim në analizë janë marrë financimi për aktivitetin vjetor dhe për zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale.

Financimi publik i partive politike në Shqipëri është i orientuar drejt partisë dhe jo drejt kandidatit dhe në këtë kontekst ngjan me traditën e vendeve të Evropës Perëndimore ku partitë politike financohen publikisht. Kështu ligji nr.7502, datë 25.07.1991 specifikon se ‘Shteti ndihmon gjithashtu materialisht partitë politike në kohën e krijimit të tyre’ (neni 19). Masa e ndihmës financiare fillestare shtetërore përcaktohej nga Këshilli i Ministrave mbi bazën e numrit të anëtarëve dhe shtrirjes territorial. Kjo ndihmë ishte jo më shumë se 2 për qind e buxhetit shtetëror vjetor të caktuar për financimin e partive (neni 20). Ndërsa pjesa e ndihmave për aktivitetin vjetor sipas nenit 21 të të njëjtit ligj ‘Dhjetë për qind e [ndihmave vjetore financiare shtetërore] ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet partive politike që kanë jo më pak se 5,000 anëtarë. Pjesa tjetër ndahet në përpjestim me numrin e votave të marra në zgjedhjet e fundit. Nga kjo shpërndarje nuk përfitojnë ato parti që kanë

marrë më pak se 2 përqind të votave'. Skema e financimi ndryshoi sërisht në vitin 1992 ku sipas ligjit nr.7591, datë 16.07.1992 'Dhjetë për qind e [ndihmave financiare nga buxheti i shtetit] ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet partive politike që kanë mbi 5 mijë anëtarë... . Tridhjetë për qind e këtyre ndihmave ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet partive që në zgjedhjet parlamentare kanë fituar të drejtën të kenë grupe parlamentare, kurse pjesa tjetër ndahet në përpjestim me numrin e votave ndërmjet partive që kanë jo më pak se dy për qind të votave" (neni 21). Ligji mbi financimin e partive politike ndryshoi sërisht në vitin 2000, ligji nr.8580, datë 17.2.2000 ku sipas nenit 19 parashikohej që për veprimtarinë vjetore të partive politike, 70 % e ndihmës shtetërore të ndahej në përputhje me votat e fituara, pavarësisht nëse ka vend në Kuvend; 20% në mënyrë të barabartë mes partish që kanë grup parlamentar; 10% në mënyrë të barabartë mes partish që kanë marrë pjesë në dy zgjedhjet e fundit parlamentare me lista kombëtare.

Pra siç shihet financimi i partive politike është tërësisht i orientuar dhe në varësi të performancës elektorale të partisë. Ndërsa fillimisht ishte në varësi të numrit të anëtarëve dhe shtrirjes territoriale, gjë që është e kuptueshme duke patur parasysh se partitë politike nuk kishin një historik të tyrin elektorale, duke qenë se u krijuan vetëm në periudhën 1990-1991, më vonë favorizoi partitë me performancën më të mirë elektorale. Sigurisht që kjo u kthye në një rreth vicioz ku partitë që performojnë më mirë marrin më shumë dhe duke qenë se kanë më shumë fonde për të mirëmbajtur rrjetin organizativ dhe për të organizuar aktivitete partiake, arrijnë të kenë sërisht rezultate më të mira zgjedhore sesa partitë e vogla apo ato që hyjnë për herë të parë në politikë.

Kjo formë sponsorizimi dallon nga ajo që partitë politike marrin nga të mbuluar shpenzimet e fushatës elektorale. Sasia e fondit të alokuar përgjithësisht është sërisht në

varësi të rezultateve të fushatës pararendëse por, në fund të përfundimit të procesit zgjedhor, atëherë kur del rezultati përfundimtar i zgjedhjeve bëhet sërish kalkulimi i fondit që do duhej të merrnin partitë politike dhe në varësi të rezultatit të marrë një pjesë e partive mund të kthejë fonde në buxhetin e shtetit (në rast se ka marrë më tepër) ose mund të marrë fonde të tjera në rast se ka marrë më pak, sipas kalkulimeve të bëra me rezultatet e zgjedhjeve të fundit. Ashtu si për fondet publike për të mbështetur aktivitetet vjetore të partisë, edhe fondet publike për fushatën elektorale janë të orientuara drejt performancës elektorale të partisë dhe në këtë mënyrë përfitojnë më së shumti partitë e mëdhaja pa u dhënë mundësi partive të vogla apo të sapokrijuara të gjejnë fonde për t'u zhvilluar në terma organizacional dhe të bëjnë fushata elektorale të suksesshme. Financimi i aktivitetit elektorale i është njohur partive politike që në fazat e para të krijimit të tyre, vetëm se deri në vitin 2000 nuk ishte specifikuar se si do të kryhej ndarja e fondit shtetëror ndërmjet partive politike. Ky financim është njohur në të njëjtën kohë me financimin e aktivitetit vjetor, kjo edhe për vetë faktin se zgjedhjet e para pluraliste në Shqipëri janë mbajtur në mars 1991, vetëm 4 muaj pas krijimit të Partisë Demokratike, që është edhe partia e parë opozitare e krijuar në Shqipëri.

Ligji për financimin e aktivitetit vjetor të partive politike ka ndryshuar vazhdimisht. Fillimisht ka pasur një lloj orientimi jo vetëm drejt numrit të votave që një parti fitonte por edhe drejt numrit të anëtarësisë. Kështu ligji 7502 (25.07.1991) specifikonte se buxheti i shtetit për aktivitetet vjetore të partisë ndahej sipas skemës: 10% në mënyrë të barabartë ndërmjet partive që kanë jo më pak se pesë mijë anëtarë, ndërsa pjesa tjetër ndahej në përpjestim me numrin e votave të marra midis partive që në zgjedhje kanë marrë jo më pak se 2% të votave në nivel kombëtar. Ligji ndryshoi më pas (ligji 7591, 21.04.1994) ku

sërisht 10% e buxhetit të shtetit të alokuar për partitë politike ndahej ndërmjet partive që kishin jo më pak se 5,000 anëtarë, por pjesa tjetër e ndarjes ndryshonte. Konkretisht, 30% e këtij buxheti ndahej në mënyrë të barabartë ndërmjet partive që kishin grupe parlamentare dhe 60% në përpjestim të drejtë me numrin e votave të marra ndërmjet partive që kishin marrë jo më pak se 2% të votave në rang vendi. Siç mund të shihet kemi një zhvendosje të vëmendjes së shtetit prej partisë si organizatë drejt asaj si performuese elektorale. Konkretisht, ligji i vitit 1991, ndihmonte më shumë partitë që përpiqeshin të kishin një lloj shtrirjeje organizative në vend dhe nuk e vinte si kusht pjesmarrjen e tyre parlamentare për të dhënë ndihmën financiare. Ndërsa ligji i vitit 1994, favorizonte më së shumti partitë parlamentare. Po të kihet parasysh se numri kryesor i vendeve në parlament zihej përmes votimit maxhoritar, ishte e qartë që më shumë rëndësi (midis vitit 1992 dhe 2005, sistemi zgjedhor ka qenë miks, ku për 100 vende në parlament konkurohej sipas sistemit maxhoritar dhe për 40 vende sipas sistemit proporcional) i jepej individëve të veçantë të partisë se sa organizatës në tërësi.

Ligji nr.8580 (17.02.2000) e hoqi tërësisht elementin e shpërndarjes së buxhetit të shtetit në varësi të anëtarësisë. Tashmë 70% e buxhetit të shtetit ndahej në përpjestim të drejtë me votat e fituara, 20% ndahej në mënyrë të barabartë ndërmjet partive parlamentare dhe 10% në mënyrë të barabartë ndërmjet partive që konkuronin në zgjedhje me lista kombëtare. Edhe ky ligj favorizonte kryesisht partitë që kishin performancën më të mirë elektorale si edhe partitë e mëdha duke qenë se ato ishin të vetmet që mund të prezantoheshin me lista kombëtare. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është se ligji, në të gjitha etapat e tij nuk specifikon se si përlllogaritej buxheti i shtetit në lidhje me aktivitetin vjetor të partive politike. Ligji tregon se si shpërndahet ky buxhet, por se sa do të jetë

shuma e tij vjetore mbetet e paspecifikuar. Kjo sigurisht që i siguron qeverisë një pushtet të jashtëzakonshëm për të përcaktuar subvencionet publike, duke bërë që në vite të caktuara, p.sh. në raste fushatash elektorale të rrisë buxhetin vjetor, gjë nga e cila kryesisht përfiton partia në pushtet.

Si përfundim mund të konkludohet në atë që thotë edhe van Biezen se “një sistem i cili jep shuma fikse është më i favorshëm për partitë e vogla, sepse në këtë rast ato marrin një shumë më të madhe parash se sa në rastin ku mbështetja financiare kryhet në përputhje me mbështetjen elektorale të partive. Përkundër, sistemet që i shpërndajnë subvencionet financiare shtetërore mbi bazën e proporcionalitetit, favorizojnë kryesisht partitë e mëdha” (2004: 709). *Andaj edhe ne mund të themi se kuadri ligjor i miratuar në Shqipëri favorizon partitë e mëdha të orientuara drejt elektoratit dhe jo organizatës bazë.*

5.4 Kufizimet, Transparenca dhe Kontrolli

Pas skicimit të kuadrit ligjor mbi financimin e partive politike dhe përpara se të vazhdoj me analizën e praktikave të financimit të partive politike në Shqipëri, në këtë seksion diskutohet mbi sistemin e kontrollit publik të financave, duke përfshirë këtu edhe kufizimet dhe ndalesat mbi donacionet dhe shpenzimet, sikurse edhe sistemin e deklarimit të të ardhurave dhe shpenzimeve si edhe detyrimin ligjor për ta bërë këtë.

Në Shqipëri ekziston kuadri ligjor që siguron kontrollin publik mbi praktikën e financimit të partive politike. Ky kuadër ligjor përfshin një seri rregullimesh mbi kufizimet dhe ndalesat mbi sasinë dhe llojin e kontributeve të lejueshme, mekanizmat e raportimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, sikurse edhe mbi metodat ligjore për zbatimin e këtij kuadri ligjor. Në të njëjtën kohë, megjithatë, partitë politike konsiderohen shoqëri private dhe

funksionimi i tyre i brendshëm dhe struktura organizacionale mbeten jashtë fokusit të ligjit. Dispozitat ligjore mbi financimin e tyre, kërkesa për raportim dhe kufizimet dhe ndalesat mbi disa lloje të ardhurash dhe shpenzimesh në një farë mënyre minojnë statusin e tyre autonom dhe privat. Megjithatë, ky konceptualizim konfliktual mbi publikën dhe privaten në partitë politike, ka prodhuar një lloj tensioni ndërmejt kërkesave ligjore dhe paraktikës aktuale politike, duke rezultuar në regjime financiare politike që ofrojnë një regjim strikt edhe pse shpesh jo konseguent të kontrollit publike të financave të partive.

Në mënyrë që të monitorohet influenca e padëshiruar e parave mbi financën politike, kontrolli publik i financave të partive përfshin kufizime dhe ndalesa ndaj disa lloje donacionesh dhe shpenzimesh. Në këtë kuptim, Shqipëria ka ndjekur rrugën e demokracive perëndimore që është e shpjegueshme për shkak të ndikimit të organizmave ndërkombëtare dhe anëtarësimit të partive politike shqiptare në organizatat ndërkombëtare partiake të djathta ose të majta. Kështu në të gjitha fazat e tij, pavarësisht ndryshimeve të bëra nga viti 1991 dhe deri në vitin 2012, ligji ndalon donacione nga ente publike ose gjysem-publike. Ndërkaq në lidhje me llojet e tjera të donacioneve ligji ka ndryshuar herë pas here. Kështu ligji 7502 (25.07.1991) dhe ligji 7591 (21.04.1994) nuk ka specifikuar ndonjë rregullesë në lidhje me donacionet e personave fizike apo juridikë shqiptarë. Ndërkaq ligji 8580 (17.02.2000) i lejon këto donacione pa specifikuar se si dhe në çfarë shume mund të jepen. Vetëm me ligjin 10019 (29.12.2008) që vazhdon të jetë i vlefshëm specifikohet se personat shqiptarë juridikë dhe fizikë mund të japin donacione deri në 1,000,000 lekë dhe donacioni i tyre deklarohet edhe në raportet financiare të partive politike.

Në lidhje me donacionet e huaja, fillimisht ligji 7502 i ndalonte donacionet nga entet e huaja publike, por pa specifikuar nëse partitë mund të përfitonin nga burime të tjera.

Në periudhën që rregullohet përmes ligjeve 7591 (1994) dhe 8580 (2000) u lejuan financime nga parti ose bashkime partish deri në masën që nuk e kalonin ndihmën maksimale vjetore të dhënë nga shteti për secilën parti. Kjo situatë zgjati deri në vitin 2008, ku me ligjin 10019 (29.12.2008) u bë tërësisht i ndaluar çdo lloj financimi i huaj.

Siç mund të shihet, legjislacioni shqiptar ka zvogëluar ndjeshëm numrin e burimeve financiare të partive politike duke vendosur tavan për subvencionet e brendshme dhe ndalesë totale për subvencionet e jashtme edhe kur këto mund të vinin nga organizata ndërkombatare degë e të cilave mund të ishin partitë politike shqiptare.

Ashtu sikurse nuk përcakton një kufi në lidhje me fondin që një parti duhet të përdorë për aktivitetin e saj vjetor ose gjatë fushatës elektorale, po ashtu legjislacioni nuk parashikon ndonjë kufi në lidhje me shpenzimet që mund të kryejnë partitë politike për të çuar para aktivitetin e tyre vjetor apo elektorale. Në fakt raportet financiare të partive tregojnë se partitë politike kanë shpenzuar gjatë fushatave elektorale më shumë edhe se sa buxheti që aktualisht kanë grumbulluar.

Në fakt ashtu sikurse edhe në demokracitë e vjetra apo në vendet e tjera postkomuniste, financimi i partive politike është ndoshta aspekti më pak transparent i aktivitetit partiak. Po të kihet parasysh se raportet financiare të partive politike filluan të bëhen publike për herë të parë në vitin 2009, mbetet një kohë shumë e gjatë, 1991-2009 e paraportuar. Po kështu, megjithëse dispozitat ligjore në lidhje me ndalesat ndaj partive politike dhe obligimit që ato kanë për të raportuar, janë rritur në vitet e fundit, është e vështirë të garantohet vlefshmëria e të dhënave. Kjo ndodh për një sërë arsyesh. Nga njëra anë, partitë nuk janë të detyruara të deklarojnë donacionet me vlerë më të vogël se 1,000,000, që është një shumë shumë e madhe. Për pasojë të gjitha shumat nën 1,000,000,

megjithëse mund të jenë të mëdhaja, mbeten megjithatë të paidentifikuara. Po kështu, audituesit nuk kanë autoritet për të investiguar llogaritë partiake dhe për të shkuar përtej informacionit që vetë partitë politike japin. Andaj edhe të dhënat duhet të konsiderohen me kujdes. Megjithatë, pavarësisht limitimit të të dhënave, mund të nxirren disa konkluzione në lidhje me praktikën e financimit partiak, veçanërisht përsa i përket varësisë së partive ndaj fondeve publike, rolit të shoqërisë në financat e partive politike sikurse edhe mund të shihet se deri në ç' masë partitë përdorin fondet e tyre kryesisht për arsye elektorale dhe jo për qëllime organizative.

5.5 Ndikimi i fondeve publike mbi partitë politike

Literatura bashkëkohore mbi partitë politike në perëndim dhe vendet e Evropës post-komuniste tregon se fondet publike dhe kryesisht buxheti shtetëror përbëjnë një përqindje të konsiderueshme, në mos pjesën më të madhe të fondit për aktivitetin vjetor dhe fushatën elektorale të partive politike. Debati tashmë është diskutuar gjerësisht në pjesën e parë të këtij kapitulli, megjithatë shkurtimisht mund të thuhet se sipas Katz & Mair (1995) afrimi me shtetin bën që partitë politike t'i largohen gjithmonë e më tepër masave sepse tashmë ato nuk janë të domosdoshme si përsa i përket kapitalit njerëzor ashtu edhe përsa i përket kapitalit human. Van Biezen (2003) argumenton se ndikimi i fondeve publike është akoma më i madh për partitë politike në vendet post-komuniste për shkak se ato iu dhanë partive politike që në fazat e hershme të formimit të tyre, në kohën kur ato përgjithësisht nuk i kishin burimet organizacionale për të gjeneruar të ardhura të tjera. Mbetet për të parë nëse fondet publike luajnë ose jo një rol kaq të rëndësishëm në partitë politike shqiptare sa të realizojnë zhvendosjen e tyre prej shoqërisë drejt shtetit.

Partitë e marra në shqyrtim janë Partia Socialiste, Partia Demokratike, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Republikane. Në përzgjedhjen e partive të marra në shqyrtim janë marrë parasysh dy aspekte. Së pari, janë përzgjedhur partitë kryesore dhe relevante (shih Kapitulli 2). Aspekti i dytë ka të bëjë me programin partiak të partisë. Të katra partitë, pavarësisht rezultatit të marrë kanë targetuar të gjithë elektoratin dhe kanë vënë kandidatura në të gjithë Shqipërinë. Ndërkaq partitë e tjera parlamentare si PBDNJ apo PDIU e kanë të kufizuar elektoratin e përkatësisë: njëra është e përqendruar në të drejtat e komunitetit grek në Shqipëri dhe tjetra në të drejtat e komunitetit çam. Edhe pse PDIU mbron të drejtat e komunitetit çam që është një komunitet shqiptar, ajo sërisht për nga forma e lobimit është më tepër e ngjashme me një parti etnike sesa një parti masash që ka shtrirje territoriale në të gjithë vendin. Andaj për to nuk mund të shtrohet në diskutim pyetja nëse janë parti masash apo kartel.

Në analizën e kryer janë hasur disa vështirësi në grumbullimin e të dhënave. Informacioni i nevojshëm për të arritur në një konkluzion kishte të bënte me buxhetin total të partisë në një vit të caktuar, ose në fushatë elektorale, me sasinë e fondeve publike të përfituara nga partia, me sasinë e të ardhurave nga kuotat e anëtarësisë, sasinë e sponsorizimeve të jashtme apo edhe me sasinë e sponsorizimeve mediatike të përfituara nga partitë politike. Megjithatë jo gjithmonë ka qenë e mundur të gjenden këto të dhëna. Vështirësia këtu është e lidhur me dy faktorë. Së pari partitë politike nuk kanë raportuar në lidhje me financat e tyre tek Komisioni Qendror i Zgjedhjeve deri në vitin 2009, edhe pse legjislacioni e kërkonte një gjë të tillë. Kjo mungesë informacioni e dëmton analizën e partive politike sepse nuk tregon të dhëna për një sërë zgjedhjesh, për zgjedhjet e menjëherëshme pas komunizmit (pra mungon informacioni në momentin kyç të rënies së

komunizmit, moment ky deciziv për ecurinë e mëtejshme të partive politike). Analiza e burimeve financiare të partive politike përfshin periudhën 2009-2013 ku janë analizuar zgjedhjet e përgjithshme 2009, 2013; zgjedhjet për pushtetin vendor 2011, si edhe aktiviteti vjetor financiar në vitet 2012 dhe 2013.

Faktori i dytë ka të bëjë me mënyrën e raportimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të partive politike. Është vënë re se raportet e hartuara nga audituesit nuk kanë një strukturë të njëjtë raportimi, andaj është bërë përpjekje për të unifikuar kategoritë që tregojnë se nga vijnë fondet e partive politike si për fushatën elektorale ashtu edhe për aktivitetin e tyre vjetor. Në kolonën “Fonde Publike” janë vendosur fondet që shteti i ka dhënë partisë për fushatën elektorale si edhe ajo pjesë e buxhetit vjetor shtetëror që partia e merr për të kryer aktivitetin e saj vjetor. Në rastet kur kjo shumë është specifikuar në raportin e auditimit shifra e vendosur ka qenë e saktë. Por ka patur raste që partia nuk ka deklaruar se sa ka qenë buxheti shtetëror vjetor dhe ç’pjesë të këtij buxheti ka përdorur për të përballuar fushatën elektorale. Në këtë rast është bërë një përlllogaritje e përafërt duke parë se sa ka qenë buxheti në vitin paraardhës apo pasardhës dhe se si është përdorur ky buxhet kur ka qenë vit elektorale (Rasti i PD në vitin 2009). Megjithëse shifra mund të mos jetë tërësisht e saktë, është gjykyar se ajo është afër të vërtetës dhe jep një panoramë më të plotë mbi peshën e fondeve publike në fondin e përgjithshëm të të ardhurave të partisë.

Problemi tjetër i hasur me analizën ka të bëjë me kategorinë “Përfitim nga reklama televizive”. Sipas Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë “Për zgjedhjet në Kuvend radiot dhe televizionet private kombëtare dhe satelitore, të cilat pranojnë reklama me pagesë, sipas këtij neni, detyrohen që gjysmën e kohës totale të reklamës së parashikuar në pikën 5 të këtij neni t’ua vënë në dispozicion falas subjekteve zgjedhore” (Neni 84/6,

29.12.2008 dhe Neni 84/6, 19.07.2012). Në këtë kontekst vetëm subjekti Lëvizja Socialiste për Integrim e ka bërë të ditur përfitimin nga reklama, ndërsa subjektet e tjera nuk e kanë bërë këtë gjë edhe pse sipas legjislacionit ato duhet të kenë përfituar në të njëjtën mënyrë. Prej kësaj rrjedh problemi që duke vendosur këtë linjë sponsorizimi, partia LSI ul peshën e fondit shtetëror në financimin e përgjithshëm të partisë. Megjithatë në analizën tonë edhe pse reklamat televizive janë dhënë më vetë ato konsiderohen si një ndihmë indirekte e shtetit i cili e mundëson këtë përmes legjislacionit të miratuar.

Në Tabelat e mëposhtme jepet pasqyra e të ardhurave të partive politike si për aktivitetin vjetor ashtu edhe për fushatat elektorale të përgjithshme dhe locale për periudhën 2009-2013.

Tabela 17 : Pasqyra e të Ardhurave të Partive Politike në Fushatën Elektorale 2009²⁷:

N r.	Subjekti Politik	Fonde Publike (Buxheti i Shtetit) (Lekë)	Fondet Jo Publike (Lekë)	Të ardhura nga Anëtarësi a (Lekë)	Përfitim nga reklama televizive (Lekë)	Të tjera (Lekë)	Total (Lekë)
1.	Partia Socialiste	86,752,304 ²⁸ (92.68%)	6,855,136 ²⁹ (7.32%)				93,607,440

²⁷ Të dhënat janë marrë nga Raportet e Auditimit për Subjektet Zgjedhore në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve: <http://www.cec.org.al/sq-al/PE2009-PartiesFinancing/aid/843>

²⁸ Përbëhet nga buxheti i shtetit për fushatën elektorale 2009 i cili konsiston në 13,693,204 leke dhe 73,059,100 leke i cili në raport figuron si fond i vetë partisë. Është vendosur në linjën e buxhetit të shtetit sepse partia nuk ka të ardhura përveç sponsorizimeve për fushatën dhe kuotave të anëtarësisë. Sponsorizimit janë paraqitur tashmë në një kollonë më vetë, ndërsa kuotat nuk kanë patur asnjëherë ndonjë vlerë të rëndësishme. Po kështu duke u nisur nga zgjedhjet e mëpasme ku PS ka marrë 80,677,253 leke si fond të buxhetit të shtetit për aktivitetet vjetore në 2011 dhe 72,787,063 leke në 2013 mendohet, se edhe në 2009 fondi i buxheti të shtetit për aktivitetin vjetor të partisë është rreth 73,059,100 leke. Fondi jepet me përafërsi

2.	Partia Demokratike	66,828,896 ³⁰ (44.49%)	79,856,841 ³¹ (53.16%)	3,533,700 (2.35%)		32	150,219,437
3.	Partia LSI	4,590,660 ³³ (40.27%)	2,137,000 ³⁴ (18.74%)		4,673,073 (40.99%)		11,400,733
4.	Partia Republika ne	10,695,140 ³⁵ (95.53%)	500,000 ³⁶ (4.47%)				11,195,140

Tabela 18: Pasqyra e të Ardhurave të Partive Politike në Fushatën Elektorale 2011³⁷

N r.	Subjekti Politik	Fonde Publike (Buxheti i Shtetit) (Lekë)	Fondet Jo Publike (Lekë)	Të ardhura nga Anëtarësi a (Lekë)	Përfitim nga reklama televizive (Lekë)	Të tjera (Lekë)	Total (Lekë)
1.	Partia Socialiste	105,016,107 ³⁸ (96,42%)	3,900,000 ³⁹ (3.58%)				108,916,106

sepse në raport nuk ka të dhëna specifike, megjithatë marzhi i gabimit konsiderohet të jetë i vogël dhe nuk dëmton vlerën e studimit.

²⁹ Sponsorizime për fushatën nga persona fizikë ose juridikë.

³⁰ Buxheti i Shtetit për Partinë Demokratike për fushatën elektorale 2009 është 16,573,342 leke ndërsa shuma prej 50,255,554 leke figuron si fond i vetë partisë. Është llogaritur në kolonën buxheti i shtetit sepse është menduar se shuma ose pjesa më e madhe e saj është fondi i shtetit për aktivitetin vjetor të partisë dhe është bërë i njëjti gjykim si në rastin më sipër të Partisë Socialiste.

³¹ Sponsorizime për fushatën elektorale nga persona fizikë dhe juridikë.

³² Fonde të vetë partisë: e paspecifikuar se nga vijnë këto burime.

³³ Buxheti i Shtetit për fushatën elektorale 2009.

³⁴ Sponsorizime për fushatën nga persona juridikë dhe fizikë.

³⁵ Buxheti i Shtetit për fushatën elektorale 2009.

³⁶ Sponsorizime nga persona juridikë dhe fizikë.

³⁷ Të dhënat janë marrë nga Raportet e Auditimit për Subjektet Zgjedhore në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve: <http://www.cec.org.al/sq-al/LE2011-SubjectsFinancing/aid/135>

³⁸ Këtu është llogaritur fondi për fushatën elektorale akorduar nga Buxheti i shtetit i cili është 30,547,726 Lekë dhe fondi prej 74,468,380 Leke i cili në raportin e auditimit konsiderohet si fond i vetë partisë por që në të vërtetë është pjesë e financimit prej 80,677,253 leke që partia ka marrë si ndihmë për aktivitetin e saj vjetor prje Buxhetit të Shtetit dhe që e ka përdorur për fushatën elektorale.

2.	Partia Demokratike	111,669,250 ⁴⁰ (60.93%)	70,164,262 ⁴¹ (38.28%)	1,450,540 (0.79%)			183,284,052
3.	Partia LSI	2,763,848 (15.46%)	4,109,400 (22.98%)		11,008,740 (61.56%)		17,881,988
4.	Partia Republikan e	3,782,230 ⁴² (88.32%)	500,000 (11.68%)				4,282,230

Tabela 19: Pasqyra e të Ardhurave të Partive Politike në Fushatën Elektorale 2013⁴³

N r.	Subjekti Politik	Fonde Publike (Buxheti i Shtetit)	Fondet Jo Publike	Të ardhura nga Anëtarësi	Përfitim nga reklama televizive	Të tjera	Total
1.	Partia	33,045,566	42,208,650	3,100,000		1,724,325	80,078,54

³⁹ Fondi prej 3,900,000 është dhënë në formë donacioni nga 12 persona fizikë shqiptarë, kryesisht anëtarë të Partisë Socialiste.

⁴⁰ Ky fond është përlogaritur me afërsi dhe është i përbërë nga: 30,991,997 lekë që është financimi i buxhetit të shtetit për fushatën elektorale 2011 dhe 80,677,253 leke. Komponenti i fundit është përzgjedhur me përafërsi: në të vërtetë në raportin financiar figuron një shumë prej 99,080,050 lek si fonde të vetë Partisë, por duke deduktuar nga raportet e viteve 2012 dhe 2013 si edhe ato të Partisë Socialiste, kuptohet që përqindjen më të madhe në ato që quhen fondet e partisë e përbën buxheti i shtetit për aktivitetet vjetore të partisë. Raporti financiar për Partinë Demokratike për vitin 2011 mungon, megjithatë mund të deduktohet se financimi i shtetit për të është më i madh se ai i Partisë Socialiste duke qenë se buxheti i shtetit ndahet në mënyrë proporcionale me vendet që partitë kanë në parlament, dhe në vitin 2011, PD ka më tepër deputetë se Partia Socialiste. Duke qenë se ne nuk mund ta dimë me ekzaktësi se sa është ky buxhet, kemi konsideruar se PD ka marrë të paktën po aq sa edhe PS për vitin 2011, pra ka marrë 80,677,253 lekë (shifër që e gjejmë në raportin e auditimit të PS për vitin 2011).

⁴¹ Shuma 70,164,262 lekë është e përbërë nga 51,761,465 lekë që janë sponsorizime të partisë dhe shuma prej 18,402,797 lekë e përftuar prej zbritjes prej 80,677,253 leke së bërë nga fondi 99,080,050 lekë që në raport figuron si burime të partisë sipas arësytimit të mësipërm.

⁴² Kjo shumë është e përbërë nga fondi prej 232,143 lekë që PR ka marrë si ndihmë nga Buxheti i Shtetit për fushatën elektorale dhe fondit prej 3,550,087 lekë që janë pjesë vlerës prej 8,101,610 lekë që PR ka marrë prej Buxhetit të Shtetit për sponsorizimin e aktiviteteve të saj vjetore. Për efekt të studimit kjo vlerë nuk është llogaritur si fond i gjeneruar nga partia por si fond publik.

⁴³ Të dhënat janë marrë nga Raportet e Auditimit për Subjektet Zgjedhore në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve: <http://www.cec.org.al/sq-al/Zgjedhjet/Zgjedhjet-p%C3%ABr-Kuvend/Zgjedhjet-2013/Financimi-i-Subjekteve/Raportet-e-Auditimit>

	Socialiste	⁴⁴ (41.26%)	⁴⁵ (52.7%)	(3.87%)		⁴⁶	1
2.	Partia Demokratike	25,688,615 (27.18%)	63,338,130 (67%)	3,469,730 (3.67%)	0	2,003,820 ⁴⁷ (2.12%)	94,500,29 5
3	Lëvizja Socialiste Për Integrim	4,100,410 (16.19%)	1,270,489 (5%)	147,600 ⁴⁸ (0.58%)	15,470,156 ⁴⁹ (61.06%)	4,345,713 ⁵⁰ (17.15%)	25,334,36 8
4.	Partia Republika ne	7,578,576 ⁵¹ (89.91%)	850,000 (10.09%)				8,428,576

Tabela 20: Pasqyrimi i të ardhurave vjetore të Partive Politike në periudhën 2011 - 2013

Partia	2011 ⁵²				
	Buxheti i Shtetit (leke)	Kuotat e Deputetëve (leke)	Kuotat e anëtarësisë (leke)	Të tjera (leke)	Total (leke)
PS	80,677,253	3,702,000	0	6,904,893 ⁵³	91,284,146

⁴⁴ Buxheti i Shtetit përbëhet nga: 26,114,596 Leke si sponsorizim për fushatën elektorale dhe 6,930,970 leke si pjesë e buxhetit shtetëror për financimin vjetor të partive politike që për vitin 2013 ka qenë 72,787,063 lekë.

⁴⁵ Në raportin e auditimit për PS, shuma e fondeve jo publike është 45,308,650 leke, dhe këtu përfshihen edhe të ardhurat nga anëtarësia (3,100,000 leke) por për hir të studimit këtu i kemi vendosur të ndara.

⁴⁶ Gjendje në llogaritë e PS e trashëguar nga viti paraardhës.

⁴⁷ Të tjera ndahet në: 5,966 Lek nga interesa kreditore nga banka dhe 1,997,584 Lek nga gjendja në llogarinë bankare në momentin e fillimit të fushatës.

⁴⁸ Të ardhurat nga anëtarësia konsiderohen si Fonde Jo Publike por për efekt të studimit janë dhënë të ndara nga seksioni "Fonde Jo Publike"

⁴⁹ Pjesa më e madhe e përfitimit ka qenë nga TOP Channel 14,931,495 dhe pjesa tjetër nga Media Vizion sha.

⁵⁰ Në raportin e auditimit të LSI kjo rubrikë i korrespondon linjës: 1.5.2: Mjete Monetare gjendje në fillim në Bankë.

⁵¹ Fondi prej 7,656,021 lekë është akorduar nga Buxheti i Shtetit për aktivitetin vjetor të partisë, dhe është përdorur për fushatën elektorale. Ndërkaq, për fushatën elektorale janë akorduar nga Buxheti i Shtetit 1,346,157 Leke të cilat nuk janë derdhur megjithatë në llogarinë bankare të partisë.

⁵² Raportet vjetore të Partive politike, Faqja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve: <http://www.cec.org.al/sq-al/Publikimet/Raporte-Financiare/Raportet-vjetore-financiare-t%C3%AB-partive-politike/Raportet-vjetore-financiare-p%C3%ABr-vitin-2011>

	(88.4%)	(4%)		(7.6%)	
LSI	14,654,580 (58.7%)	0	0	10,291,351 (41.3%)	24,945,931
2012⁵⁴					
Partia Socialiste	75,283,434 (87.63%)	3,492,000	350,000 (0.41%)	6,789,000	85,914,434
Partia Demokratike	59,725,127 (91.52%)	2,900,000 (4.44%)		2,634,880 (4.04)	65,260,007
Partia LSI					
Partia Republikane	7,656,021 (100%)				7,656,021
2013⁵⁵					
Partia Socialiste	98,901,659 ⁵⁶ (62.24%)		55,117,019 ⁵⁷	4,873,576 ⁵⁸	158,892,254
Partia Demokratike	89,785,001 (95.43%)	4,275,000 (4.54%)		24,680	94,084,681
Partia LSI	14,295,923 (31.37%)		1,749,500 (3.84%)	29,525,835 ⁵⁹ (64.78%)	45,579,164 ⁶⁰

⁵³ Nga raporti vjetor i partisë socialiste figuron se 1,650,000 lekë janë nga donator të ndryshëm, 5,260,000 lekë janë të ardhura nga qera ambjenti, 23,328 lekë nga qera ambienti dhe 7,565 të tjera. Pavarësisht se në raportin vjetor është përfshirë edhe shuma prej 30,547,726 lekë fond i buxhetit të shtetit për fushatën elektorale si edhe donacioni prej 3,900,000 lekë për fushatën, këto nuk janë përfshirë në këtë linjë për shkak se janë përlllogaritur njëherë në tabelën e të ardhurave për fushatën elektorale, dhe nuk janë pjesë e aktivitetit vjetor rutinë të partisë.

⁵⁴ Raportet vjetore të partive politike për vitin 2012 në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve: <http://www.cec.org.al/sq-al/Publikimet/Raporte-Financiare/Raportet-vjetore-financiare-t%C3%AB-partive-politike/Raportet-vjetore-financiare-t%C3%AB-partive-politike-p%C3%ABr-vitin-2013>: <http://www.cec.org.al/sq-al/Publikimet/Raporte-Financiare/Raportet-vjetore-financiare-t%C3%AB-partive-politike/Raportet-vjetore-financiare-p%C3%ABr-vitin-2012>

⁵⁵ Raportet vjetore të partive politike në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve:

⁵⁶ Financimi i buxhetit të shtetit në shumën 98,901,659 leke i përbërë nga 26,114,596 leke për fushatën elektorale dhe 72,787,063 leke për aktivitetet vjetore.

⁵⁷ Fondi i partisë: 55,117,019 leke i përbërë nga kuota anëtarësimi 14,712,900 leke dhe sponsorizime për fushatën zgjedhore në shumën 40,404,119 leke.

⁵⁸ Të ardhura nga qeradheniet.

Nga analiza e të dhënave doli se në raportet e auditimit të partive politike, shteti është një faktor i rëndësishëm dhe shpesh luan edhe rolin kyç në financimin e partive politike të marra në shqyrtim. Kështu në rastin e Partisë Socialiste ai siguron 92.68% të të ardhurave në fushatën elektorale të vitit 2009, kundrejt 0% prej anëtarësisë. E njëjtat situatë përsëritet në zgjedhjet e vitit 2011, ku shteti është furnizuesi i 96.42% të të ardhurave për fushatën elektorale kundrejt, sërish, 0% nga anëtarësia. Edhe në raportin vjetor pesha e buxhetit të shtetit duket sikur bie në fushatën elektorale të 2013, ku ajo shkon në 41.26% dhe duke ja lënë vendin kryesor financimit prej personave fizikë dhe juridikë, që shkon në 52.7% të buxhetit të partisë për atë fushatë. Megjithatë duhet vënë re se buxheti i shtetit ka qenë në shuma të konsiderueshme dhe pak a shumë në të njëjtat vlera si edhe në vitet paraardhëse, vetëm se financimi prej personave fizikë dhe juridikë ka qenë në vlera shumë më të mëdha këtë vit se sa në vitet e tjera. Kjo në një farë mënyrë është një të njëjtën kohë indikator dhe faktor për rotacionin e qeverisë në 2013-ën nga PD tek PS. Megjithatë në vitin 2013, situatë ndryshon radikalisht dhe financuesi kryesor i PS është sërish shteti që kontribuon 62.24% të të ardhurave për aktivitetin vjetor të organizatës përkundrejt 9.23% të ardhura nga anëtarësia.

E njëjta situatë shfaqet edhe në rastin e Partisë Demokratike. Buxheti i shtetit ka qenë kontribuesi më i madh i të ardhurave në fushatën elektorale 2011, dhe në aktivitetin vjetor 2012 dhe 2013 duke zenë kështu përkatësisht 60.93%, 91.52% dhe 95.43%. Në vitin

⁵⁹ Të ardhura nga Mediat në vlerën 15,579,164 leke dhe 14,055,679 leke nga shoqëri, persona fizikë dhe juridikë.

⁶⁰ Për të marrë këtë shumë janë shtuar edhe 7,907 leke të ardhura nga interesat që nuk bien në asnjërën nga linjat e buxhetit të paraqitura në tabela dhe për shkak të peshës shumë të vogël që kanë nuk është parë e arësyeshme të paraqiten më vete.

2009 buxheti i shtetit ishte zeri i dytë më i rëndësishëm duke zënë 44.49% të fondeve totale për fushatën ku vëndin kryesor e zunë donacionet e personave fizikë dhe juridikë me 53.16% të tyre. Në fushatën elektorale 2013, buxheti i shtetit zë një vend shumë më të vogël se herët e tjera dhe konkretisht 27.18% të fondeve të fushatës. Megjithatë në rast se shpenzimet e fushatës shihen së bashku me shpenzimet vjetore të organizatës për vitin 2013 shikojmë së në tërësi buxheti i shtetit për vitin 2013 ka zënë 61.23% të fondeve totale për këtë vit elektorale. Pra sërisht ka zënë vëndin kryesor.

Megjithatë ajo që duhet thënë si për Partinë Socialiste ashtu edhe për Partinë Demokratikë, është që në raportet e auditimit mungojnë të ardhurat në formë shërbimi, që konsistojnë në kohën falas në televizionin dhe radion publike. Informacioni për to do të jepte një panoramë më të qartë të rolit që luajnë fondet publike mbi partitë politike.

Për Partinë Republikane buxheti i shtetit ka qenë më deciziv se për të gjitha partitë e tjera. A ka zënë shifra të konsiderueshme të fondeve totale të partisë duke filluar nga 88.32% në 2011, 89.91% në 2013, 95.53% në 2009 e deri në 100% në fondin e përgjithshëm të aktiviteteve vjetore në vitin 2012.

Për Partinë LSI duket sikur buxheti i shtetit nuk luan një rol aq deciziv sa për partitë e tjera. Ai ka qenë gjithmonë zeri i dytë më i rëndësishëm duke variuar nga 15.46% në fushatën elektorale të vitit 2011 e deri në 40.27% në fushatën elektorale të vitit 2009. Megjithatë e ka edhe kjo një shpjegim. LSI e ka të ndryshme formën e raportimit të burimit të fondeve. Ajo përfshin si të ardhur edhe kohën që i vihet në dispozicion nga media, gjë që partitë e tjera nuk e bëjnë. Në fakt të ardhurat nga media lëvizin midis shifrave 40.99% dhe 64.68% duke zënë gjithmonë vëndin e parë në financimin e partisë. Po të kihet parasysh edhe ky burim financimi prej medias vjen si pasojë e legjislacionit shtetëror që ua garanton

partive politike një burim të tillë, atëherë do të shikonim se fondet publike edhe në këtë rast janë burimi kryesor dhe pothuajse i vetëm i partisë.

Përveç rolit të rëndësishëm që luajnë fondet e shtetit në aktivitetet vjetore dhe fushatën elektorale të një partie, në analizën e bërë vihet re edhe një e përbashkët tjetër e partive politike: kontributi shumë i ulët i anëtarësisë. Për Partinë Republikane dhe LSI-në partia është inekzistente ose së paku nuk kontribuon aspak në formën e kuotave të anëtarësisë në buxhetin e partisë. Por edhe për Partinë Socialiste dhe Partinë Demokratike, roli i anëtarësisë mbetet shumë minimal dhe kontributi i kuotave në fushatën elektorale apo aktivitetin vjetor të partisë lëviz midis shifrave 0.00% e deri në 3.85% për Partinë Socialiste, 3.67% për Partinë Demokratike dhe vetëm në një rast në 3.84% për LSI-në.

Pra të ardhurat shumë minimale dhe ndonjëherë inekzistente nga anëtarësia dhe predominimi i fondeve publike janë indikatorë që tregojnë se në partitë politike shqiptare anëtarësia nuk luan rolin që ka luajtur në partinë e masave. Një observim tjetër që vjen prej kësaj analize është se përkundër asaj që konkludon van Biezen se partitë me numër të madh anëtarësie kryejnë fushata elektorale më pak të shpenzueshme për shkak se mund të mbështeten në një rrjet të gjerë organizativ për të përçuar mesazhin (2003:192), partitë politike shqiptare që kanë patur edhe fushatat më të shpenzueshme kanë qenë partitë e mëdha, ato me numër më të madh anëtarësie, dhe kjo sepse edhe fondet që kanë marrë nga buxheti i shtetit ka qenë më të mëdha, por edhe sepse donacionet nga personat privatë dhe juridikë kanë qenë më të mëdha. Dhe një situatë e tillë ka përforcuar rezultatin e forcimit të partive tashmë të forta nga njeri vit në tjetrin, duke bërë kështu të pamundur hyrjen në skenë të partive të vogla, të cilat e kanë të vështirë në mos të pamundur të organizohen territorialisht për shkak të burimeve të vogla në dispozicion. Pikërisht, sasia e madhe e

fondeve që marrin prej shtetit i lidh më shumë partitë me këtë të fundit, duke mos i dhënë incentiva për të grumbulluar fonde prej anëtarësisë. Megjithatë duhen parë edhe elementët e tjerë të organizimit partiak për të konkluduar mbi tipologjinë e partive politike shqiptare.

Tabela 21: Të ardhurat nga kuotizacioni për partitë politike në periudhën 2009-2013

Partia	2009	2011	2012	2013
PS	0	0	350,000	14,712,900
PD	3,533,700	1,450,540	0	3,469,730
LSI	0	0	147,500	

Nga tabela shihet qartë që në vitet 2009 dhe 2011 Partia Socialiste dhe LSI nuk kanë patur të ardhura nga anëtarësia. Për LSI-në kjo është e vërtetë edhe për vitin 2013. Në vitin 2012 Partia Socialiste ka grumbulluar një shumë modeste prej 350,000 lekësh megjithëse një pjesë e mirë e anëtarësisë së saj paguajnë kuotizacione shumë të larta. Kështu në vitin 2012, Asambleja Kombëtare miratoi listën e re të kuotizacionit sipas të cilës biznesmenët do të paguanin më shumë dhe të varfrit më pak. Konkretisht skema e pagesës së kuotizacionit është e tillë:

...200 lekë për studentët, pensionistët, të papunët, punonjës fshati, 1,000 lekë të punësuarit në sektorin shtetëror dhe aktivitetin e vogël privat, 1,500 lekë Anëtarët e këshillave të bashkive të kategorisë së tretë, të komunave, kryepleqtë, 2,000 lekë anëtarët e këshillave të bashkive të kategorisë së dytë, 2,500 lekë anëtarët e këshillave të bashkive së parë, 5,000 lekë kryetarët e komunave, nënkryetarët e bashkive të kategorisë së dytë dhe të tretë dhe sekretarët e bashkive/komunave, 10,000 lekë Kryetarët e bashkive të kategorisë së dytë, nënkryetarët e bashkive të kategorisë së parë, 20,000 lekë Kryetarët e bashkive të kategorisë së parë, 20,000 lekë Biznesmenët dhe 72,000 lekë Deputetët (Panorama, 23 janar, 2012).

Pra, pavarësisht kuotave të larta që do të duhej të paguanin një pjesë e mirë e anëtarësisë, del qartazi që një pjesë shumë e madhe e kësaj anëtarësie ose nuk paguan, ose në shifrat që deklarojnë partitë politike nuk janë të sakta. E njëjta situatë ndodh edhe në PD ku të ardhurat nga kuotizacioni janë minimale dhe jo në përputhje me numrin e madh të anëtarësisë që ka partia. Është e qartë që partitë politike nuk arrijnë t'i mbledhin të gjitha të ardhurat nga kuotizacioni megjithë penalitetet që ekzistojnë. Kështu sipas nenit 14 statutit të Partisë Demokratike, thuhet se “kuotizacioni duhet të paguhet brenda 60 ditëve nga data e thirrjes për pagimin e tyre. Me përfundimin e afatit të njoftuar për pagimin e kuotizacionit, anëtarët që nuk kanë paguar atë, humbasin të drejtën e votës, deri në rinovimin e anëtarësisë”. E megjithë vlerat e ulëta të kuotizacionit që indikon qartë që një numër i madh i anëtarëve të PD-së nuk e kanë paguar kuotën e anëtarësisë, numri i anëtarëve të PD-së nuk është zvogëluar, por përkundrazi është rritur nga njëri vit në tjetrin siç e tregon edhe tabela më sipër. Kjo tregon për një interes më të vogël të anëtarësisë në punët organizative. Megjithatë, përveç të ardhurave të pakta të cilat indikojnë për një numër jo real të deklaruar nga partië politike, edhe një krahasim me vendet e tjera do të na ndimonte të kuptonim në mirë këtë fenomen. Kështu partita më e mëdhe hungareze ka një anëtarësi prej 60,000 anëtarësh, gjë që konsiderohet megjithatë një shifër e ekzagjeruar (van Biezen, 2003:111). Kështu që në këtë kontekst mund të sugjerohet se edhe shifrat e raportuara nga partitë politike nuk janë korrekte.

5.6 Roli i Shoqërisë

Literatura mbi partitë politike në vendet post-komuniste, e lidh nivelin e ulët të të ardhurave prej anëtarësisë me nivelin e ulët të anëtarësimit. Në fakt në Republikën Çeke dhe në Hungari është vënë re se respektivisht, vetëm 3.9 dhe 2.2 përqind e elektoratit janë të anëtarësuar në një parti politike, gjë që nënkupton që anëtarësimi partiak përbën veçse një burim të vogël të të ardhurave. Megjithatë ky nuk është rasti i Shqipërisë. Në analizën e rolit të anëtarësisë tek partitë politike Shqiptare (shih Kapitulli IV) u vu re se partitë politike shqiptare janë më të ankoruara në shoqëri se sa simotrat e tyre në vendet post-komuniste. Kështu për rastin e Shqipërisë u vu re se përqindja e anëtarësisë së partive politike në raport me elektoratin varion nga 8.9% (viti 1992) dhe arrin deri në 12.1% (viti 2005, por edhe për vitet 2001 dhe 2009 shifrat vërtiten tek 12 përqind). Në zgjedhjet e fundit 11.7% e elektoratit votues ishte i anëtarësuar në tri partitë e marra në shqyrtim. E megjithatë ndonëse partitë politike shqiptare duken më të ankoruara në elektorat sesa partitë në vendet e tjera post-komuniste, të ardhurat që gjenerohen prej anëtarësisë janë më të vogla sesa ato që realizohen prej anëtarësisë së vendeve të tjera post-komuniste. Kështu shifrat për partitë Çeke tregojnë se të ardhurat prej anëtarësisë lëvizin ndërmjet 9.7% - 14.1% të të ardhurave, ndërsa për partitë hungareze lëvizin në vlerat 2.2-2.4% në periudhën 1990-1997 (van Biezen, 2003: 189-191). Kështu nëse i referohemi Tabelave 17-21 shikojmë se të ardhurat nga anëtarësia vetëm një herë i janë afruar shifrave të vendeve post-komuniste kur në vitin 2013 PS arriti të grumbullonte 14,712, 900 lekë nga anëtarësia që është e barabartë me 9.3% të të ardhurave të përgjithshme për atë vit. Në një pjesë të konsiderueshme të rasteve të ardhurat nga anëtarësia kanë qenë 0% si në rastin e PS, LSI,

PR për fushatën elektorale të vitit 2009, PS, LSI dhe PR për fushatën elektorale të vitit 2011, PD, LSI dhe PR për vitin 2012, PD për vitin 2013.

Është e qartë që pavarësisht deklarimit të shifrave të anëtarësisë, të cilat sidoqë të jetë merren me rezervë, për shkak se partitë, me qëllim që të rritin bazën e legjitimitetit të tyre, janë të prirura për të deklaruar anëtarë më tepër se sa kanë, pra pavarësisht këtij deklarimi, duket që anëtarësia nuk luan rolin 'klasik' që ka luajtur në partinë e masave. Pra edhe pse është e madhe në numër, prej saj nuk pritet që të jetë një kontribuese e rëndësishme në të ardhurat e partisë. Natyrshëm mund të lind pyetja, se përse duhet anëtarësia, për sa kohë që karriera në parti të politike jo domosdoshmërisht kalon përmes militantizmit të hershëm në parti.

Është e rëndësishme të thuhet se analiza e rolit të shoqërisë mbi partitë politike nuk duhet kufizuar vetëm tek analiza e të ardhurave të anëtarësisë. Lidhja e partisë me shoqërinë nuk sigurohet vetëm prej anëtarësisë, por edhe prej individëve, grupeve të interesit apo sindikatave (van Biezen, 2003:193-194). Në këtë kontekst është me rëndësi të shihet se sa të rëndësishme janë kontributet e ardhura nga donatorët privatë. Në këtë linjë duket që partitë sigurojnë shumë më tepër fonde nga donatorë privatë sesa nga anëtarësia. Kështu është emblematike shifra prej 79,856,841 lekë, që PD siguroi nga fonde jo publike në fushatën elektorale të vitit 2009. Kjo shifër përbën në fakt edhe 53.16% të të ardhurave të partisë për këtë fushatë. Po kështu edhe në zgjedhjet e vitit 2013 Partia Demokratike siguroi 63,338,130 lekë apo 67% të të ardhurave prej fondeve jo-publike. Po këtë vit Partia Socialiste siguroi 42,208,650 lekë të ardhura prej fondeve jo-publike ose 52.6% të të ardhurave totale për fushatën. Ky element duhet parë me vëmendje sepse këto shifra jo domosdoshmërisht tregojnë depërtim të partisë në shoqëri. Sipas raporteve të auditit të

Partisë Demokratike për zgjedhjet e vitit 2009 dhe 2013, të ardhurat e fondeve jo-publike janë kryesisht prej individëve fizikë. Kështu për zgjedhjet e vitit 2009, nga 79,855,180 lekë të fondeve jo-publike, 51,704,980 lekë ose 64.7 ishin prej personave fizike dhe pjesa tjetër prej personave juridikë. Ndërsa për zgjedhjet e vitit 2013, 100% e shumës vinte prej personave fizikë. E njëjta gjë është e vërtetë edhe për Partinë Socialiste e cila në fakt identifikon si donatorë jo-publikë një seri personash fizikë, ndër të cilët anëtarë të strukturave të larta të PS. Janë dy pika të rëndësishme që duhen nënvizuar:

- Së pari, lidhjet me personat fizikë nuk tregojnë depërtim të partisë në shoqëri. Këto tregojnë lidhje me individë specifikë, dhe kjo është tipike e partive klienteliste. Duhet shtuar gjithashtu që për zgjedhjet e vitit 2009, e gjithë shuma e marrë nga degët e PD në rrethe është shpenzuar po aty, duke përforcuar më shumë tezën e lidhjeve klienteliste ndërmjet personave lokalë.
- Së dyti, është e rëndësishme të vihet re se PD, si parti në pushtet ka arritur të grumbullojë shumë më tepër fonde jo-publike në krahasim me Partinë Socialiste. Kështu në vitin 2009, ku ka arritur të grumbullojë 79,856,841 lekë kundrejt 6,855,136 lekë të PS, pra dhjetë herë më shumë se PS. Diferenca është akoma më e theksuar në zgjedhjet e vitit 2011, ku PD siguron 70,164,262 lekë të ardhura nga fonde jo-publike, përkundrejt 3,900,000 lekë të PS, pothuaj 17-fishin e PS. Në zgjedhjet e vitit 2013, diferenca nuk është kaq e madhe, dhe konkretisht PD ka siguruar 63,338,130 lekë prej fondeve jo-publike përkundër 42,208,650 lekë të PS. Kjo gjithashtu përforcon tezën sipas së cilës, *partitë që financohen më shumë janë ato që, kanë gjasa të kryejnë edhe praktikën e patronazhit, klientelizmit dhe korrupsionit* (van Biezen, & Kopecky, 2001:424).

Mungesa e lidhjeve me organizata, grupe interesi apo sindikata, që në fakt do të ishin indikatorët që tregonin lidhjen e partisë me shoqërinë, por me individë të cilët në pjesën më të madhe janë të padeklaruar sepse kanë dhuruar shuma nën 100,000 dhe sipas ligjit këta nuk është e rëndësishme të deklarohen, gjë që e bën më të thjeshtë marrëdhënien pardon-klient. Mungesa e lidhjeve me shoqërinë përmes grupeve të interesit, është e përbashkët me vendet e tjera post-komuniste (van Biezen, 2003: 194).

Evidencat tregojnë se shteti dhe personat fizikë luajnë rolin kryesor për partitë e mëdha, sidomos ato në pushtet, ndërsa për partitë e vogla shteti mbetet kontribuesi kryesor. Në praktikë, partitë marrin shuma të konsiderueshme prej burimesh të paligjshme. Parë në këtë prespektivë, kuotat e anëtarësisë dhe donacionet private mund të përbëjnë vetëm një pjesë të kategorisë më të gjerë të fondeve shoqërore. Të fokusuarit vetëm mbi format ligjore të financimit të partive nuk na jep mundësinë e të vlerësuarit të rolit të rëndësishëm që luajnë burimet e paligjshme të financimit të partive politike, duke nënvlerësuar kështu rëndësinë e shoqërisë mbi financat e partive. Për më tepër, sikurse e komenton edhe van Biezen (2003:196) burimet shtetërore nuk janë të kufizuara vetëm tek subvencionet e partive, por përfshijnë edhe një sërë subvencionesh indirekte, dhe sidomos patronazhin partiak. Andaj edhe në këtë punim nuk mund të anashkalohej analiza e praktikave të financimit jo-ligjor si prej shoqërisë ashtu edhe prej shtetit, të cilat përgjithësisht i shpëtojnë kontrollit ligjor të shtetit. Megjithëse korrupsioni, për shkak të vetë natyrës së tij, është i vështirë për t'u vlerësuar, ekziston bindja se praktikave të tij janë të përhapura në Shqipëri.

Prania e financimit jo-ligjor të partive politike shpjegon në një farë mase edhe situatën paradoksale ku partitë politike shqiptare shpesh deklarojnë se janë debitorë, pa u

përpjekur të gjenerojnë fonde të tjera për të mbuluar këto borxhe. Në të gjitha raportet e audimit të partive të marra në shqyrtim, partitë deklarojnë se janë në borxh dhe se shuma e harxhuar për fushata ose aktivitetin vjetor, i ka kaluar të ardhurat e tyre. Një shpjegim për këtë mospërputhje ndërmjet pamundësisë së deklaruar për të përballuar shpenzimet dhe mungesës së përpjekjeve për të gjeneruar burime të ligjshme të ardhurash mund të jetë kontrolli jo adekuat dhe jo efektiv i financave të partive, për shkak të të cilit, forma financimi private jo legjitime kompensojnë pikërisht sasinë e vogël të burimeve financiare të partive politike. Për më tepër, një tjetër mënyrë për të rritur ndikimin e tyre mbi elektorat është edhe ushtrimi i formave të patronazhit dhe klientelizmit, duke përdorur kështu burimet shtetërore përmes posteve zyrtare (Xhaferaj, 2012; 2013).

Sikurse edhe Katz dhe Mair (1995) e kanë vënë re, partitë në demokracitë bashkëkohore po posedojnë gjithmonë e më tepër burime publike, që përfshijnë subvencione shtetërore, financim indirekt dhe në natyrë, dhe akses në media. Si pasojë e lidhjeve të forta me shtetin, partitë mund t'i kthehen shtetit për fonde të tjera përveç atyre të sipërpërmendura, dhe kanë prirjen për të t'i përdorur burimet shtetërore në mënyrë të paautorizuar. Sikurse komenton edhe Pasquino, një sistem financimi publik mund të jetë suplementar dhe jo zëvendësues i formave klienteliste të financimit (në Blanco, 1995:165).

5.7 Financat Partiake dhe Organizimi Partiak

Varësia e jashtëzakonshme e partive prej fondeve publike sugjeron se partitë politike shqiptare kanë krijuar një lidhje të fortë me shtetin që prej formimit të tyre. Kombinimi i varësisë së fortë prej shtetit i shoqëruar me forma të theksuara patronazhi (Xhaferaj, 2013) ka bërë që partitë të ankorohen aq shumë në shtet sa që mund të shihen si agjenci gjysëm-

shtetërore (shih Katz dhe Mair, 1995). Për më tepër në Shqipëri pjesa më e madhe e subvencioneve shtetërore i alokohet partisë në qender. Për shembull në raportin financiar vjetor 2013 të Partisë Demokratike vihet re se ndërsa pagat e punonjësve në qendër janë 11,273,477 ose 22.1% të shpenzimeve totale të partisë për atë vit, pagesa e degëve është 7,021,000 ose 13.7% të shpenzimeve vjetore, megjithëse PD ka një shtrirje territorial shumë të gjerë dhe sipas raportit të auditimit për fushatën elektorale 2013 ka 36 degë në të gjithë vendin. Kjo inkurajon një model organizimi nga qendra – në bazë duke përqendruar vendim-marrjen financiare në duart e udhëheqjes së partisë duke centralizuar kështu, gjithmonë e më tepër, lokusin e pushtetit në parti që tashmë janë të centralizuara.

Përveç kësaj, rëndësia më e madhe për shpenzimeve elektorale përkundër shpenzimeve për aktivitetet vjetore, rutinë, të partisë është një indikator tjetër që tregon se organizata jashtë-parlamentare e ka humbur tashmë rëndësinë financiare që mund të ketë pasur ndonjëherë. Kështu në raportin e aktivitetit vjetor të Partisë Socialiste për vitin 2013 vihet re se donacionet e anëtarëve të partisë kanë qenë 55,117,019 leke ose 34.69% e fondit vjetor të partisë. Megjithatë në një vëzhgim më të detajuar shihet se vetëm 14,712,900 lekë ose 9.26% janë të ardhura nga kuotat e anëtarësisë, ndërsa pjesa tjetër prej 40,404,119 lekë ose 25.43% e fondeve vjetore, janë dhënë nga anëtarë të partisë si kontribut për fushatën zgjedhore. Ka shifra që tregojnë se ndihma e dhënë mund të arrijë deri në 1,000,000 lekë në përputhje me legjislacionin shqiptar, gjë që indikon se numri i atyre që japin është shumë më i vogël se sa numri i anëtarësisë së partisë. Po kështu, në rastin e të dyja partive, si PS ashtu edhe PD, një pjesë të mirë të shpenzimeve vjetore e kanë për konsulenca ose reklama pa specifikuar se për çfarë janë këshilluar apo se për ç'arësye e kanë konsideruar reklamën si aktivitet vjetor dhe duke qenë se këto konsulenca apo reklama ndodhin në vit elektorale, të

gjitha gjasat janë që ato të jenë kryer për fushatën elektorale. Kështu në vitin 2013, PD ka shpenzuar 14,809,974 lekë ose 29% të shpenzimeve totale të vitit për konsulencë, ndërsa Partia Socialiste ka shpenzuar 157,247, 683 lekë ose 80% të shpenzimit vjetore për reklama. Pra partitë politike shqiptare e përdornin një pjesë të konsiderueshme të buxhetit të aktiviteteve vjetore për fushatën elektorale, edhe pse ato përfitojnë më shumë nga buxheti i shtetit për aktivitetin vjetor dhe jo atë elektorale. Kjo tregon një orientim më të madh të partisë drejt elektoratit dhe jo drejt organizatës bazë.

5.8 Konkluzioni

Nga analiza e rolit që luajnë financat tek partitë politike shqiptare u vu re se fondet publike luajnë një rol kyç në financimin e partive. Po kështu u vu re se këto fonde iu dhanë partive politike që në momentet e para të krijimit të tyre. Për pasojë duke qenë se fondet shtetërore iu dhanë partive në fazat e para të zhvillimit të tyre, partitë politike shqiptare krijuan lidhje të forta me shtetin dhe nuk patën incentiva për të kërkuar burime të tjera financiare (me përjashtim ndoshta të burimeve të korruptuara) dhe kjo hoqi incentivat për të vendosur lidhje të forta me shoqërinë. Në këtë mënyrë partitë u bënë pjesë e aparatit shtetëror dhe jo përfaqësues të shoqërisë (Katz, 1996).

Duke qenë se në buxheti i shtetit kapte shifra shumë të larta, ndonjëherë edhe 100%, varësia financiare e partive prej shtetit është tërësore. Në kontrast me të ardhurat publike vihen të ardhurat nga kuotizacioni dhe të cilat janë shumë minimale dhe ndonjëherë edhe zero, gjë që flet për një rënie të jashtëzakonshme të relevancës së anëtarësisë si burim i financimit të partisë.

Përsa i përket lidhjes së partisë me shoqërinë është e vështirë të përcaktohet. Financimet jo publike të partive politike përbëhen nga donacione nga persona fizikë dhe privatë. Megjithatë PD si në zgjedhjet e vitit 2009 ashtu edhe në ato të vitit 2013 ka patur më tepër se 50% të financimit prej donatorëve jo publikë, pra prej shoqërisë, ndërsa Partia Socialiste pati një rritje të theksuar të këtyre fondeve vetëm në vitin 2013, që është edhe vit i rrotacionit politik. Ndërkaq fondet jo publike janë pothuajse inekzistente për aktivitetin vjetor të partisë, gjë që indikon se lidhjet e partisë me shoqërinë forcohen vetëm në fushatë elektorale gjë që tregon sërisht një orientim të partisë për të forcuar performancën elektorale dhe jo atë vjetore, por në të njëjtën kohë tregon edhe një interes të shoqërisë për partinë si subjekt elektorale dhe jo si përfaqësuese të shoqërisë. Po kështu praktika e dhurimit më shumë për partinë në pushtet (PD në 2009, 2011 dhe 2013) shërben njëkohësisht edhe si një indikator i praktikave të patronazhit që ushtrohen nga partitë politike të cilat shpërblejnë mbështetësit e tyre me poste publike në shkëmbim të mbështetjes financiare të marrë në kohë fushate.

Po kështu analiza e kuadrit ligjor tregoi se duke qenë se subvencionet shtetërore përcaktohen në terma të suksesit elektorale apo forcës parlamentare, ky kuadër e bën të vështirë hyrjen në skenë të partive të reja. Në këtë sens, fondet publike shërbejnë për të krijuar një *status-quo* të sistemit partiak dhe inkurajojnë kartelizimin e tij.

KAPITULLIL VI: PËRFUNDIME – SISTEMIT PARTIAK DHE STRUKTURA DHE ORGANIZIMI I PARTIVE POLITIKE SHQIPTARE

6.1 Hyrje

Ndryshimet politike që ndodhën në Shqipëri me rënien e komunizmit, ashtu sikundër edhe në vendet e tjera post-komuniste, ofruan një transformim shumë-dimensional të skenës politike, shoqërisë, si edhe të aktorëve politikë që u angazhuan në luftën për përfaqësim. Punimi nisi me premisën se konteksti institucional në të cilin shfaqen partitë politike (van Biezen, 2003) dhe e shkuara historike e vendit (Kitschelt et.al., 1998) ka një rëndësi fundamentale për të kuptuar procesin e formimit të partive politike sepse ai është përcaktues i oportuniteteve dhe pengesave në rrugën për ndërtimin organizacional të partisë dhe po kështu ndikon edhe në strukturën e sistemit partiak sepse partitë që lindin dhe çështjet immediate që shfaqen në hapësirën politike, përcaktojnë edhe mënyrën e ndërveprimit të partive politike me njera-tjetrën si edhe lidhjen e tyre me elektoratin.

Studjuesit kanë vërejtur se sistemi partiak në vendet post-komuniste është karakterizuar nga paqëndrueshmëri e theksuar si edhe nga parti të cilat janë etatizuar duke u larguar gjithmonë e më tepër nga shoqëria (van Biezen, 2003). Ndër faktorët që kanë çuar në krijimin e një sistemi të tillë, literatura liston mungesën e identiteteve të qarta shoqërore dhe ekonomike për shkak të nivelimit që sistemi komunist i bëri të gjitha grupimeve shoqërore, dobësinë ose inekzistencën e shoqërisë civile dhe të grupeve të interesit, subvencionimin me fonde publike të partive politike që në fillim të krijimit të tyre,

originën e tyre institucionale dhe jo si rezultat i lëvizjeve sociale si edhe rritjen e rëndësisë së medias elektronike (Hanley, 2007:2).

Megjithatë punimi e identifikoi Shqipërinë si një rast jo tërësisht të ngjashëm me atë të vendeve të tjera post-komuniste. Kështu, tipari dallues i parë që identifikoi punimi dhe që shërbeu edhe si kriter për përzgjedhjen e Shqipërisë si rast studimor, është se në ndryshim nga vendet e tjera post-komuniste si Polonia, Çekia, Hungaria apo Sllovakia, nga ku përgjithësisht ka gjeneruar literatura mbi studimin e partive politike, Shqipëria ka një të shkuar të ndryshme prej tyre, duke u karakterizuar kështu në atë që Kitschelt et.al (1998) e konsideron si komunizëm patrimonial. Vendet e komunizmit patrimonial, ku klasifikohet edhe Shqipëria, nuk patën disidencë gjatë komunizmit. Në periudhën e tranzicionit, pjesa e pakënaqur e elitës komuniste, ia doli të vetë-organizohej dhe të krijonte partitë opozitare, para se forcat anti-komuniste të mobilizoheshin për të krijuar një rend liberal-demokrat. Partitë post-komuniste u karakterizuan nga programe jo të mirëfillta ideologjike, duke u fokusuar kryesisht tek anti-komunizmi, duke mos arritur kështu ta organizonin garën zgjedhore në terma të ‘përplasjes’ ‘ e majtë-e djathtë’ (fq. 388). Po kështu në vendet që i përkasin komunizmit patrimonial, në mungesë të ndarjeve të qarta ideologjike, partitë politike prirën të krijojnë atashime klienteliste dhe jo programatike me elektoratin (fq.52).

Tipari i dytë, që e bën gjithashtu specifik rastin e Shqipërisë, është se në ndryshim nga vendet e tjera post-komuniste, partitë politike Shqiptare nuk patën mundësi të mbështeteshin tek media për përçimin e mesazhit të tyre, andaj ju desh që të depërtonin territorialisht në vend, pra u mbështetën mbi organizatat bazë, degët e partive në rrethe për të përçarur mesazhin e parties (shih seksioni 1.2).

Tipari i tretë që e dallon Shqipërinë nga vendet e tjera post-komuniste, është se përgjithësisht këto vende u karakterizuan nga nivele të larta paqëndrueshmërie (Rose et al. 1998; Toka 1998; Lewis 2000; Birch 2001; Sikk 2005; Tavits 2005), ndërsa sistemi politik shqiptar është karakterizuar nga alternimi i rregullt i pushtetit ndërmjet dy partive politike, që janë edhe pjesë e këtij studimi, Partisë Demokratike dhe Partisë Socialiste. Pra, në kundërshtim me atë çfarë ka vërejtur literature bashkëkohore mbi sistemin partiak në vendet post-komuniste, sistemi partiak shqiptar ka shfaqur qëndrueshmëri.

Në këtë kontekst, pyetjes kërkimore *“Cili është sistemi partiak dhe cila është struktura dhe organizimi i partive politike shqiptare?”* punimi iu përgjigj me tezën se *“Sistemi partiak shqiptar është karakterizuar nga qëndrueshmëri dhe është mbizotëruar nga dy parti kryesore (PS dhe PD). Sistemi i financimit të partive politike prej fondeve publike përforcon qëndrueshmërinë e sistemit, duke favorizuar partitë parlamentare të mëdha. Partitë politike shqiptare janë parti masash klienteliste, me shtrirje të gjerë në terren por që nuk financohen nga anëtarësia, por përdorin pushtetin shtetëror për të shpërblyer anëtarësinë dhe simpatizantët për mbështetjen e marrë në kohë fushate. Ato janë të centralizuara në qendër duke lënë pak hapësirë për organizatën bazë në lidhje me procesin e vendimmarrjes dhe karakterizohen nga një krah më i fortë jashtë-parlamentar kundrejt atij në post-publik, gjë që forcon pushtetin e ekzekutivit të partisë.*

Për t’i dhënë përgjigje pyetjes kërkimore, punimit iu desh ta zhvillonte analizën e tij si në nivel makro (sistemi) ashtu edhe në nivel mezo (partia). Kjo jo vetëm se pyetja i ngërthen të dyja nivelet, por edhe sepse këto nivele janë intrinsikisht të lidhura me njëra-tjetrën. Parti (nivel mezo) të organizuara mirë në terren mund të stabilizojnë elektoratin (nivel makro) (Gherghina, 2012:3). Po kështu, kuadri ligjor (nivel makro) që favorizon

partitë parlamentare, heq incentivat e këtyre të fundit për të krijuar lidhje të forta me shoqërinë (nivel makro). Me lidhje të forta, kuptohen lidhje ligjërishu të gjurmueshme, sepse në fakt punimi vërtetoi që këto lidhje ekzistojnë, por janë të natyrës klienteliste. Në këtë kontekst studimi u strukturua në tri pjesë:

- 1- Analiza e sistemit partiak: a) cilat janë partitë relevante dhe b) cila është luhatshmëria e elektoratit;
- 2- Analiza e vetë njësisë së studimit, partisë politike: roli i anëtarësisë, shpërndarja e brendshme e pushtetit dhe lidhja e partisë me shoqërinë;
- 3- Identifikimi i burimit të financimit të partive politike: cili është kuadri ligjor dhe cilat janë vlerat monetare që përfitojnë partitë politike për të ushtruar aktivitetin e tyre vjetor si edhe për të zhvilluar fushatën elektorale.

6.2 Sistemi Partiak Shqiptar dhe Panorama Komplekse e Luhatshmërisë Elektorale

Një ndër synimet kryesore të punimit ishte të analizonte sistemin partiak shqiptar. Për ta realizuar këtë punimi u mbështet në klasifikimin e Siaroff mbi sistemin partiak si edhe në indeksin e fragmentizimit të Lakso dhe Taagepera (1979). Po kështu analiza përcaktoi se partitë relevante sipas konceptit të Sartorit ishin Partia Socialiste dhe Partia Demokratike, pavarësisht se parë nën dritën e rezultateve të tri zgjedhjeve të fundit, edhe Partia Lëvizja Socialiste për Integrim u përfshi në këtë analizë.

Analiza e sistemit partiak konsistoi në dy pjesë. Në pjesën e parë u vlerësua numri efektiv i partive, dhe në pjesën e dytë u vlerësua luhatshmëria e elektoratit shqiptar. Analiza e këtyre dy komponentëve të rëndësishëm të sistemit partiak u krye jo vetëm sepse na përshkruajnë në vlera numerike këtë sistem, që ishte edhe një ndër qëllimet e punimit, por

edhe sepse ndihmojnë për të kuptuar se sa janë në gjendje partitë politike për të kontrolluar elektoratin shqiptar. Gherghina (2012) shpjegon luhatshmërinë elektorale nga një qasje organizative. Sipas tij, burimet e luhatshmërisë elektorale janë institucionale dhe organizimi partiak mund ta ulë luhatshmërinë duke rritur qëndrueshmërinë e elektoratit. Duke ndjekur këtë logjikë, punimi u përpoq të kuptonte se pse qëndrueshmëria e sistemit partiak Shqiptar shoqërohej me nivele të larta luhatshmërie elektorale, gjë që bie në kontradiktë me logjikën. Luhatshmëria elektorale tregon zhvendosje të elektoratit nga njera parti në tjetrën dhe për pasojë një luhatshmëri e lartë duhet të shoqërohet me ndryshime në sistemin partiak gjë që nuk vihet re në rastin shqiptar.

Matja e Numrit Efektiv të Partive Parlamentare tregoi se indeksi i fragmentizimit është i ulët. I shoqëruar me klasifikimin e Siaroff që nuk mjaftohet vetëm me gjetjen e indeksit të fragmentizimit por edhe me analizën e peshës specifike që zënë partitë politike në një sistem partiak të caktuar, u pa se partitë politike relevante në Shqipëri janë Partia Socialiste dhe Partia Demokratike, dhe së fundmi edhe Partia Lëvizja Socialiste për Integrim. Edhe në vitet ku sistemi partiak duket i fragmentizuar, si p.sh. në vitin 2005, sërish, klasifikimi i Siaroff-it na tregon se në fakt dy partitë kryesore kontrollojnë 71% të parlamentit; distanca midis partisë së parë dhe të dytë është e vogël, ndërsa midis partisë së dytë dhe të tretë është shumë e madhe. Është e qartë që sistemi është i predominuar nga dy parti kryesore.

Qëndrueshmëria e sistemit partiak megjithatë është e shoqëruar me luhatshmëri të madhe elektorale në nivel partie por me luhatshmëri të ulët në nivel blloku partiak. Në tabelën e mëposhtme, përmbledhen të gjitha të dhënat në lidhje me nivelin e fragmentizimit dhe luhatshmërinë elektorale në nivel partie dhe blloku partiak:

Tabela 22: Tabelë Përmbledhëse për Sistemin Partiak dhe Lulatshmerinë e Elektoratit

Viti Elektoral	P3%S	2PSC	SR 1:2	SR 2:3	NEPP	Sistemi Partiak	LES⁶¹	LEB
1991	2	98%	2.27	15	1.81	Dy-partiak	NA	NA
1992	3	93%	2.42	5.43	1.97	Dy partiak	30.7	NA
1996	2	94%	12.2	3.33	1.31	Dy partiak	17.97	NA
1997	4	83%	3.92	2.89	2.14	Multi partiak me një parti dominuese	37.63	NA
2001	5	75%	2.28	3.56	2.99	Multi- partiak me dy parti dominuse	11.04	5.65
2005	5	71%	1.33	3.82	3.68	Multi- partiak me dy parti dominuse	27.14	2.95
2009	2	96%	1.03	16.5	2.21	Dy partiak	65.26	4.25
2013	3	82%	1.35	3.06	2.80	Dy parti e gjysëm	11.34	5.03

Nga tabela duket qartazi që pavarësisht se lulatjet e elektoratit në nivel partie janë të mëdha (në vitin 2009 shkojnë në 65.26), ato në nivel blloku partie janë të ulëta. Janë në fakt nivelet më të ulëta të lulatshmerisë krahasuar jo vetëm me vendet post-komuniste, por edhe me vendet e Evropës Perëndimore, edhe pse ndarjet shoqërore në këto të fundit janë më të konsoliduara dhe për pasojë edhe besnikëria e elektoratit më e lartë. Lulatshmeria e

⁶¹ LE- Lulatshmeria Elektorale në nivel Sistemi

ulët në nivel blloku e shoqëruar me sistem partiak të qëndrueshëm, na shërbeu si indikator për të treguar se partitë politike kanë depërtim të thellë territorial në elektorat dhe janë në gjendje të orientojnë votat e elektoratit për të maksimizuar përfaqësimin e tyre parlamentar. Në mungesë të ndarjeve të qarta shoqërore dhe një elektorati me identitet jo të qartë politike si edhe në kuadër të premisë teorike të trashëgimisë historike të Shqipërisë (Kitschelt et.al., 1999), sipas së cilës vendet që i përkasin komunizmit patrimonial nuk mund të krijojnë parti programatikisht të strukturuar por veçse parti klienteliste), punimi e konsideroi besnikërinë e elektoratit shqiptar si një indikator të marrëdhënieve klienteliste me anë të të cilave partitë politike ruajnë depërtimin e tyre territorial.

Në këtë kontekst, luhatshmëria e elektoratit përveçse i dha përgjigje pyetjes se ç'loj sistemi partiak kemi në Shqipëri, hodhi edhe një hap për të kuptuar tipologjinë e partive politike shqiptare, tipologji kjo që u analizua më në detaje në Kapitullin IV (*Organizimi Partiak, Anëtarësia dhe Balanca e Brendshme e Pushtetit*) dhe në Kapitullin V (*Ndikimi i Financave mbi Partitë Politike*).

6.3 Organizimi Partiak, Anëtarësia dhe Balanca e Brendshme e Pushtetit

Është e qartë që anëtarësia partiake luan një rol të reduktuar në krahasim me profesionistët dhe lidhshimin e partive të marra në shqyrtim, edhe pse është e rëndësishme të vihet në dukje se partitë megjithatë i japin rëndësi të pasurit të një organizimi të mbështetur tek anëtarësia. Kjo gjë u pa nga struktura organizative e adoptuar prej krahut jashtë-parlamentar. Të gjitha partitë e analizuar janë të mbështetura në regjistrimin formal të anëtarësisë, kushtet për t'u anëtarësuar janë të lehta dhe të tria partitë e marra në shqyrtim kanë adoptuar një strukturë ku dega lokale është njësia bazike e organizimit.

Përsa i përket strukturës, partitë politike kanë artikulum vertikal, me lidhje të forta ndërmjet niveleve të ndryshme organizative përmes përfaqësimit të niveleve më të ulta në nivelet më të larta të partisë. Kongreset apo asamblëtë janë organet më të larta dhe organet ekzekutive zgjidhen prej këtyre kongreseve/asambleve ndaj të cilave japin gjithashtu llogari. Kjo tregon se modeli organizativ i mbështetur mbi anëtarësinë është modeli i dëshiruar për t'u ndjekur. Rëndësia që i jepet anëtarësisë mund të shihet jo vetëm në shifrat e larta që raportojnë partitë politike, por edhe në fushatat që ato ndërmarrin për të rekrutuar anëtarë të rinj në rradhët e partisë.

Megjithatë, pavarësisht strukturës dhe statutit të partisë, në partitë politike shqiptare anëtarësia nuk luan rolin, që së paku tradicionalisht, sipas modelit duvergerian, pritet që të luajë. Kjo shihet në rënien e frekuencës së organizimit të kongreseve të partisë, gjë që kufizon mundësinë e anëtarësisë për përfshirje dhe pjesëmarrje në vendimmarrje dhe në të njëjtën kohë tregon se partitë politike shqiptare janë të dominuara nga udhëheqja qendrore. Në një farë mënyre, lidhjet e dobëta me shoqërinë kanë shtruar udhën për të rritur influencën e elitave partiake në kurriz të anëtarësisë së thjeshtë. Në fakt partia në qendër shfaqet si organi përfundimtar që kontrollon funksionimin e aparatit partiak, vendimmarrjen në lidhje me çështjet financiare sikurse edhe bën përzgjedhjen e kandidatëve për postet publike.

Një gjetje tjetër e studimit ishte se anëtarët e partisë, janë më pak relevantë se profesionistët e kontraktuar. Kjo megjithatë është një tendencë që vihet re si në vendet e tjera post-komuniste ashtu edhe në vendet e Evropës Perëndimore.

Përsa i përket lidhjeve të partive me shoqërinë, mund të thuhet se partitë politike shqiptare përpiqen të kenë një shtrirje të gjerë territoriale. Në fakt, ato mbulojnë të gjithë

territorin e vendit, gjë që duket edhe në kapacitetin e tyre për të propozuar kandidatë në të gjitha zonat zgjedhore. Për më tepër, në ndryshim nga partitë në vendet e tjera post-komuniste, partitë politike përpiqen të mos vendosin vetëm lidhje elektorale me shoqërinë. Kështu partitë politike përpiqen të përfshijnë një pjesë të madhe të mbështetësve të tyre në rradhët e partisë, gjë që është tipike për partinë e masave dhe jo partinë elektorale – profesionale apo kartel. Megjithatë, lidhja e tyre me shoqërinë është e limitizuar vetëm në rekrutimin e anëtarëve dhe krijimin e degëve rinore dhe forumit të grave të cilat rritin aksesin e partisë në këta ‘sektorë’ të shoqërisë. Përsa i përket grupeve të tjera të interesit, partitë politike shqiptare nuk kanë krijuar lidhje me to. As partitë nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes së grupeve të interesit dhe as këto të fundit nuk janë të përfaqësuara në organet e partisë.

Në lidhje me rekrutimin e kandidatëve, shpesh, partitë politike kanë rekrutuar kandidatë pa afiliacion politik, por për shkak të influencës që ushtrojnë në një vend të caktuar dhe kjo është parë si një indikator i marrëdhënieve personale që vendosin kandidatët/partia me elektoratin. Për shkak të këtyre marrëdhënieve, kandidatët dhe për pasojë partia e ka më të lehtë kontrollin e votës dhe për pasojë e kanë më të lehtë edhe ushtrimin e praktikave të klientelizmit dhe patronazhit. Po kështu, sjellja e kandidatëve jo prej rradhëve të partisë, rrit lidhjen e kandidatit me lidhshërinë e partisë në qendër duke anashkaluar kështu hallkat tradicionale të komunikimit dhe llogaridhënies në parti. Në këtë kontekst anëtarësia shërben për të rritur legjitimitetin e partisë, por nuk kryen funksionet që tradicionalisht dhe me statut priten prej saj.

Përsa i përket balancës së brendshme të pushtetit, lokusi i pushtetit ndodhet në qendrën e partisë. Në lidhje me çështjen e vendimmarrjes, shumica i nënshtrohet pakicës

